

ARBEN DEDJA: SIPAS MEJE, POEZIA NUK ËSHTË FARE LETËRSI

Bisedoi Andreas Dushi



Mbi autorësinë e romaneve "Martesa e Lejlës" dhe "Sotiri e Mitka"

ROMANET QË JANË KONSIDERUAR GABIMISHT TË FAIK KONICËS

nga Sevdai Kastrati

Në dhjetor të vitit 2010 studiuesi dhe përkthyesi Fotaq Andrea zbuloi (duke e shfletuar shtypin francez) dy romane me tematikë shqiptare të shkruara nga Jean de Kroia, e sipas zbuluesit nuk ishte tjetër veçse Faik Konica. Zbulimi i romaneve të shkruara në frëngjishte tërhoqi vëmendjen e studiuesve. Njëri roman quhet "Martesa e Lejlës" dhe tjetri "Sotiri e Mitka". Vijon nga numri 189.



IN MEMORIAM
VILSON BLOSHMI DHE GENC LEKA
PO UNË, A DO TË KEM FATIN
TË NGOPEM SË LEXUARI? (fq. 10)

Prof.as.dr. Lili SULA

PANDOTJA
POETIKE E SHPIRTIT (fq. 11)

Nga Rudolf Marku

SHËNIME MBI LIBRAT

DISA MENDIME PËR LIBRIN

"ARBËRESHËT – MIDIS
REALITETIT DHE MITIT" TË
AUTORIT FATMIR TOÇI

nga Prof. Ermir Xhindi (fq. 7)

"ARKA E DJALLIT" E
DRITËRO AGOLLIT, NJË
VEPËR POLIFONIKE

Nga Agim Vinca (fq. 14)

UDHËTIM NË PËRMBLEDHJEN
POETIKE "RABINI IM" TË
ABDULLAH ZENELIT

nga Behar Gjoka (fq. 12)

Përkthyer nga Abidin Krasniqi, botuar nga "Fauves
édition", Paris. Romani "Les oisillons du coucou:
Souvenir d'un colon serbe".

ROMANI "ZOGJTË E QYQES" I
GANI MEHMETAJT, TASHMË
FLET FRËNGJISHT

nga Bajram Sefaj (fq. 15)

Shënime mbi romanin e Besnik Mustafaj "Një sagë e vogël",
botuar në suplementin kulturor të gazetës "Al – Araby"

ERRËSIRA SUNDON
JASHTË HEKURAVE

nga Lejla Abdullah (fq. 17)

MODIGLIANI: I KEQKUPTUAR

Nga Doug Stewart



BIBLIOTEKË

- Mira Meksi (fq. 18)
Puthja e Amazonës
- Martin Camaj (fq. 20)
*Nji trim që këndohej ndër
kangë popullore*
- Arbër Selmani (fq. 21)
M'i sillni 48 piano
- Aleko Likaj (fq. 16)
Papastasët
- Fatmir Musai (fq. 11)
Vdekja e bletës

Në gjurmët e një arkive të panjohur

ZBULIMI I NDUE PAL SHLLAKUT

Nga Xhahid Bushati

Ndue Pal Shllaku hyri në Shoqërinë Antoniane rreth viteve
1935 – 1936. Si interpretues në fushën e aktrimit lë shenjë
në komedinë "Shjor Puci" (komedi në tri akte) me autor
Zef Gianini, përkthyer nga Dom Lazër Shantoja. Është
për t'u përmendur se në këtë shfaqje ishte i pranishëm
dhe poeti Atë Gjergj Fishta.

(fq. 8)

ARBEN DEDJA:

Sipas meje, poezia nuk është fare letërsi

Bisedoi Andreas Dushi



Kryesisht, shkrimtarët e fillojnë botimin e krijimtarisë së tyre në gazeta apo revista e mandej, dalin me një libër. Ndërsa ju, sipas regjistrimeve të sistemit online të Bibliotekës Kombëtare (ku përfshihen artikujt e pas viteve '90), rezulton se në krye keni botuar një libër, "Shpella e trishtimeve të tua" ("Naim Frashëri", 1994) e pastaj pjesë ndër periodikë. A e kujtoni pse-në e kësaj?

Në fakt edhe unë fillimisht kam botuar në gazeta e revista, siç është e natyrshme. Bile, te gazeta "Drita" kam botuar që në klasë të tetë/vit të parë gjimnaz; një lloj rekordi i vogël për kohën (jemi në vitet shtatëdhjetë). Poezi pa ndonjë vlerë. Atëherë të botoje ishte shumë më e vështirë se sot. Dhe unë s'kam qenë kurrë i partishëm.

Nëse lejohem të luaj me titujt e zgjedhur prej jush për libra, cikle apo tregime, mund të ndërtoj një soj poezie surreale që të bën të ndjesh përzierje emocionale.

"Shpella e trishtimeve të tua" dhe "Milingonat" janë

"Poezi për kakën e tim biri", prandaj "Pa poezitë e mia prapë e bukur është bota",

"O çorape" "I thopërkuom"

"Puçrra", "Amputime të zgjatura"

"Kulla e mishit": të gjitha janë "The Italian Job".

Mes thonjzave janë titujt, jashtë tyre lidhëza e folje që kam shtuar unë. Titujt e tu Arben janë deri diku të panatyrshëm. Me çfarë mendoni se lidhet kjo?

I ngjan një loje që bënim të vegjël me titujt e filmave. Nuk e di sa të panatyrshëm janë titujt e mi. Unë vetë i kam zgjedhur spontanisht. Gjithsesi, mendoj se e gjitha ka lidhje me letërsinë, që nuk është aspak diçka natyrale. Po të krahasojmë, për shembull, një dialog të jetës reale me një dialog të shkruar do të vëmë re menjëherë sa larg janë mes tyre. "Natyrshtëria" e dialogut të shkruar është tjetër gjë. E keqja është se ekziston ideja, nganjëherë edhe te shkrimtarë të mirë, që dialogjet

në letërsi duhet të jenë si ato të jetës së përditshme. Dhe dalin lumë e det pastaj.

Sa e lumtur dhe e natyrshme është bashkëjetesa e poezisë dhe prozës së shkurtër brenda jush? Po ndërhyrja e herëpashershme e përkthimit, si përjetohet nga ky çift?

Thonë që forma letrare që i afrohet më shumë poezisë është tregimi (në kuptimin e gjerë të fjalës). Kësisoj jemi në kuadrin e një martesë të lumtur dhe tradicionale. Kurse përkthimi

është i treti "i paftuar" ose i treti – i vërteti. Sidomos në rastin tim kur, sa për të sjellë një shembull, numri i vargjeve që kam përkthyer është tre-katër herë më i madh (po e them pak me tahmin) se i vargjeve që kam shkruar. Duhet pak përpjekje në jetë. Njoh poetë e prozatorë që kanë një jetë në emigracion – i njohin gjuhët, pra – dhe nuk kanë përkthyer asnjë rresht letërsi të huaj. *Mamma mia!*


Duke e lexuar poezinë dhe prozën tuaj vërej dy gjëra të cilat do të doja t'i elaboroje pak më gjatë, ndoshta si

përsiatje e arsyes pse gjenden në to. Së pari, mishi, carne, mishërimi...

Mishërimi është një koncept fetar që nuk më përket, kështu që, në rastin tim, do të mbetesh te mishi. Dhe në fakt, atyre pak kritikëve që ma kanë analizuar veprën – këtu në Itali flas, se në Shqipëri nuk bëhet fjalë – poezia ime u është dukur tejet e prekshme, konkrete, sepse e lidhur ngushtë me trupin, trupore pra: shqipja ma pranon fjalën. E lidhnin këtë, jo pa të drejtë, me profesionin tim të mjekut kirurg. Në fakt e kam ushtruar mjekësinë vetëm njëmbëdhjetë vite, por meqë im gjysh ishte mjek, sikurse edhe im atë që, më keq akoma po t'i mëshojmë aspektit mishtor, ishte edhe kirurg, pra mjek jo vetëm me një akses teorik, por edhe praktik brenda trupit të njeriut, mua më duket se jam rritur brenda një rruzulli përditshmërisht që kishin të bënin me rropullitë, me barkun, prapë me mishin pra, të sëmurë ose jo, por kryesisht të sëmurë, njerëzor. Që katër-pesë vjeç im atë më merrte me vete të dielave në spital, kur shkonte për atë që ai e quante "kondravitë" (me gjasë diç e kundërt me vizitën që familjarët u bënin të dashurve të tyre).

Dhe së dyti, njerëzit realë si personazhe të së tashmes, përshembull te "Kulla e Mishit", apo familjarë, në vëllimin e sapobotuar me poezi "The Italian Job"...

Në veprat trillimtare (*fiction*), fakti nëse ngjarjet që përshkruhen kanë ndodhur vërtet apo jo nuk ia prek aspak natyrën trillimtare tekstit. E njëjta gjë edhe me personazhet. Në qoftë se unë them "unë" ose "Arben Dedja" ose një tjetër personazh me emër e mbiemër real ka bërë këtë ose atë, përsëri po trilloj. Fakti që unë ose personazhi në fjalë i ka bërë pastaj vërtet ato gjëra është krejt i papërfillshëm. Kemi këtu atë që Gérard Genette e quan "epitekst". Shpresoj që lexuesi të mos t'i kujtoj të vërteta ngjarjet dhe për të vërtetë personazhet – kjo do të ishte leshtësi nga ana e lexuesit. Po unë si autor, a jam i ndërgjegjshëm për këtë? A po luaj pak me epitekstin? Natyrisht.



Është si një patinim vërtetësie që i jap tekstit, por... edhe kjo është letërsi. Kurse për poezinë puna është pak më ndryshe, se poezia, sipas meje, nuk është fare letërsi. Nejse, diskursi po zhdrivillohet ca si shumë, sa nuk po dua të hyj në të thella.

Nëntitulli i "The Italian Job" është poezi mërgimi. Më kujtoi "Enciklopedia e mërgimit" të Entela Tabakut e Shqiptar Osekut, por prapëseprapë, ngjan si një term i ri. Përtej shkakut që merret me mend, se janë shkruar gjatë mërgimit tuaj, a ka diçka tjetër? Dhe në fakt, titulli në gjuhën angleze... Po kjo zgjedhje, nga ka ardhur?

"Këngë kurbeti" i quan folklori ynë. Në rastin tim, titulli: "poezi mërgimi" është krejt ironik, se në ka një gjë që këto poezi nuk kanë – me ndonjë përjashtim të rrallë që vetëm sa forcon rregullin – është t'i këndohet emigracionit, vuajtjeve, mallit, sakrificave të emigrantëve, atdheut të braktisur (për faj të pushtetarëve, natyrisht) e të tjera klishe sidozot. Kurse sa i përket titullit, nuk është hera e parë që vë tituj në anglisht. Dikur i vinin në latinisht. Nuk e bëj për t'u hequr i mençëm, jo: e bëj për ekonomi shprehjeje. Titulli "The Italian Job", lë të nënkuptosh vetiu një punë të kryer jo nën dritën e diellit, një si aferë të pisët, do të thoshim. Dhe është një çikë ashtu, apo jo, përderisa jetoj e punoj prej vitesh në Itali dhe, netëve mbarsur vetmi (se nëse ka një gjë të sigurt në mërgim është të qenët i vetëm), vazhdoj t'i shpreh ndjenjat e mia në gjuhën e vjetër, në shqip.

Dyshimi, jeta, vdekja, ekzistenca në vetvete e shprehur nëpërmjet ekzistencializmit... A buron krijimtaria juaj nga shqetësime personale? Nëse po, i identifikon dot ato?

Si çdo krijimtari. Janë shqetësimet e çdo epoke dhe të gjithkujt – edhe të lexuesit, tekefundit. Se është me atë që poeti/shkrimtari duhet të identifikohet. Ndryshon, besoj, vetëm mënyra si trajtohen dhe shprehen ato shqetësime. Që ta përmbledh, shqetësimet, ato ekzistencialialet flas, mund të jenë gjithsej në historinë e njerëzimit nja një duzinë – mënyra e shprehjes dhe përballjes me to: e pafund.


Shkrimtari, a duhet të jetë një Zoon Politikon dhe, të qenurit i atillë, duhet ta manifestojë në krijimtari?

Më duket e pamundur të mos jesh i tillë e kjo vlen për çdo qenie njerëzore. Por në letërsi, ama, siç na mësojnë gjithnjë francezët tanë të dashur, epërsia e narrativës moderne qëndron te neutraliteti i zërit rrëfimtar. Që të kemi art të vërtetë, ngjarja nuk duhet assesi komentuar, por vetëm duhet paraqitur në vetvete, pa asnjë hundëfutje nga ana e autorit. Autori duhet thjesht të zhduket dhe t'i lërë lexuesit "të përlëshen" me



personazhet dhe fatet e tyre. Kështu që, paradoksalisht, nëse në një tregim timin (se, nga ana fikzionale, unë vetëm tregime shkruaj, ndonjëherë edhe tejet të gjatë) ekziston një personazh me emrin "Arben Dedja", siç thashë edhe te përgjigja e pyetjes numër 5, ai mund të bëjë e të mendojë në tekst gjëra që nuk është aspak e thënë t'i ketë bërë e menduar Arben Dedja prej mishi e gjaku. Autori Arben Dedja (ai tipi prej mishi e gjaku) ka një ideologji e moral të vetin si çdo njeri në këtë botë, ideologji e moral që nuk po e gjykmë sot këtu; kurse narratori Arben Dedja është më tepër një transfigurim, në rastin "më të keq" krejt i ndryshëm nga dy Arben Dedjat e parë e në rastin "më të mirë" shumë i ndryshëm, që projektin hijen e tij mbi tekst, por ajo, si çdo hije, nuk e pengon lexuesin të ecë mbi të, ta shkelë e të shkojë tutje.

Ju, sikurse e thatë jeni kirurg. Mendoni se shtresëzimet ndjesore – emocionale që shpesh shpreh poezia janë në fakt thjesht dhe vetëm shfaqja e dukshme e diçkaje që prodhohet biologjikisht brenda zemrës apo mendjes së njeriut?




Pra, duke marrë një titull të një poezie të Luljeta Lleshanakut, a jemi ne njerëzit veç ujë dhe karbon e gjithçka ndjejmë apo përjetojmë është bashkëveprim i këtyre elementëve?

Natyrisht, shpreh mendimin tim si person, si autor dhe, duke e lidhur muhabetin me pyetjen paraardhëse, ky nuk është aspak i njëjtë me mendimin tim si... rrëfimtar. Le të themi që autori mund ta mendojë – duhet ta mendojë – ndryshe. Besoj që çdo gjë në Universin material dhe në atë të gjallë ujdhet sipas ligjeve fizike e biologjike. Shkenca është analitike dhe përpiket t'i zgjidhë pikëpyetjet e natyrës hap pas hapi. Sapo rrok një të vërtetë, të tjera të panjohura shfaqen në horizontin e ngjarjeve. Në atë fashë dritëmugët midis të vërtetës së sapozbuluar dhe të panjohurave të reja lind poezia.

Loja me ironinë, ç'vend zë në hirearkinë e tipareve që e bëjnë të veçantë dhe estetikisht të kënaqshëm një tekst, qoftë ai ese, tregim, roman...?

Zë vend lart. Por e kam ironinë edhe në jetë: është pjesë e imja. Ngela duke



e parë kithtaz (për familjarët e mi – kithtaz deri në dëshpërim) çdo sukses ose mossukses timin, me buzagaz, pa e marrë kurrë veten seriozisht. Është më tepër autoironi, pra. Kështu bëj edhe në letërsi. Letërsia e vërtetë është evokative dhe e figurshme. Dhe figura e saj bazë, kryefigura, është metafora. Tani ironinë, sikurse edhe metaforën, gjuhësia i fut në të njëjtën familje figurash retorike. Janë të dyja trope. Metafora është bashkëshoqërim i dy ideve ose realiteteve pak a shumë të largëta, aq sa vjen një çast që njëra zëvendëson tjetrën (po e thjeshtëzoi); kurse ironia don të rrëfej që ky bashkëshoqërim nuk ka arsye të qëndrojë (ose mbron diçka që shtiret sikur e shpërmiraton): është, pra, një metaforë në të kundërt. Janë dy motra, por, ndërsa metafora është e pashme dhe e edukuar; ironia është – le t'i themi – kundërpedal.

Mëtova ta them në disa forma, por tani po e them hapur: poezia juaj është ndryshe nga poezia e përgjithshme shqipe, me aq sa e njoh unë të paktën. Kush janë shkrimtarët që kanë ndikuar, jo drejtpërdrejtë dhe, mendoni se poezia juaj vjen natyrisht në letërsinë shqipe, pra si vijim a thyerje e traditës apo ka hyrë nëpërmjet një rruge tjetër, të ndryshme, të panjohur?

Po sjell këtu në ndihmë Borges-in, kur e pyetën (me njëfarë keqdashjeje), për traditën e letërsisë argjentinase. "Tradita e letërsisë argjentinase" tha, "është krejt letërsia perëndimore." Ne që shkruajmë shqip jemi, në thelb, perëndimorë. Gjuha shqipe është gjuhë indoeuropiane, hyn, pra, në atë familje gjuhësh ku është shkruar 90% e letërsisë botërore. E kemi kapur prej kohësh atë tren. S'ka kuptim ta kufizojmë vështrimin tek oborri i shtëpisë.

2. Pse Aladro Kastrioti nuk është autori i romaneve?

F. Andrea i ka trajtuar marrëdhëniet e Konicës me Aladron duke shqyrtuar revistën “Albania”, duke u mbështetur në letërkëmbimin e Konicës si dhe duke u ndalur në ndonjë burim të tërthortë për Aladron.

Këtu vlen të përmendet se kur F. Andrea ‘zbulon’ se romani “Sotiri e Mitka” është përkthyer në spanjisht dhe është në autorësinë e Juan Pedro Aladros, i futet një analize (e cila i takon më shumë fushës së hamendësimeve) siç e quan “Retrospektivë radioskopike për një portretizim të Aladro Kastriotit”.

Me sa di, Robert Elsie është i pari që e ka bërë të njohur se romani “Sotiri e Mitka” (titulli në spanjisht) është në autorësinë e Aladro Kastriotit më 2013 në librin²⁰ *A Bibliographical Dictionary of Albanian History*. Edhe pse ai është në kundërshtim me vetveten: disa vjet më herët në *History of Albanian Literature* (1995) mendon për autor të romanit një autor tjetër. Luhajtet e Elsie na bën të mendojmë se ai nuk e ka lexuar fare romanin në fjalë.

F. Andrea duke i analizuar marrëdhëniet Konica-Aladro, për të cilin ka dhënë një përshkrim të gjatë, prapëseprapë i ka kushtuar vëmendje të dhënave jashtëtekstore²¹.

Krhas pohimi kategorik të F. Andreas në studimin hyrës *Lojnia* se autori i dy romaneve është Faik Konica dhe këtë ‘s’e luan as topi!’ apo në pasthënie se autori i dy romaneve është Faik Konica alias Gjoni i Krujës, dhe kurrkush tjetër ai, prapëseprapë, do të ndalet për ta shqyrtuar më mirë çështjen e autorsisë duke e mohuar Aladro Kastriotin si autor.

Së pari, sipas F. Andreas, Aladro Kastrioti nuk mund të jetë autor i romanit “Sotiri e Mitka” për disa arsye:

- nuk ka dalur jashtë Evropës;
- nuk ka mbajtur lidhje me shqiptarët e Amerikës;
- nuk e njeh toponomastikën shqiptare.

Në lidhje me pikat a dhe c nuk jemi në një mendje me Andrean se tashmë është një fakt i njohur në historinë e letërsisë shqipe: rasti Jeronim De Rada. Edhe pse duke e pasur fatin të jetojë gjatë, ai kurrë nuk do ta ketë rast të vizitojë Shqipërinë. Është thënë nga Francesco Altimari se toponimet Arta, Janina, Suli, Salagora etj. i ka marrë nga veprat F. Pouqueville-it, konsullit francez gjatë viteve (1806-13) pranë Ali pashë Tepelenës në Janinë. Gjithashtu është vënë re nga Eqrem Çabej se De Rada i merrte personazhet (për të paraqitur turqit) nga poezia klasike indiane dhe jo ndonjë rast edhe nga bota arabe e Spanjës mesjetare.

I japim të drejtë Th. Gjokës²², i cili në këtë rast mendon ndryshe nga F. Andrea, kur thotë se: “shkrimtari për të krijuar vepra realiste me vlerë artistike i duhet në radhë të parë talent i fuqishëm dhe fantazi krijuese dhe jo njohja faktologjike e jetës, që vjen nga të jetuarit afër me ngjarjet e faktet”.

Së dyti, sipas F. Andreas, Aladro Kastrioti nuk mund të jetë autor i romanit “Martesa e Lejlës” se nuk njihet të ketë bërë: a) ndonji duel dhe b) nuk i njeh termat në latinisht.

Sa i përket pikës së parë F. Andrea shpreh dyshimin e tij lidhur me ndonji duel të Aladros: nuk e ka vënë re gjëkund në studimin e tij. Krejt ndryshe i ka dalur Konica: kur e ftojnë dhe i fton në duel.

Mbi autorësinë e romaneve “Martesa e Lejlës” dhe “Sotiri e Mitka”

ROMANET QË JANË KONSIDERUAR GABIMISHT TË FAIK KONICËS

nga Sevdai Kastrati

Vijon nga nr 189

Shtrohet pyetja: kush e ka ftuar Konicën në duel?

Lidhur me këtë kemi një përgjigje nga F. Andrea kur thotë se është ftuar në duel nga Gaspër Jakova. Ai për ta bërë të besueshëm pohimin citon edhe burimin dokumentar. Për fat të keq, burimi i cituar nuk e thotë se Gaspër Jakova-Mërturi ka ftuar në duel Faik Konicën. Përkundrazi, faktet dëshmojnë të kundërtën: Gaspër Jakova i shkruan një letër për ta botuar te “Albania” (siç na njofton Konica²³ në një letër të hapur dërguar G. Jakovës në shkurt të 1903-ës) e fton Palok Hilën me dalë në duel, kurse Shqyptarit t’ Nikopolit

që ishte pseudonimi i sivëllait tij Dom Tomë Velja ‘donte t’i çante barkun e t’i nxirrte zorrët’.

Nga ana tjetër, nuk është për t’u shpërfillur përgjigjia e Gaspër Jakovës²⁴, i cili e mohon të ketë shkruar një letër të tillë dhe se është shprehur për duelin (bejlegun) duke e konsideruar thjesht si një dikuri barbare. Gjithsesi deri më tani nuk kemi hasur në të dhënë që të na dëshmojnë vërtetësinë e këtij episodi.

Përsëri shtrohet pyetja: kë e ka ftuar Konica në duel?

Me pak fjalë, do të doja të ndalëm lidhur me duelin e F. Konicës gjatë

Kongresit të Trieshtës. Këtë njoftim Andrea e ka marrë nga shtypi huaj, pa e dhënë burimin dhe emrin e personit që Konica e kishte ftuar në duel.

Tashmë është fakt i njohur se Faik Konica është përplasur në Trieshtë, në ditën e tretë të Kongresit, me Nikollë Ivanaj. Dhe është fakt që Faik Konica është i stërvitur në artin e skermës. Siç e ka pohuar vetë, në një rast kur shkruante për termin sintaksor *kryefjalë* e ku përpigjet ta shpjegojë sa më mirë me shembuj:


«Unë jam që nga ca vjet pjesëtar i një shoqërie ku mësohet përdorimi i spatës për dylëftim; kio shoqëri ka marrë për kryefjalë: “Pro Marte et arte, d.m.th. *për artin* (se Marti ish hyji i luftës) dhe *për artin* (se dylëftimi është një mjeshtëri e hollë)²⁵».

Gjithashtu, me një rast tjetër Konica do të sqarojë lidhur me incidentin e Trieshtës. Si shkas është botimi i një kalendari nga Qerim Panariti, i cili shtrembëron të vërtetën duke thënë se në Kongresin e Trieshtës Nikollë Ivanaj thirri Faik Konicën në duel dhe ky i fundit refuzoi dhe incidenti mori fund. Faik Konica, pasi e qorton lidhur me botimin e kalendarit, i kujton se në botën e qytetëruar kalendarët botohen në fund ose në fillim të vitit e jo në mes të vitit, thotë:

«Unë kam marrë pesë vjet mësim në *fencing* ose *escrime*, dhe Z. Ivanaj s’ka as atë më të larkmën ide ç’është dueli. Nuk ish pra “fair” që të lëftoja me të. Po me që e desh puna, j’ u-luta Zt. leftënar Haessler, inxhinier n’ ushtëri t’ Austrisë, edhe Zt. Dervish Hima të veprojnë si dëshmonjësit e mij; vanë te Z. Ivanaj dhe i thanë t’ emërojë dhe ay dy dëshmonjës: emëroj ZZ. Filip Kraja dhe Mark Kakariqi. Dëshmonjësit e mij kishin pororsinë që të kërkojnë doemos luftë; dhe me që unë isha i shari dhe ashtu kisha të drejtë të zgjeth armët, u thashë që zgjeth spatën çponjëse (“épée de combat”), me të cilën jam i stërvitur. Të katër dëshmonjësit u-mblohën; dhe, pasi ata të Z. Ivanaj deklaruan që Z. Ivanaj s’kish qëllim të më shajë, vëndosnë me një zë që s’ mbetej më shkak për duel.²⁶»

Në një vend tjetër, Fotaq Andrea duke mos u pajtuar me ‘pseudo-studuesit’ e Konicës, i rikthehet edhe një herë çështjes së duelit. Lëkundjet që kishte për emrin në studimin hyrës *Lojnia* (2012?) dhe, kur pohon në pasthënie (shtator 2016) se ‘tre herë flet e fton për duel kundërshtar te Albania’, i plotëson, katër vjet më vonë, kërkime²⁷ duke zbuluar jo vetëm emrin por edhe armën që do të përdorte Konica në duel: pistoletën. Edhe për sqarimin e kësaj çështjeje ai nuk jep ndonjë burim dhe çështja e duelit bëhet tragjikomike²⁸

Sikurse dihet, Konica ishte kundër vrasjeve politike e jo më të marrë pjesë në duel me pistoletë. Ai ka protestuar për vrasjen e dhespotit të Korçës, kur për të tjerët vrasja e Fotit ishte një gjë patriotike dhe ishte për t’u lavdëruar. Ai ka protestuar për vrasjen e Niaziut nga Resnja në Vlorë dhe është e njohur zënka me Ismail Qemalin përmbi këtë pikë. Ai ka protestuar për vrasjen e Abdyl Ypit dhe u bë kundërshtar i rreptë ndaj dy grupeve që kishin gisht në vrasje. Ai ka protestuar për lirimin e Beqir Walterit nga burgu, duke kujtuar se në qoftë se ka një të drejtë për revolucion - nuk ka një të drejtë për vrasjeje. Ai ka protestuar kur kryeministër i Shqipërisë u bë një pjesëmarrës në masakrat armene më 1915-16 dhe që personi në fjalë ishte i



Letër e Faik Konicës, shkruar në anije

afërm i tij. Dhe kështu me radhë Konica vazhdon ta urrejë principin e vrasjes duke e konsideruar si poshtërsi dhe kafshëri afrikane të pusisë²⁹.

Me këtë rast po sjell një shembull nga kujtimet e Konicës, kur filologjia³⁰ praktikohet me sistemin e pistoletës:

«Pata një bisedim të çuditshëm me një “filolog” gegë disa vjet më parë. Mundohesha t’i jap të kuptojë se toskërishtia thotë një *vit*, dy *vjet*, - kur gegërishtia thotë një *vjet*, dy *vjet*. “Jo, zotni!” ulërinte filologu i maleve, “nuk â punë. *Vit* nuk âsht shqyyp. *Vit* s’thoon Shqyptart, *vit* thoon Gogt.” (“Gogë” në Gegëri u thonë Orthodoxëve dhe veçan Vllehve.) Më në funt që t’â qetësoj i thashë se nuk interesohe me të tilla çështje gjuhe dhe s’është çudi të ketë të drejtë. Po butësia ime, në vënt që t’i ftohë gjakun, j’â ndezi më tepër. Nxori koburen, e vuri në tryezë pranë dorës tij, dhe ulërinte me më tepër forcë: “Pasha Zotin, s’ke me mâ hanger hakën! *Vit* nuk â shqyyp. A po e njeft gabimin t’ann, more Zotni?” Dhe unë, bindur nga forca e argumenteve të këtij eruditi, e njoha me gëzim edhe u-ngrijta dhe ika.»


Të gjithë studiuesit e Konicës pajtohen një zëri në një pikë: Faiku ynë nuk qe njeri i pistoletës. Armë të vetme kishte penën dhe ka ditur si ta përdorë atë si askurrkush tjetër në luftën e penave. I papërballueshëm në polemikë dhe kundërshtarët në pamundësi që t’i përgjigjen Faikut jo rrallëherë i mohojnë shqiptarësinë: *Gaspër Jakova e quante me prejardhje vllahe, kurse Mehdi Frashëri e bën grek mysliman. Ndërkaq Shuk Gurakuqi³¹ në një letër që botohet në gazetën “Dielli” më 23 qershor 1925 ndër të tjera i shkruan se “e vetmja përgjigje per ty asht dajaku, i cili nuk do të kursehet per në kjoftë se do të qesin ndonji herë rasti nder këto ana”.*

Sa i përket pikës së dytë F. Andrea është i mendimit se “Martesa e Leilës” nuk mund të jetë në autorsinë e Aladros se vetëm një Faik di të përdorë termat latinisht. Kemi të bëjmë për një term *errata* që ndodhet në fund të librit për gabimet e shtypit. Ai pohon gabimisht se romani “Martesa e Lejlës” mbyllet me një faqe “Errata”. Në të vërtetë faqja “Errata” ndodhet në fund të librit “Sotiri e Mitka” dhe nuk janë gjashtë gabime siç pohon Andrea, por janë shtatë. Në fakt nuk janë vënë në dukje të gjitha gabimet, se gabime të këtilla ka pasur.

Veçse për këtë hipotezë nuk jep tjetër argument përpos një trillimi letrar kinse Aladro Kastrioti, para se t’i botonte romanet, ia ka dhënë bocat për t’i korrigjuar Faik Konicës. Po le të lëjmë mënjane pohimin e Andreas se në vend që ta ndihmojë autorsinë e ndërlikon më shumë, sepse ai përkujdeset më shumë për *side issues*.

Pa dashur të ndalëm më gjatë mbi këtë pikë, aq sa nuk vihet në dyshim mosnjohja e një termi që mund ta dijë gjithëkush e jo më Aladro Kastrioti, i cili duke e pasur parasysh faktin se ai zotëronte një bibliotekë me rreth 13 mijë libra më 1902³². Me këtë rast, dua të saktësoj shkurt një fakt: në *Bibliographie albanaise* [Bibliografia shqipe] të Emil Legrandit kemi 89 libra (në gjuhë të ndryshme) të cituara nga biblioteka e Aladro Kastriotit që fillojnë nga viti 1474 e gjer më 1899 dhe kemi vetëm një libër nga biblioteka e Thrank Spirobegut.

Këtu është me interes të thuhet se F. Andrea e nënvlerëson rolin e Faik Konicës me Aladro Kastriotin në disa gjëra të



përbashkëta ndërmjet tyre. Për hir të së vërtetës, duhet të themi se për herë të parë: a) fabrikohet flamuri kombëtar, b) me propozimin e Konicës³³ themelohet çmimi “Skënderbeg” dhe pa dyshim, me propozimin e tij i jipet çmimi prej 1000 frangash shkrimtarit Ndoc Nikajt si dhe c) me shpenzimet e Aladros botohet Karta Dheshkrimtare e Shqipërisë [harta gjeografike e Shqipërisë] në Institutin e gjeografit të famshëm Élisé Reclus-it në Bruksel.

Në fund të këtij shqyrtimi na mbetet të përmendim studiuesin Agron Alibali, autor i librit “Faik Konica – dritëhijet e një diplomati” Tiranë 2016, i cili pati mirësinë të verë në dispozicion tonë letërkëmbimin me Bibliotekën e Katalonjës ku si autor të romaneve “Le mariage de Leila” dhe “Sotiri e Mitka” nuk është Jean de Kroia, por bashkëshortja e Aladro Kastriotit. Po kështu kemi vënë re edhe në revistën³⁴ “Biblioteconomía” të Barcelonës që gabimisht romanet konsiderohen të ‘princeshësh’ Kastrioti.

Koha dhe vendi i shkrimit

Një nga hipotezat e dyshimta të Fotaq Andreas është edhe koha se kur janë shkruar romanet “Martesa e Leilës” dhe “Sotiri e Mitka”. Sipas tij romanet janë shkruar më 1909, sepse në këtë vit ka lindur mbesa e

Faik Konicës, Leila Konica. Ai erdhi në këtë përfundim mbasi u takua me Sherif Delvinën, i cili pati mirësinë t’i dhurojë pemën gjenealogjike të familjes Konica. Edhe pse Leila, e bija e Mehmet Konicës nuk ka lindur më 1909 (siç do ta shohim më poshtë) do të jetë jo vetëm kryepersonazhi i romanit *Martesa e Leilës*, por ajo do të jetë çelësi i artë mbi zbërthimin e enigmës së romanit i takojnë katërçipërisht Konicës. Po kështu, edhe studiuesi Thanasi Gjika³⁵ është i të njëjtit mendim se romanet janë shkruar më 1909. Në të vërtetë, në një rast tjetër kur Fotaq Andrea më ishte drejtuar për një mendim, mendonte se romanet ishin shkruar në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1910.

F. Andrea nuk i përmbahet gjithmonë teorisë së tij. Në një sqarim tjetër që na jep Andrea në studimin *Lojnia* pohon se romanet u shkruan më 1909 për dy arsye dhe rreth një emri: e para martesa e piktorit Theohtar Gjinit që kishte ndodhur tre vjet më parë, nga e cila do të frymëzohet Faik Konica për të shkruar romanin *Martesa e Leilës* dhe e dyta se në Paris më 1909 është themeluar Shoqëria e Shqiptarëve të Parisit me kryetar Theohtar Gjinin. Kështu pra, Andrea arrin në përfundim:

Pikërisht rrethana të tilla konkrete duhet ta kenë nxitur Faik Konicën të ulëj e të shkruante romanet më 1909.

Për sa u takon të dhënave që na jep

lidhur me tezën e dytë F. Andrea nuk është në dijeni se kur është themeluar Shoqëria e Shqiptarëve të Parisit. Në këtë rast do të ndalemi t’i sqarojmë lexuesit e gazetës *Ex Libris* se më 26 nëntor 1909 botohet një shënim për një letër që kishte ardhur në redaksinë e gazetës *Dielli* nga Parisi (5, rue *Pajou*) të nënshkruar nga “Th. Konçeli”, i cili bën me dije se është themeluar atje një shoqëri me emrin “Shoqëria e Shqiptarëve Parisit”. Dy javë më pas, më 10 dhjetor, në gazetën *Dielli* botohet shkrimi *Një artist shqipëtar* ku thuhet se Theohtar Ghini Contechelly (një nga fytyrat më të kulluara të lëvizjes shqiptare dhe miku i vjetër i Faik Konicës) u zgjodh kryetar i Shoqërisë së Shqiptarëve të Parisit.

Në të vërtetë Fotaq Andrea këtë numër të gazetës “Dielli” (Numrin 37) e ka cituar në studimin e tij *Lojnia* (f. 58). Edhe pse në bazë të dhënave që parashtruar më lart, vijmë në përfundim se Fotaq Andrea nuk e ka pasur mundësinë ta ketë në dispozicion gazetën “Dielli”, për arsye se ka mospërputhje me kufirin kohor dhe hapësinor që i ka caktuar vetë në studimin e tij *Lojnia*. Në fakt, ai është mbështetur vetëm në një burim: në studimin e Ferid Hudhrit mbi piktorin Theohtar Gjini³⁶. Edhe pse është burimi kryesor i tij, në një rast bën sikur nuk pajtohet lidhur me vitin e martesës së piktorit Th. Gjini, sepse ka një burim ‘të pakonfirmuar’ se martesa ka ndodhur më 1908. Megjithatë edhe ky shpjegim do të harrohet, ashtu siç harrohen edhe dasmat mbas tri ditësh³⁷.

Sa i përket vendit se ku janë shkruar romanet F. Andrea shtron ca pyetje duke i dhënë njëkohësisht dhe përgjigje:

A t’i ketë shkruar Konica këto romane nëpër det, drejt vajtjes për në Korfuz dhe në kohën e pushimit pranë nënës së tij të dashur? Apo mos vallë i kishte përfunduar tashmë që në Bruksel krahas Albania-s dhe ia sillte sagllam sallam Aldros.

Është fakt se Faik Konica ka shkruar në anije dhe shkruesi i këtyre radhëve e ka vënë re në disa raste. Kështu p.sh. kur udhëtonte nga Doveri i Anglisë për në Ostend të Belgjikës në anijen “Princesse Clémentine” shkruan artikullin “Reziku i afërm i Shqipëtarëve muhamedanë” dhe kur udhëtonte nga New Yorku për në Queenstown të Irlandës në anijen “Baltic” shkruan artikullin “Mbretëria Shqipëtare edhe paanësia e saj” që mban datën 27 dhjetor 1912.

Po kështu është fakt se kur kemi të bëjmë me ndonji vepër letrare, Faik Konica e shkruante kryesisht natën. Vetë Konica e pohonte më 30 janar 1926 se “jam nga ata që për fat të zi punoj më mirë natën”.

Lidhur me pyetjen e parë kemi një përgjigje, siç shkruan vetë Konica³⁸ në kujtimet e tij:

«Shkoja, në verë të fundit, anës detit të Çamërisë. Lundra që më shpinte qëndroi në shumë vise, sicilido ndër të cilat, më zgjonte kujtime historiake: Preveza, ku triumfuan armët e Augustit kundër Antonit; ku u-bënë aqë lufta në kohë të pastajme, si ajo e ushtarëve të Bonapartit me ata t’ Ali pashë Tepelenës; Parga, edhe plot me madhështin’ e Venedikut. Po bukuria e vendit, majmësia dhe begatia naturale e dheut më bëjtin të çuditëm dhe të harroj kujtimet e vjetëra. Ç’kopsht i rrallë munt të bëhet Çamëria, kur të punohet dhe të ndërtohet, me kujdes dhe me regull! Dhe si munt t’ua lëmë Grekëve një pjesë të tillë të Shqipërisë».

Përsa i përket pyetjes se romanet janë shkruar 'në kohën e pushimit pranë nënës së tij të dashur' do ta hedhim poshtë si hipotezë. Lidhur me këtë do të veçojmë një letër të Faik Konicës dërguar At Pashk Bardhit në Arbënesh (it. Borgo Erizzo, kr. Arbanas) të Zarës më 19 qershor 1902. Nga kjo letër e famshme Bardhi³⁹ na zbulon aspekte të rëndësishme të marrëdhënieve që Konica mbajti me nënën:

«Më vjen keq për nënë t'ime, për plakën e mjerë që dhietë vjetë që po më pret kot në lotë e hidhërimë, e që ndofta kurrë më s'ka për të më parë».

Përveç këtyre që përmenda shkurt më lart, do të veçojmë një nga takimet që pati Konica në Korfuz. Ai do të takojë (ndoshta për herë të parë) udhëheqësin e Çamërisë, Musa Demin e lavdishëm, për të cilin (17 vjet më vonë) do të shkruajë: "një shqiptar i kthjelltë që s'ka kursyer asnjë rrezik për veten e tij, ka pësuar dëme, ka ngrënë burgje, por ka mbetur i patundur. Një njeri si ky duhet të nderohet jo vetëm nga ne, por edhe nga grekët me karakter."

Siç është tashmë e njohur, Konica do të qëndrojë në Korfuz pranë nënës rreth një muaj. Me sa e di Jup Kastrati është i pari që ka thënë se "në korrik të këtij viti [1909] Faiku shkoi në Korfuz për t'ua takuar me prindërit e tij dhe prej andej u nis për në Amerikë⁴⁰". Gjithashtu Konica do të qëndrojë një javë pranë vëllait (Mehmetit) në Artë të Çamërisë. Aty do të takohet edhe me disa shqiptarë që ishin pronarë tokash në fushën e Llorit.

Me këtë rast do të kujtoj se F. Andrea pohon se Konica ishte në Korfuz në fund të gushtit. Është për të theksuar se Andrea shpeshherë i ngatërron datat:

a) ngatërron vitin e zbulimit të romaneve (ka thënë më parë 2010, i këtij mendimi është edhe Th. Gjika) e zhvendos një vit më vonë në studimin hyrës *Lojnia*, kurse në një shkrim tjetër *Zbulim i rrallë në Letrat koniciane*⁴¹ e zhvendos në kapërcyell të viteve 2011-2012;

b) ngatërron vitin e shkrimit (shkruesit të këtyre radhëve i ka thënë se janë shkruar 1910) kurse Th. Gjika (i mbështetur në mendimet e Andreas) e zhvendos një vit më parë dhe në një rast tjetër dy vjet më parë;


c) ngatërron vitin pagëzimit të Faik Konicës në 'katolik' (ka thënë se pagëzimi ka ndodhur më 1895) dhe më vonë është i mendimet⁴² se është pagëzuar një vit më parë, domethënë viti 1894 dhe

d) ai daton gabimisht edhe studimin hyrës *Lojnia* gjoja se është përfunduar më 2012.

Në fund është me interes të thuhet, siç e cekëm pak më lart, sipas F. Andreas romanet janë përfunduar në Bruksel 'dhe ia sillte sagllam sallam Aldros'. Është një hipotezë e pazakontë dhe e pabesueshme, duket sikur çudi, edhe vetë Andrea zor se mund ta besojë. Dimë, se Konica ka jetuar në Bruksel deri më 1902, *d.m.th. sipas një* shkresë të datës 16 gusht 1902⁴³ njoftohet se ai nuk jetonte më në këtë qytet. Edhe ku pohim F. Andreas për të ndriçuar kohën dhe vendin e shkrimit të romaneve do të ngelet si gjurmë në akull.

Shënime

³⁹Don Aladro was author of a short story written in French on an Albanian theme. This 56-page work of no particular literary



merit was translated into Spanish under the title *Sotir y Mitka* (Sotir and Mitka), Jerz 1912". Robert Elsie: *A Bibliographical Dictionary of Albanian History*, "I.B.Tauris & Cp. Ltd.", London, 2013, f. 7.

²¹Lidhur me këtë shih F. Andrea: *Retrospektivë radioskopike për një portretizim të Aladro Kastriotit*, f. 28-29: "Pra, ky, Aladro, që edhe për të hartuar një letër të thjeshtë përdorte sekretar, veç kur do na shkruaka ngeshëm, vite më pas, aty nga viti 1909 dy libra, shi në kulmin e depresionit – siç do ta shohim më pas -, dhe të manipulimeve të tij të pareshtura për t'ia hipur kaluarthi fronit të Shqipërisë! E jo dy libra të karakterit politik siç do duhej t'i kishte hije "personalitetit të tij shoqëror", por dy romane të mira në frëngjisht me tematikë të mirëfilltë shqiptare!"

²²Thanas Gjika, *Faik Konica – romancier i parë realist i letërisë sonë* (Mbi realizmin e diptikut romanor *Martesa e Lejlës, Sotiri dhe Mitka*), "Illyria", 25 nëntor – 8 dhjetor 2016, f. 72.

²³Faik Konica, *Letrë e çilun Gaspër Jakovës*, "Albania", Londër, 1903, nr. 2.

²⁴Shih. G. I. M.: *Faik-derri*, "Laimtari i Shqypëniës", Romë, 15 dhjetor 1904, nr. 7, f. 46.

²⁵Shih [Faik Konica]: *Ç'është një "Kryefjalë"?* "Albania", Londër, 1906, nr. 5, f. 90.

²⁶Shih Faik Konica: *Një kalendar, një duel, dhe një palaço*, "Dielli", Boston, 18 prill 1923, nr. 2575 (118), f. 5.

²⁷Shih Fotaq Andrea, *Njeriu Faik me përkushtim Shqipërinë modern, "Dielli" online 27 prill 2020*.

²⁸I pari, që e ka vënë në dukje çështjen e duelit si komedi, ishte Rexhep Qosja në veprën e vitit 1972 me titull *Asdreni: jeta dhe vepra e tij*, ku thotë: "Pas përfundimit të Kongresit të Trieshtës, në të cilin ishte luajtur një komedi e vogël kur Nikollë Ivanaj e kishte ftuar në dyluftim Faik Konicën".

²⁹Shih Faik Konica, *Për stërvitjen morale dhe sociale të Popullit: një shoqëri kriminale*,

Arkivi Qendror i Shtetit (Tiranë) – "Fondi Faik Konica 12, dosja 12", f. 1-16; F. K.: *Federata "Vatra" dhe Federata e Madhe "Atdheu"*. "Dielli", 3 qershor 1922, nr. 2451 (34), f. 4-5; Faik Konica, *Themelet e shtetit dhe Beqir Valteri*, "Dielli", 2 gusht 1924, nr. 2746 (289), f. 5.

³⁰Faik Konica, *Pata një bisedim të çuditshëm*, "Dielli", Boston, 14 prill 1923, nr. 2574 (117), f. 4.

³¹Ia vlen të lexohet letra e plotë e Sh. Gurakuqit që *dërgohet nga Roma dhe mban datën 8 qershor 1925: Shum, prej atyne qi të kanë njohtë, thojshin se ti je një nieri i poshtun, por unë nuk do t'a kishem mendue kurr se poshtersija e yte mbërrinjë në një shkallë aq të qelbun, sa me të bam me qitun jarg prej gojet tue i u shpifun, me një mënyrë të çuditshme, një të vdekunit, i cili e shkrini të gjithë jetën për vend të vet. Nuk e paske harruem shkopin e Gurakuqit, e duket se paska kenun aq i fortë, sa po t'u krueka shpina gjithnji. Nji nieri do ta kish hjekun mundim të mathme i trillue të gjitha ato fjalë të shamesh, shpifjesh e shkarkimesh kunder nji atdhetari aq të math e të njohtun si kje Luigj Gurakuqi, por për ty do të jet kenun puna e lehtë, pse, si duket, kur shkruen ven para nji pasqyrë, dhe aty sheh e pershkruen kualitetet t'ua.*

Nji turp ma i math qi e shton poshtersin t'ande asht se ti guxon me vuem goje kunder Gurakuqit sot qi asht i vdekun, por nuk asht çudi, pse nji njeri i poshtern e i qelbun si ti nuk mund ta dij se çka asht burrnija. Kur në Parlament shqiptar nji deputet nisi të flasë kundër tejet, Gurakuqi i ngratë i ndaloj fjalën tue i thanun kryetarit se nuk ishte mirë të flitej kunder nji nieri qi nuk ishte present për të mprojtë veten. Ti por nuk meritojshe mprojtje, sikurse nuk meriton as përgjigje: e vetmja përgjigje per ty asht dajaku, i cili nuk do të kursethet për në kjoftë se do të qesin ndonji herë rasti nder këto ana.

³²Shukri Rahmi: *Kush ka qenë Aladro Kastrioti?* "Jehona", Shkup, 1966, nr. 4, f. 72.

³³Siç mund të shihet nga një letër që F.

Konica i ka dërguar V. Dodanit që mban datën 29 nëntor 1901 ku ndër të tjera thotë: "Për Princin e Aladros që më pyete munt të të shiguronj se është njeri shumë i ndershëm e më duket se qëllimet e tija janë të lartra e të bukura. Është mirë të këmbesh edhe zotrote letra me të. Në do shkruaji një përgëzim për emrin Skënderbeg që ka themeluar, i cili i-a dha sivjet një bashkëpunëtori t'im nga Gegëria që ka shtypur disa libra. Princi i Aladros dha edhe disa mijëra frënga për një kartë dheshkrimtare të Shqipërisë që do të dalë në dritë në fund të Kalëndorit, është gati të prishë edhe të tjera të holla, po kam frikë se mos e lodhin së rjepuri ca zuzarë të pa-turpshëm", në: Vissar Dodani, *Memoriet e mija: kujtime nga shvillimet e para e rilindjes të kombit shqipëtar ndë Bukuresht*, Shtypshkronja "Albania", Constantza, 1930, f. 98.

³⁴Shih "Biblioteconomía", Barcelonë, Enero-Junio 1956, nr. 43, f. 111.

³⁵Thanas Gjika, *Mosdënimi i kriminës është krim i ri*, Botimet Omsca-1, Tiranë, 2016, f. 225.

³⁶Ferid Hudhri, *Piktori mëmëdhetar Theohar Gjini*, në: *Arti i rilindjes shqiptare (1883-1945)*, "Onufri", Tiranë 200, f. 155-165.

³⁷Rexhep Qosja, *Kritika letrare*, "Rilindja", Prishtinë, 1969, f. 191.

³⁸Shih Faik Konica, *Çamët dhe Shqipëtarësia*, "Dielli", Boston, 14 janar, 1910, nr. 42, f. 2.

³⁹At Pashk Bardhi, Faik Konica, "Hylli i dritës", Shkodër, nanduer-dhetuer 1942, nr. 11-12, f. 476.

⁴⁰Jup Kastrati, *Faik Konica*, "Gjonlekaj Publishing Company", New York, 1995, f. 59.

⁴¹Shih Fotaq Andrea, *Zbulim i rrallë në Letrat koniciane* (Faik Konica alias Gjoni i Krudës me dy romane të reja, të panjohura deri më sot, "Martesa e Lejlës" – "Sotiri dhe Mitka"), "Illyria", 28 nëntor 2016, f. 51

⁴²Fotaq Andrea, *po aty*.

⁴³Isak Shema, *Veprimtaria e Faik Konicës (Bruxelles 1896-1902)*, "Dituria 2015", Prishtinë 2019, f. 11.

Dua të ndaj me ju disa mendime modeste për librin monografik të autorit Fatmir Toçi, "Arbëreshët, midis realitetit dhe mitit".

Dëshiroj të pohoj qysh në fillim se, ky është një libër i rëndësishëm, me vlerë, për arsye që lidhen me të në vetvete, pastaj me kontekstin e tij të sotëm të leximit. Është traditë e hershme filologjike që, kur flitet për *literaturën*, e kuptuar kjo e fundit me një lloj veneracioni ndaj traditës, të jepen dy arsye, që e bëjnë një tekst pjesë të një fondi të pashmangshëm për pasardhësit.

Në fillim përmendet struktura e librit të mundshëm. Pasuria, plotmëria, aftësia e saj për të rrokur një rend të ndërlukur çështjesh, përmes një kodi, që është në gjendje të përvetësojë kuptime të thella e t'i dëshmojë ato gjuhësisht me gjallëri e me forcë. Tekste të tilla, pa marrë parasysh dallimet gjinore apo drejtimet tematike mbrojnë besnikërisht dijen dhe trashëgiminë. Libri i z. Toçi në këtë pikëpamje, pra, në rrafshin strukturor, përfaqëson një shembull të mirë, në hullinë e disa librave me vlerë, të botuar sidomos në lëmë të gjurmëve albanologjike këto kohë.

Nuk mund të mos vërehet një organizim me të vërtetë funksional i tekstit: pjesa e parë – **Arbëreshët një histori mbijetese**, është një parashtrim i imët historik, kronologjik e zhvillimeve për bashkësinë arbëreshe në të gjithë përmasën e vet sociale, kulturore, ekonomike, psikologjike e morale; pjesa e dytë – **Ngulimet arbëreshe** është një hulumtim skrupuloz në hapësirën e kohës së sipërmendur, si truall që i bën të mundshme e konkrete, karakteristikat identitare të ngulimeve e bashkësive të atyshme. Kreu II, i pjesës së dytë, mbi **Ndarjen kishtare** e bën premisën deskriptive të funksionit **kohë-hapësirë** të qënies së arbëreshëve, të fitojë vlerën e argumentit antropologjik, çka, për tipologjinë e kësaj vepre është me të vërtetë sofistifikim për t'u lakmuar.

Pjesa e tretë – **Pasqyrat përmbledhëse** - e kryen, e mbyll ecurinë e këtij rrethi (do ta quaja hermeneutik) me elementin etik të punës së mirëfilltë, të paraqitjes së fakteve. Teksti merr përsipër të ndërtojë, të përgatisë, të bëjë të mundshme edhe një perspektivë tjetër përmes këtij *komentari*, t'i japë një lloj lirie lexuesit profesionist, i cili mund t'i përdorë të dhënat, qoftë dhe jashtë vullnetit interpretativ të autorit.

Me një fjalë, kujtdo që do të bëjë kritikën e këtij teksti, i është dorëzuar jo vetëm kodi i tij metodologjik, por edhe mundësia e riinterpretimit, madje e rindërtimit të tij. Njëlloj ndershmërie intelektuale në stilin kritik të Stanley Fishit.

Në tërësi, për strukturën, ky tekst shënon një arritje të rëndësishme në marrëdhënie me vëllimin, ndërlikimin e vështirësinë e materialit të përpunuar.

Sa i takon kontekstin të sotëm të leximit, sërish në hullinë e filologjisë tradicionale, **një libër i rëndësishëm** është i tillë, para së gjithash, sepse mund të ushtrojë një ndikim domethënës mbi lexuesit e tij, një ndikim të provuar në procesin mendor e shpirtëror të kohës.

Jo për të mbetur te hermeneutika, por më takon të jap shpjegime, përse sipas meje, dhe jo vetëm në frymën e gjykimit akademik apo teorik, ky libër e mbart aftësinë e të qenit ndikues.

Ky libër është i rëndësishëm në fillim, për preken e çështjeve që lidhen me identitetin e shqiptarëve, si kontribut në një rrethanë veçanërisht të posaçme receptimi, lokale e globale;

- është i rëndësishëm për çështje që lidhen me interpretimin e tij në një sistem vlerash identitare, përmes një pragmatike, do ta quaja të njëjtësimit kulturor për shqiptarët;

- së fundi, rëndësia e këtij libri qëndron te të dhënat e drejtpërdrejta, mbi ide, dukuri, gjendje, personalitete që e kanë populluar botën arbëreshe si standard që do të printe, nxiste e mbështeste projektin politik shqiptar në fund të shekullit XIX. Këtu unë veçoj kuptimin që ka De Rades në atë rrethanë.

Këto kohë, siç është e pritshme, çështjet e identitetit janë rikthyer, jo vetëm si pasojë e një epoke postmoderne, që ka relativizuar

DISA MENDIME PËR LIBRIN "ARBËRESHËT – MIDIS REALITETIT DHE MITIT" TË AUTORIT FATMIR TOÇI

nga Prof. Ermir Xhindi

gjithçka, por edhe për shkak të krisjeve të brendshme që e kanë shoqëruar të kuptuarin tonë mbi identitetin.

Mjaft të sjell në vëmendje debatin e vështirë të 2006-ës, pikëpamjet e Kadaresë, të prof. Qosjes e posaçërisht mes shumë të tjerëve, ndërhyrjen e prof. Kristo Frashërit. Libri i Fatmirit, përmes përmasës së vet informuese, hyn në atë pragmatikë leximi, duke na ndihmuar për një qasje më të kujdesshme, përkatësisht mbi premisën e një kombëtarizmi laik, një identiteti të iniciuar **në kontakt me perëndimin**, që niste si i tillë, në fillim, në koloninë e arbëreshëve të Italisë dhe që nuk ishte spekulim mekanicist i elitave të rilindjes, por fundi i një procesi mendor, shpirtëror, ideologjik e moral.

Debati mbi identitetin sigurisht mbetet i gjallë. Letërsia e ka parandjerë dhe në mënyrën e vet e ka dëshmuar këtë mospajtim. Njëlloj letërsia e identitetit që ka kohë që shkruhet e botohet në Shqipëri në shtetërore, në Kosovë, Maqedoni apo diasporë prej fillimeve të '90-ës, rreket t'i përgjigjet pyetjes: ç'jemi? Nga vijmë? Ç'të ardhme na përgatit e shkuara?

Jam i prirur ta shoh këtë formante në versionin kulturor, përkatësisht siç e përkufizon Preston në një nga variantet e termit kulturë sipas tij: "*pra, si mënyrë e të*

jetuarit, si sferë e veprimtarive praktike të shumëllojshme, një lloj praxis-i që shënjon tërësi idesh të mishëruara në rutinën e përditshme dhe në institutet e organizimit të familjes, e që shënjon vetëdijen tone mbi vetveten".

Natyrisht, që kjo tingëllon disi e paqartë, por në bindjen time libra si ky, të prof. Xhufit, të prof. Cekës, të prof. Sinanit etj., ndihmojnë jashtëzakonisht për të kuptuar natyrën e proceseve historike dhe të pasojave përkatëse mbi identitetin. Me këtë dua të them, se kjo nuk është thjesht çështje e empatisë individuale të të interesuarve, por një horizont i domosdoshëm interpretimi.

Përfitoj nga rasti të theksoj se ka ardhur koha, në mos jemi pas, me përkthimin e punëve të rëndësishme të përgjithësisht filologëve, të gjuhëtarëve, historianëve, antropologëve e etnologëve shqiptarë. Me gjithë nderimin për literaturën e huaj mbi ne, në jo pak raste bëhem pre situatash të çuditshme, pohimesh e tezash absurde – *opinionit duhet të dëgjojë shqiptarët në gjuhë të huaj*. Kam bindjen se me pak përpjekje mund të kapërcehet kompleksi ynë i inferioritetit edhe këtu.

Sa i takon çështjes së interpretimit në sistem, sërish për çështjet e identitetit, ky libër sjell një ndihmë të mirë, krahu një

aradhe veprash mbi arbëreshët e Italisë, natyrisht, si tekst më i përimtuar, më i përditësuar. E theksoj këtë element, pasi dua të veçoj natyrën institucionale të proceseve që ndodhen në koloninë e Arbëreshëve të Italisë përgjatë një shtrirje kohore relativisht të gjatë dhe krej pangjashmërisht me çdo entitet tjetër kulturor e gjuhësor shqiptar të kohës. Nuk është rastësi që mitet e Motit të madh, Atdheut, Skënderbeut, të krijuar së pari ndër arbëreshët e Italisë, ngjiten si elemente njëjtësues e përbashkues për shqiptarët gjatë shek. XIX.

Libri ka meritën e padiskutueshme të argumentit se gjetjet ideologjike gjatë rilindjes kombëtare të shqiptarëve, nuk ishin platforma eksperimentale të huazuara, përkundrazi. Besoj se një sistem, në kuptimin që prof. Qosja i jep bashkësisë së ngulimeve shqiptare gjatë shek. XIX, është konteksti i përshtatshëm i interpretimit për këtë libër, dhe ku, ai merr vlerë të posaçme. Në këtë kuptim mund t'u përgjigjem edhe spekulimeve të sotme mbi identitetin, që priren të fotografojnë të pjesshmen për shqiptarët, në kohë në hapësirë. Arbëreshët dalin nga rutina mitologjike e interpretimit, për t'u përgjigjur realitetit.

Lidhur me De Radën. Në hyrje të vëllimit të parë të Opera Omnia (I Canti Premilosaiçi), i respektuari profesor Françesko Altimari, ndër të tjera, kur flet për shtysën e botimit të plotë të De Radës e përkufion kështu: "*bëhet fjalë për kthimin e një detyrimi historik ndaj Atij (me a të madhe) që dha një dëshmi të fortë vetjake për mbrojtjen e njohjen, në Itali e në Evropë, të të drejtave të njerëzve të tij, të vendit të tij të vjetër të origjinës, Shqipërisë. ... ishin, veprat e tij, fryte mundimesh të renda vetjake, që bëri të ndihet në diasporë e në Ballkan, në rrethet intelektuale italiane e evropiane, zëri i një kombi deri atëherë i mohuar...*"

Libri i Z. Toçi e kurorëzon kulturën arbëreshe përmes De Radës, me këtë mision. Duket se aty mbillet fara e një letërsie që me të drejtë Qosja e çmon si të vetmin institucion të përbashkët në jetën e shqiptarëve të shek. XIX dhe që do të vijojë të bëjë mecenatin e identitetit shqiptar.

Korniza kulturore, institucionale e arbëreshëve i dha letërsisë shqipe, përmes De Radës e te tjerëve, autoritetin e pazakontë që ajo ka pasur deri vonë, në jetën e shqiptarëve. Edhe kur Shqipëria e pati shtetin, institucionet, jetën e mirëfilltë shoqërore, letërsia mbeti fusha ku identiteti ynë do të shqiptohej e dokumentohej me gjithë kompleksitetin e tij.

Në pikëpamje historiko-letrare e përgjithësisht kulturologjike, dominantet ideologjike, integralet poetike strukturore e kuptimore me origjinë arbëreshe ose italo-shqiptare në letërsinë tonë kanë rëndësi të madhe, sepse në gjykimin tim, ishin njëkohësisht rezultat i dinamikave deri diku normale e i proceseve deri-diku konservuese për identitetin shqiptar.

Besoj se ky libër, i lexuar në këtë perspektivë, pra mbi këtë korpus të dhënash e mbi këtë hermeneutikë kuptimore, ka një potencial shërues për një kulturë si e jona që gëlon nga konfliktet, paqartësitë e të pavërtetat. Ai mbështet tezën e vijimësisë institucionale për identitetin e shqiptarëve, këto kohë kur globalizmi po e paketon kulturën njëlloj si salsicet dhe kur kitchi urban i imitimit të historisë po gllabëron ato pak vlera të konservuara që na kanë mbetur, ndaç shpirtërore e ndaç materiale.

Nëse gjithë sa thashë e bëjnë këtë libër të rëndësishëm me standardin e filologjisë tradicionale, për filologjinë moderne e bëjnë të detyrueshëm për lexim, një libër punë të domosdoshëm.

Për ta mbyllur,

Unë fola kryesisht për tekstin e për ne si lexues, por shkaku është padyshim autori, Fatmiri. Me këtë vepër ai e ka shënuar personalitetin e tij në mënyrë domethënëse.

Ky libër është fryt i një pune të madhe, i një vullneti moral dhe i një vetëdije intelektuale, kombëtare e qytetare, dëshmi e një pune të bërë me dashuri e që meriton mirënjohjen tonë.

FATMIR TOÇI

ARBËRESHËT MIDIS REALITETIT DHE MITIT

Vështrim i shkurtër historiko-kulturor



BOTIMET TOENA

1.

Emrin e Ndue Pal Shllakut e “takova” për herë të parë si aktor amator në Shoqërinë Antoniane, në librin me kujtime “100 vjet teatër në Shkodër” (1879 – 1979) të autorit Andrea Skanjeti. Më vonë mësova se aktori Shllaku kishte edhe disa interpretime të tjera në skenat teatrore të kësaj shoqërie, ku kishte realizuar disa personazhe. Plotësime të mëtejshme të biografisë artistike të Ndue Pal Shllakut i gjeta, më vonë, edhe në shkrimet e studimet e aktorit Gjon Karma si dhe në arkivin e njohësit të historisë së teatrit të Shkodrës, Gjush Sheldia.

Nga studiuesit mësojmë se Ndue Pal Shllaku hyri në Shoqërinë Antoniane rreth viteve 1935 – 1936. Si interpretues në fushën e aktrimit lë shenjë në komedinë “Shjor Puci” (komedi në tre akte) me autor Zef Gianini, përkthyer nga Dom Lazër Shantoja. Është për t’u përmendur se në këtë shfaqje ishte i pranishëm dhe poeti Atë Gjergj Fishta. Më vonë, dhe është qershori i vitit 1941, kur Ndue Pal Shllaku mban një fjalim në përkujtim të këtij poeti të shquar. Gjithashtu, Ndueja interpretoi edhe në dramën me tre akte “Kur orët lajmojnë” të Ernest Koliqit, (të cilën vetë e përpunoi dhe vetë luajti personazhin e Gegë Markut); në farsën “Loja e mijvet, gazmendi i dacave” (komedi, përpunuar nga Çesk Vuksani), interpretoi rolin e Sulejmanit. Jo vetëm kaq, po Ndueja, te “Sekretari esnafë” (komedi me një akt), luajti rolin e Palushit. Në muajin prill të vitit 1941 luan personazhin kryesor në tragjedinë me pesë akte “Thomas Moore” të Silvio Pelicës (dramë e përkthyer nga padër Agustin Ashiku), e cila si premierë u dha në vitin 1941. U shfaq katër herë me 1200 spektatorë. Ndërsa në tragjedinë me një akt “Një natë tragjike” (dramatizim nga Ndue Pal Shllaku) mbështetur në kapitullin “Gjak Romanjolas”, shkëputur nga libri “Zemra” i E. De Amicis; vetë Ndueja luajti rolin e plakut (gjyshit). Po në këtë muaj me rastin e festës së kësaj shoqërie, interpreton në komedinë me një akt “Mnistari” (përkthyer nga italishtja e përshtatur në shqip nga At Silvestër Hila). Këtu luan rolin e doktorit. Më pas interpretoi në komedinë me një akt “Gjyqi” me autor padër Frano Kiro. Premiera u dha më, 16.04.1936 me këto interpretues: Lin Gjonej, Gjon Karma, Ndoc Harapi, Pjetër Gjoka, Gaspër Bicej, Shan Zadrima, **Ndue Pal Shllaku** (në rolin e gjykatësit, dhe ishte 14 vjeç). Ndërsa interpretimi i fundit është në tetor të vitit 1941, në dramën me pesë akte të titulluar “Ferdinandi i Agrigjentit”, e cila u shfaq pesë herë. Ndue Pal Shllaku interpretoi rolin e Ferdinantit. Duke parë afirmimin e personalitetit të tij si aktor e si krijues, interesat e tij artistike erdhën gjithnjë në rritje. Kështu Ndueja rreth viteve 1940 – 1941 u zgjodh sekretar i Shoqërisë Antoniane. E, Shoqërinë Antoniane, Ndueja e kishte për zemër e në shpirt. Ai kërkonte që kjo Shoqëri të kishte gjithnjë ideale dhe vizione. Për këtë lexojmë një shkrim, ku gjithë entuziazëm, në emër të Djelmnisë Antoniane përhëndet ardhjen e vitit 1941. Citoj: “Aq ma teper na – Djelmnija – e kemi per detyrë me u drejtue syt ngjarjevet e veprave t’ona të vjetit të kaluem. E kur të gëzuem per frytet e vepravet t’ona, do të mundohemi qi ato vepra të gjalla e të dobishme të jenë prap dishiri i ynë i flakët, dhe mandej tuj rishikue të metat, veset e gabimet t’ona të kerkojmë qi, t’i zhdukim ato njiherë e pergjithmonë, e në vend të tyne të bajmë me shëndritë virtyti, dashtnija, ideja e bamirsija. ... Pra, Antonian pri prej shejtit pajtuer t’onit, Shna Ndout, grumbullue rreth shejtit të shejtë qi na udhheqë, shtye prej dishirit veç me perparue; le t’u apim hov me fuqin qi vetem na do të dijmë me perdorue, të gjithë degëvet të ndryshme të rrethit t’onë, jo vrra në vrra, por me kalojn, entuziazem e durim pa u topitë e kem me pa se vjeti i ri qi fillojë do të jetë ugur mirë i vjetvet e qi

Në gjurmët e një arkive të panjohur

ZBULIMI I NDUE PAL SHLLAKUT

Nga Xhahid Bushati

do të pasojnë per lumnin e shoqnisë s’onë së dashtun.”¹

2.

Krahas rrugës aktoreke e asaj fillestare në rrugën e dramaturgjisë (nëpërmjet dramatizimit), djali nga Shllaku fshihte thellë në shpirtin e tij tragjik dashurinë për letërsinë. E dashuroi atë si vetë ëndërrën për të ëndërruar, e dashuroi atë si vetë jetën për të jetuar. E kishte kredo të viteve që i kishin mbetur. “*Me kangë të shpirtit tim këndon edhe jeta*” dhe më tej Ndueja vazhdon: “... *shpirtin... qi vueti përherë në heshtje*”. E ky njeri me shpirt njeriu, mori një dimension të ri e befasues në hulumtimet e studimet e mia. Shkas u bë, një ditë vjeshte, një bisedë krejt e zakonshme me ish aktoren e talentuar të teatrit “Migjeni” Antoneta Fishta (tashmë e ndarë nga jeta), në shtëpinë e saj. Teksa unë interesohesha për jetën e saj artistike në fushën e aktrimit, ajo më përmendi emrin e Ndue Pal Shllakut, ashtu krejt rastësisht, ngaqë biseda me ish aktoren e mirënjohur, tashmë, kishte hyrë edhe në hullinë e vlerave të panjohura që ende i ruan qyteti ynë. Unë mbeta për një çast i habitur. Për momentin pranova heshtjen, dhe në heshtje gërmova në kujtesën time. I tregova se çfarë dija për personazhin që përmendi pak më parë. Ajo qeshi, me atë të qeshurën e saj karakteristike e paksa burrërore dhe njëkohësisht më befasoi, kur me bujarinë, dashamirësinë e fisnikërinë e saj më vuri në dispozicion arkivin e tij letrar. Tani “do të bisedoja” me faqe të shkruara e të panjohura (poezi, prozë, studime, etj.), ku shpaloseshin konceptet estetike dhe botëkuptimi i tij, qëndrimet dhe shtysat, motivet dhe realiteti i krijuar prej tij... “T’falëm o diell vezllimesh! / E ju rreze të shkëlqyeshme. / Që n’hare puthni mallet / N’largim për i dit’ dëfrimesh / Që agon me ngjyra t’ndryshme! / Plot zemër e gjith i botë u falet!” (Diellit..., autori: Ndue P. Shllaku, botuar: Tomori, 05.06.1942)

Zj. Fishta më përmendi edhe një amanet: “*Im shoq, Lec Fishta e ka ruajtë me kujdes e dhembshuri për 50 vjet me radhë. Me shpresën për ditë më të bukura, me besimin se një ditë do t’ia jap lexuesit të gjitha këto*”. Dhe unë pas një pauze të shkurtër i thashë se do të vijë një ditë që zëri poetik i Ndue Pal Shllakut do të bëhet i njohur.

3.

Materiali i shfletuar me kujdes, më ofron ndjesinë e kohës së humbur e njëkohësisht kohës së fituar. Nocioni i kohës, i raportit të saj me autorin, me sensibilitetin e fluiditetin moshor, shpirtëror, që ruan e kondenson herë një romantizëm engjëllor e herë një romantizëm shpresëvakët e shpesh pesimist, mbeten dukuri të veçanta e interesante që vijëzojnë individualitetin e tij krijues si fllad ngjashmërie kah Gaspër Pali e si revoltë ndaj padrejtësive kah

Migjeni. I themi këto se si poezia ashtu edhe proza (përshirë edhe temat hartimore, esetë, etj.) janë refleks të dalë prej shpirtit të tij, prej dhimbjes burimore të tij. Nuk e ke të vështirë të kuptosh se kemi të bëjmë me një shpirt të ndryem brenda shpirtit të vet përherë ndër vuajtje, si një shembull i durimit në heshtje, apo siç thotë vetë poeti: “*Kje diçka, nji i luftës kundër valëvevet të jetës*”. Kësaj të vërtetë të dhimbshme janë dëshmitarë të heshtjes shumë vite të jetës së tij, që e vunë në prova e rrethana shumë të vështira, por Ndueja me kurajo, me vullnet pse jo nganjëherë edhe me nota dëshpëruese, por me guxim moshe u mundua t’i kapërcejë. Ndonëse viti 1942 nuk ishte i mbarë, i jetës (ishte caku i fundit i të jetuarit) për Nduen. Në këtë gjendje të vështirë shëndetësore, ku shpirti i tij ende ruante si margaritar dashurinë për jetën, Ndueja me forcën e sublimitetit të shpirtit shkruan pa pushim... Dhe muajin e fundit e kuptoi se lulet dhe diellin e qershorit nuk do të arrinte t’i shihte më. Jeta për të çdo ditë vakej, tashmë ishte një shpresë e kotë... Megjithatë ai vazhdonte të shkruante... ashtu i shtrirë në copa ltrash e në faqe të plota. Edhe pse dora dridhej e fjalët ishin të pasigurta. “VORFNIIJA asht nji grue e shkretë / Me zemër plot mjerime; / Gjithmonë udhton ndeshprime, / Shpesh t’mson me e gzue kët jetë. / PAS’NIJ’ a’j zojush’ e terbueme; / Të knaq’njat-her’ kur e ke, / Me t’ikë, at-her’ i mjer’je / Vishtir’ m’e ba ma t’hatrueme.” (VORFNIIJA e PASUNIIJA, autori: Ndue P. Shllaku, poezi në dorëshkrim)

E ndarja nga jeta e Ndues, në at’ vjeshtë me “qiell të vrasuemun”, lë gjurmë frymëzimi, dashurie dhe përjetësie të një autor me pseudonimin ‘Lodja’, ku i kushton Ndues, këtë poezi mortore: “Krahasoj prendveren t’ime: / Me vjeshtë që don me ardhë / Me jeten që Ty t’a mardhë, / Me naten që s’ka m’u zbardhë / Kurr ma. // E lott m’rrjedhin heshtueshem / N’per zemren e gandueme / N’per mollxat e zverdueme / N’per vargjet e vorfnueme / O vlla. (Vjeshtë!.. -kushtue Ndue P. Shllakut-, autori: Lodja, gaz. Tomori, 24.11.1942)

Krahas botimeve në gazetën “Tomori” e “Tomori i vogël”, në revistën “Zani i Shna Ndout” e në fletoren “Sporti shqiptar”, Ndue Pal Shllaku la mjaft dorëshkrime të botuara, si: 30 poezi, 10 novela e novelëza, një ditar, një përrallë dhe shumë përkthime, ku mund të veçojmë dramën “Mbas njimdhjet vjet”sh” të autorit italian Camilo Federici. Është për t’u përmendur edhe puna që nisi me një dramë origjinale të titulluar “Omeri i ri” që arriti deri te akti i parë, pasi sëmundja nuk e la që të vazhdonte më tej. (Poezia, proza dhe dramaturgjia do të jenë shqyrtime të studimeve të mia të ardhshme.)

Duke iu rikthyer botimeve, vërejmë se shkrimi i parë mban datën 07.01.1939 dhe titullohet: “Kujtime” (botuar në fletoren “Sporti shqiptar”), ndërsa vjersha e fundit mban titullin “Jeh i vetmuar” (botuar në gazetën “Tomori”, në vitin 1924). Në këtë gazetë ka botuar poezitë: “Muzg vjeshte”, “Ushtima”, “Mramja”, “Hanës” dhe novelën



“Kulla e çekiçi”. Kurse në revistën “Zani i Shna Ndout” boton novelën “Streha dëshmuese”.

4.

Ndueja lindi më 25.02.1922 në Shllak. Ishte biri i Pal Vuksanit dhe i Katrinës (i thoshin dhe Kate) së Kolë Ndout, e cila ishte bijë prej Dushmanit (Shllak). Babai i vdiq shumë herët dhe nuk e njohu atë. Ndueja ishte një vjeç. Më vonë poeti i ardhshëm do të shkruante në ditarin e tij: “... *që në fëmëni dishroj babën. Trupi i tij përkundej në shpinën e ngarkuese të samës. Kjante e veç lotët e syevet tue rige mbi mollza ia lmojshin faqet Ndout ferishte. Strehë pushimi dituer për Ndoun, ishte ndo’ i hije peme nder ara të zharituna ku e ama punonte për t’ushqye vedin e të voglin e sajë. Atë nuk e lmuen kurr duer delikate; por dy duer të vrazhda pune po shum të dashura nane. Kangë gjumi ishte për të zani i natyrës*”.

Rreth viteve 1924 – 1925 së bashku me nënën i dhanë “lamtumirën” Shllakut, (ku e ëma përpiquej të siguronte kafshatën e bukës) dhe zbritën për të jetuar në Shkodër, (ku e ëma punonte aty-këtu dyerve të panjohura për të siguruar minimumin e jetesës.) Ndueja, tashmë, ishte tre vjeç.

Strehohet për mëshirë në një dhomë përdhese të një familjeje bamirëse shkodrane. Dhe për Nduen e vogël strehë ditore bëhen Motrat Servite, ku ai merr edukatën e parë. Shkollën fillore e kryen pranë Kolegjit të Françeskanëve (1929 – 1930, 1933 – 1934). Pas mbylljes së saj, klasën e pestë e kreu në shkollën pranë Dugajve të Reja. Në vitet 1934 – 1935 regjistrohët në Liceu shtetëror (është fjala për Gjimmnazin e Shkodrës), ku vazhdoi deri në klasën e katërt të kursit të lartë. Nga fundi i vitit shkollor, pra, në mars të vitit 1942 u sëmure rëndë. Matura për të, tani, është vetëm një ëndërr e porealizuar. Vdiq më 28.05.1942.

Kur mosha duhej t’i fliste pranverës, Ndueja përjeton tragjizmin e jetës e tragjizmin e sëmundjes së tij... (Në vetvete poeti dhe prozatori i panjohur, tashmë i njohur, është personazh tragjik. Ky lloj përkimi gjen terren edhe në shënimet e tij, ku lexojmë: “*Migjeni, ah, po, te shkrimet e tij shikoj aty këtu vetveten e jetës teme*”. (Lindi 11 vjet më vonë se Migjeni dhe vdiq 4 vjet më vonë se ai. Ndueja vdiq 20 vjeç, kurse Migjeni 27 vjeç. Të gjitha këto shënime flasin se midis tyre ka pasur vite bashkëkohësie, njohjeje, leximi e studimi.)

Pasioni dhe interesat për letërsinë kanë një fushë të gjerë. Ka lexuar me dëshirë dhe vëmendje Migjenin, Gj. Fishtën, Nd. Mjedjen, F. Nolin, N. Frashërin, D. Aligerin, V. Hygonë dhe Leopardin. Dhe ky spektër kulturor reflekton në krijimet e tij, si: në lexime origjinale (italisht e gjermanisht që i di shumë mirë) në përjetimet e rrëfimeve të personazheve, të shkrirjes së unit lirik, apo të skenave të ndryshme: epike a lirike qofshin ato, në zbërthimin e ideve e argumentimin e tyre, ndriçime e këndvështrime të shkrimtarëve në raport me veprat dhe kohën e tyre, citime nga krijimet e autorëve, përqsja dhe elementet krahasuese, etj., etj.

1 ... e Sh. (njëri nga pseudonime e Ndue Pal Shllakut); shkrimi: Me vjetin e ri..., rev. Zani i Shna Ndout, kallnduer 1941, Nr. 1, vjeti XXIX, f. 17 – 19.

5.

Kodi poetik i krijuesit Ndue Pal Shllaku në marrëdhënie me kohën e realitetin shoqëror në këto rrafshje: **1. Realiteti dhe problemet e tij, 2. Realiteti dhe shpirti i tij.** (Këto poezi e copëza të saj janë faza e fundit e krijimtarisë së poetit. Raportet me vdekjen bëhen më të ngushta. Rrëfimi gjithashtu. Jeta ka trajtën e të jashtëzakonshmes e të tragjikes. Kënga e poetit, tashmë, më shumë është për vete, ka më shumë karakter autobiografik që konturohet me një rrëfim të dëshpëruar për një çast të caktuar të jetës. E vërteta e poezisë, vrulli dhe fuqia e poetit kanë gjendje dhe ritëm të shqetësuar. Dashuria është aq e zjarrtë, vullkanike sa edhe e dëshpëruar, në kacafytje, kësaj radhe të poetit me vetveten. Ai i kërkoj jetës t'i marrë sa më shumë jetë. Për të **Koha** është **Jetë.**

6.

Në hapësirat e poezisë së krijuesit Ndue Pal Shllaku lëviz *hija*. Poeti thotë: *"Merzija / dhe hija / me kangët e shpirtit t'im / Ushtoj në mjerim"*. ("Ushtima", 14.07.1941.) *Lëviz hana*. Poeti thotë: *"Nqetsin' qiellore, o hani, shtrihesh / plot hire / n'mjerime t'njerzvet s'ngjesh e dëshire / Me t'pa, dikush sa s'ka mbarue"*. (Hanës..., 11.11.1941.) *Lëvizin: muzgu, mbramja, zemra, shpirti, retë që falen me diell, kujtimi, vetmia, andrra plot uzdajë, heshtja, dashuria e pafat, etj., në qerthullin e mjerimit. Në qoftë se te Migjeni trajtimi i kësaj teme lidhet edhe me qëndrimin e dukshëm të poetit, te Ndue Pal Shllaku trajtimi i kësaj teme e ka pikënisjen te shpirti i tij dhe hapësira poetike është sa vetë shpirti i tij. Këtu duhet ta kërkojmë realitetin shoqëror, i cili kornizohet dhe merr karakterin e intimitetit. Mbi bazën e kësaj metafore përcepton edhe motivin, ndërton strukturën e poezisë e sistemin figurativ të saj. Kjo vërehet: në imazhet e vendlindjes, në lirikën e peizazhit, si edhe në atë të dashurisë. Tek poezia "Mbramja", dukuritë 'arkaikë' nuk e cënojnë aspak poetikën a frymëmarrjen e krijimit. E mbështetur në leksikon autentik të trevës së vet me të cilin operon përmes detajeve poetike, poeti idealizon fshatin, botën e tij, natyrën dhe njerëzit..., një pamje gjithë ngjyra romantike, realitet që është pjesë e fëmijërisë së tij. Dhe poeti e përcjell këtë poezi me këto fjalë: "Asht vështirë me e përshkrue bukurinë e mbrëmjes së fshatit t'im. Duhet me i ngjye shpesh herë gishtat në shllinë; duhet me fjetë në fierë me trup nënë krye në një zdatk me vathin e berrevet; duhet me i ndie e me u deshprue nga grahmat e fuqishme të malsorëvet punëtorë; për me mbujtë me e paraqitë mbrëmjen e jetën e hareshme të fshatit tim". (gusht, 1941).*

Ndue Pal Shllaku ishte një krijues jo shumë i përmendur, ndonëse botoi herë pas here poezi e proza në shtypin e kohës. Vdekja i shoi rininë e moshës. Arkivi me krijimtarinë letrare që la pas i ndrit rininë e moshës dhe i fal pavdekësinë e krijimit dhe të krijuesit.

Nga arkivi që kam në dorë, dhe nga fotografitë (të cilat janë të pakta), vetiu më vjen ndërmend një bisedë e bërë shumë vite më parë me regjisorin Lec Shllaku. Leci e kishte pasur Nduen, shok klase. Më bën këtë portretizim: "Ndueja gjithmonë më kujton Zherar Filipin tek "E kuqja dhe e zeza". Tip sportiv, i veshur bukur (i kërpitur), hollak, inteligjent, (inteligjenca shtrihet në të gjitha gjërat që e rrethonin e ku depërtonin sytë e tij shprehës), kishte buzë të trasha. Ndueja ishte formati i intelektualëve të asaj kohe. Paraqitja e bukur e intelektualit, që di e që mundet. Që don t'u thotë të tjerëve: "Kujdes kur të bisedoni me mua!"

Ndue Pal Shllaku është poet i drithërimës e i zemrës së drithëruar. Shpirtin ia fali

poezisë. Poezia iu bë shpirt, jetë dhe dhimbje. Kështu foli në heshtje me "re dëshiri". Dhe m'u kujtuan ca vargje të poetit polak Adam Asnyk: "Se çdo ëndërr, gëzim, gjithçka tretet, / edhe ëndjet, pasionet në botë 'perëndojnë... por dhimbja veç mbetet". (poezia: "Dëborë") Bashkë me dhimbjen edhe magjia e një poeti të talentuar, që quhet: Ndue Pal Shllaku.

7.

Autori: Ndue Pal Shllaku KOLIQUI në "Balada e mandeve" (Studim)

Kur nxuni fillë me shkruet Koliqi, në Shqipi, shumë shkrimtarë kërkojshin horizonte të reja për një farë drejtimi të ri të letërsisë Shqiptare.

Kërkojshin gjurmë udhëzimi ndër letërsitë e huaja, shfletojshin volume me gjetë diçka të pa ndieme; ndërsa Koliqi, tue ba për vehte letrat e huaja e tue i ngjeshë ambëlta me poezin popullore, nxjer një pelhurë të hieshme, që i rrin per bukuritë shpirtit të popullit Shqiptar.

Veshë ket pelhurë të re, pervehtëson artin e ri e formon nepër tingujt andertrart një vehtje poetike të randsishme. Shkrimtarët admirojnë rrymen e re. Koliqi punon.

E ktu, po më kande me e vrojtë Koliqin në "Baladen", jo se jam i mendimit se asht në ma të bukuren pasqyrë të lirikave të veta, por, pse ktu disi edhe mue më ngjallë mall per një kohë të kandshme gadi-gadi të harrueme. Po më kande me e vrojtë; poetin e luhatjeve të knaqshme, të muzikalitetit; t'ertzimeve e të tytmive të luleve të dashunis ideale, të kandshme nepër fletëzat e kuqe të drandofileve, të të buzqeshjeve plot harmoni riynore, të mallit; Koliqin e kujtimeve.

Poezija fillon me një kujtim permallimi të shqetësuem. Poeti mallohet, fëshin syet e ri e të qetë e fillon me këndue rishtas. Me pranverë i ngjallet në shpirt edhe një herë mendimi i rruzullit i natyrës, i asaj natyrë së pa kufi që i asht veshë në zemër e qi ende i zhvillohet buzëqesëshe para sieve, e vron e kërkon me rizbulue në te andjet e bukurin e kalueme. Kalimi i kohës e prekë randë poetin e malli i atyne buzqeshjeve e ndezë zemren e tij. Me shpirtë të flakët pyet:

"Tue shkundun mandin pse s'na kthehet gzimi

i mbramjeve t'fmijnis qi koha shqimi?"

Qe sa përmallëshëm e sa bukur e fillon poeti kangën e mallit. Koliqi duket zemruem, kujtimet e përallojnë e merzitet; dobësohet e i perkulun para jetës së vazhdueshme rimundohet me ngjallë të të kaluemen.

Fillon me përshkrue ato mesdite Maji, të freskta e të gëzueshme njetëherë kur dielli fillonte me u mekë, me lirue qytetin prej vapës e me u lëshue vend atyne hijeve të flladëshme e t'erandësishme, që shtriheshin nen degët e hapëta të mandave. E. Koliqi, ndien edhe një herë mall, ndien me lot ndër sy, ato zaje e hapa të kandshme e të zhdervjedhët, që sjellin sofrabezat; i rishef kah i shtjellojnë nen gema e rishef ato vasha me buzë në gaz.

"...fyrën përpyet, çue mang't te llana."

Qe një tjetër bukuritë e gjallë që vetëm Koliqi e shprehë. Poeti asht hutue në vegim e rishikon ashtu i ngrimë në hare, deri sa...

"...plym si breshën dikon pema / kokrrat kumbore t'rimuna ndër ana / nga mjalta e verës qi ndër pal't e gjana / bje t'sobrabazit ku ban bark randimi."

Knaqet nat të raem frytesh të shieshme e t'ambila si mjalta, gëzon në kujtim per sofrabezin plot. E kur çdo gja e shef të kryeme, burri zdrypë e, kur fëmija mbarojnë së mbledhuni mandate anash e saksijash (bash si dikuer!);

"Shtrve në bar mandej e kandshme ndeja ishte,

vue përpara çinijat plot me manda..."

Poeti ka tretë nder kujtime, e me mish e me shpirtë jeton në kohën e kalueme, ai knaqet mbi at bar të blerë fladejsh e erënash së mrekuellueshme, ndeja i asht e kandshme ndën fletët qi luhasin lehtas e freskojnë shpirtin e shqetësuem të poetit. E në sa dielli me ato rreze lëmueme në shkelqim puthë ambëlta tue u largue lulishte, lule vilet e ngjyrëshme në bukuritë, atij nen at freski të madhnueshme e të pa cak, nen at' shijim mjalte,

"...jo vetëm në gojë i rrëshqitte anda po nje në shpirt na binte ambëlcimi."

E si i habitun poeti vron at' kohë plot dhimbë, at kohë lumnije. Asht mbulue nga një tis i hollë andrrash e kujtimeesh e, çuditet per ndryshimin e një kohës kaq të shkurtë.

E kur lodhëshem e deshprueshem çelë syet shef se nuk asht ma nen at atmosferë të hyjnueshme, afer atyne fladejve të knaqshem, bri atyne dritave kuq-loshe, para atyne fryteve mjaltoër e deshprueshëm me dhimbë shpirti thurret: -

"Kokrrat e mjaltshe pse n'kto kohna t'reja

Shije ma s'kanë, e, pse n'oborr si at-hera e shkundjes s'mandit nuk kumbon hareja q'ishte ndër ma t'gjallat qi na falte vera?"

Asht deshprue e, kah don me e ngjallë edhe një herë lumnin e kalueme lëshon zanin e fuqishëm qi mjerisht shuhet shpejt, pse dashurija e kohëvet të riynis asht zhdukë, ka humbë. Merzija e kohëvet të jetesës së tashme e ka lodhë, demoralizue, prishë andjen e jetës. Ato mbramje të bukura, sot shëndrrue në mbramje merzije e trishtimi. E poetit i rrahë zemra, i fryhet e i shfryhet gjoksi, me fuqi, e idhnu me vedi thurret: -

Eni, vajza, n'oborr... eni - thotë Koliqi pse ju e vetëm ju, qi me ato duer të njoma e të bardha mbani sofrabezat, ju vetëm mundeni me sjellë andjet e riynis, andjet e harrueme. E poeti qi e ka për dishirë me ngjallë, me përtri, me rijetue lumnin e kalueme, don t'i ndezi në ket mbramje të ksaj kohe së verbueme, don të shtrihet edhe një herë në barin e njomë, aty bri drandofilleve qi tumtojnë në lulishtë e don qi edhe një herë.

"... ambël biseda t'sillet mbi doke t'vjetra t'primna kah prendimi..."

Doke qi Koliqin e ndezin në një lumni të re. Doke të knaqshme per popullin Shkodran. E si Koliqi, permallue prej lumnis së kalueme ndezë prej deshirit me gëzue haren e valet e riynis; ri-hjell zanin nder vasha, nder shokë, në Shkoder; pret një pergjigje... përgjegje vallesh së pa shterrëshme. E tue shpresue, njatje te e vona, i primë prej deshires së tij si në një mjegullinë hiroshë thurret per një jetë fat-bardhë e të knaqshme.

"E prap e lume mbramja ka m'u endun, shtrve rrotull përmbi bar si ndit t'kalueme, fmijnin arit me t'fshame tue permendun..."


At fëmijni lumnije t'atyne ditëve të furieshme andjesh së pa fre. At riyni të rrezeve të knaqshme të diellit pranveruer, t'atyne fletëve të dridhëshme flladejsh, t'atyne ertzimeve të mrekuella lulesh, t'atyne shijeve t'ambila mandash... Kan me e permendun e ajo ambëlsi qi rishtas kan me lëshue mandate e andshem të sotshmes kan me na bashkue, me na gnjitë, me na afrue edhe një herë hijesh së shendriteshme rrezesh vezulluese dielli në prendim; nat prendim ku mjalta ambelsija e shoknija e kohes së shkueme... tash na ep një amë agimi. E nat amë agimi, Koliqi, rrehet e shpreson se do t'a shofin edhe një herë kohen e lumnis së kalueme. Por me riyni soset gjithçkafja e ket e din edhe poeti lirik Shkodran.

Koliqi në "Baladen" na paraqitet mjaft i gjallë. Kujtimet e tij ngjallin një mall Shkodran, që vetëm ai e ndien. Pasunija e fjalëve asht e çuditëshme. Poeti tretet shëpesh nder sfumatura e gjyserr hije të kandshme qënë ças e bajnë me harrue realitetin e shkruem e e tresin në fantazi me një fuqi rithmore e me një muzikalitet të çuditëshem, por poeti pernjihërë rikujton të kaluemen e ngjallet si një hije andrruese, bash si - De Lamartine o Petrarca - e, atëherë poezija merr frymë të re e Koliqi humbet nder ertzimet e tytmimet e luleve. Bukuri e çuditëshme!

Ky tekst i Ndue Pal Shllakut është shoqëruar në fillim, nga ana e redaksisë me këtë shënim: "Në ditët e fundit na ra në dorë një dorëshkrim tjetër i të ndierit letrarit të ri Ndue P. Shllaku. Nuk është një studim i përsosur që kërkon thema, por me këtë tregohet talenti i tij poliedrik që aq shpejtë u shua, pa arritur akoma në provat e pjekurisë.

Sa të vlerëshëm janë vërtetë të rinj të tillë për letërsinë t'onë të varfër!"

Botuar në gazetën "Tomorri", 20.06.1942 SHKODËR, QERSHOR, 2022



Tekste të shquara të letërsisë botërore bazohen tek epistolar, zhanër i njohur qysh te Heroidet e Ovidit, për të kaluar te letrat e filozofit dhe teologut Pietro Abelarit të shek. XII drejtuar Eloizës, apo vepra e lëvizjes "Stuhi dhe vrull", *Vuajtjet e djaloshit Verter* të Gëtes; *Letrat e fundit të Jakopo Ortis* të Ugo Foskolos, që shënoi romanin e parë epistolar në letërsinë romantike, si dhe vepra më të vona: *Frankenstein, ose Prometeu modern* i Mari Shellit, *Drakula* i Bram Stokerit apo veprat e shekullit XX, *Letra të një fillestari* i Guido Piovenes, *Ngjyrë vjollcë* i Alis Uoker e shumë të tjera. Nga ana tjetër, është e vështirë të gjejmë një shkrimtar a poet të letërsisë sonë që të mos ketë dërguar e marrë letra me personalitete shqiptare ose të huaja të kohës, qofshin këta artistë, politikanë apo persona me funksione të caktuara (nga Budi, Bardhi, De Rada, Skiroi, Serembeja, Asdreni, Kuteli, Lasgushi, Konica, Fishta e deri te bashkëkohorët Kadare, Agolli, Camaj, Zhiti etj.). Njerëzit e letrave shkruajnë letërsi dhe dinë të këmbëjnë letra të bukura dhe, me çdukët, do ta gëzojnë këtë fat për sa kohë nuk do të duan ta zëvendësojnë këtë përvojë me forma alternative.

Interes të posaçëm përbëjnë letërkëmbimet në raste autorësh të censuruar, të burgosur e të ekzekutuar, si Vilson Blloshmi, duke u shndërruar në burim të dhënash për anë të panjohura të krijimtarisë dhe personalitetit të poetit e, njëherësh, duke u integruar në mozaikun e veprimtarisë së tij letrare. Nga letërkëmbimi i Vilsonit me Lumturi Blloshmin, kemi ndër duar 11 letra, që poeti ia dërgoi me postë Lumes, përgjatë viteve 1968, '72, '73, '74, ndërkohë që atyre u mungon zëri tjetër, nuk dimë përgjigjet që i ka kthyer piktorja, duke e drejtuar vëmendjen kështu vetëm nga njëri kah i këmbimit – Vilsoni letërdërgues. Le të kujtojmë ndërkaq se, pas mbarimit të shkollës pedagogjike në Elbasan, më 1966, Vilsoni gjatë viteve të letërkëmbimeve, që ushtar në brigadë pune në Tale dhe Zejmen të Lezhës e më pas punoi si druvar në Stravaj dhe minator në Përrenjas.

Po kush është Lumturi Blloshmi? Kushëria e Vilsonit, e cila jetonte në kryeqytet, ku edhe kishte kryer studimet për pikturë, filloi krijimtarinë në prag të viteve të vështira 1973-'74, përgjatë të cilëve mjaft artistë u dënuan, internuan, burgosën, madje, edhe u ekzekutuan nga pushteti totalitar. Në këtë periudhë, Lume Blloshmi u mor kryesisht me peizazhe e portrete realiste, të cilat u paraqitën në ekspozita kombëtare të kohës dhe në ekspozita vetjake. Pas rënies së diktaturës, ajo spikati si një nga piktorët më të mira bashkëkohorë me tablo ekspresioniste e simboliste, si dhe përmes modelimeve moderne të figurave (cikli i tablove nudo). Tema të rëndësishme sociale dhe shpirtërore, gjithashtu, gjetën shprehje figurative në pikturat e Lume Blloshmit, siç është cikli kushtuar eksodit të shqiptarëve të viteve 1991-'92.

Dy kushërinj, dy artistë të një brezi me botë të përbashkët artistike dhe me interesa të njëjta kulturore këmbëjnë ide, mendime e kode mbi leximet e parapëlqyera të filozofëve e autorëve të shquar botërorë, për sigurimin e librave dhe fjalorëve që qarkullonin në mënyrë të kufizuar apo ishin ndaluar, për përkthime të shkrimtarëve të letërsisë së huaj, ekspozita pikturash, për vlerësime e parapëlqime për kompozitorë e të tjera. Të rrëfyera në vetë të parë, me një ligjërim elegant, plot erudicion e herë-herë me tone humor, këto letra, që shpesh kanë trajtë eseistike, përcjellin një prerje të kohës në të cilën jetoi Vilsoni dhe plotësojmë profilin poetik e përkthimor të autorit, pikëpamjet artistike e intelektuale të tij mbi poezinë, përkthimin, muzikën, kulturën, si dhe pamjen njerëzore të poetit, gjendjen e tij shëndetësore dhe jetën e përditshme, raportet familjare e shoqërore etj. Mungojnë këtu pikëpamjet për shoqërinë dhe politikën


- Mbi letrat e Vilsonit dërguar Lumturi Blloshmit -

PO UNË, A DO TË KEM FATIN TË NGOPEM SË LEXUARI?

Prof.as.dr. Lili SULA


e kohës dhe, sigurisht, që Vilsoni ka qenë i kujdesshëm që të mos shprehet rreth tyre. Ai e dinte që ishte pjesë e familjeve dhe detyrë më të mira e më me autoritet të zonës, si dhe pjesë e klasës së përmbytur politike (ishin shpallur kulakë nga regjimi), dinte po ashtu se punonte në minierë pasi i qe refuzuar e drejta e ushtrimit të profesionit të mësuesit dhe se për të nuk kishte hapësirë për të botuar krijime artistike. Trajta e autocensurës në rrafsh të ligjëritimit politiko-social, në letrat e shkruara në shqip, dritësohet e receptohet përmes artikulimeve për shijet estetike, admirimin për poetët e ndaluar simbolistë, Bodler, Vërlen, Rembo, Mallerme, që nuk shkruanin sipas parimeve të realizmit socialist, si dhe me interesimet e përkthyesit për të shqipëruar perlat e poezisë franceze. Pamundësia e shprehjes së lirë artikulohej në kundërvënien bipolare *ndjenjë-fjalë*, si pazotësi e kësaj të fundit për të komunikuar e shprehur *ndjenjat*, që nënkupton peshën kuptimore në rrafsh implicit përkundrejt atij eksplisit. "Sado që të shkruaj nuk ia arrij dot komunikimit", shkruan poeti, "sa keq që fjala

është zhvilluar pas ndjenjës dhe shumëfish më pak se ajo" (*Letër pa datë: Vilson Blloshmi, Vepra I, Tiranë, 2008, f. 188*), duke tërhequr vëmendjen e marrëses së letrës në kode gjuhësore të nënkuptuara e në lexime zonash të bardha midis rreshtash, e shumë më tepër në perceptime ndjesore, që rrjedhin nga përkatësia e përbashkët farefisnore e nga interesat e përbashkëta kulturore në kohën e errët të diktaturës. Lexues e vlerësues i majave të letërsisë botërore, që rrezatohet në krijimtarinë poetike e atë përkthimore e që në letrat drejtuar Lumes shprehet si dëshirë e kërkesë për lexime veprash të rëndësishme ase vlerësime për autorë e filozofë të shek. XX (si ekzistencialistët A. Kamy Zh. e P. Sartrri), më 12 tetor 1972, Vilsoni i shkruan Lumes: "U bëra ca ziliqar kur mora vesh se po lexoje *La mort dans l'ame* të Zhan Pol Sartrit, përfaqësuesit më të madh të ekzistencializmit, këtij artisti të vërtetë që ka lëvruar të gjitha gjinitë letrare dhe ka pasur suksese të mëdha në të gjitha... por suksesin më të madh e korri në mendjemadhësi pikërisht në vitin 1964, kur



refuzoi çmimin *Nobel*... Më thoshe, se kishe lexuar mbi jetën e Artur Rembosë. Mirë, po pse nuk më çove ndonjë copë poezi nga Remboja? Përse nuk më tregon asgjë për sonetin e famshëm të ngjyrave. Përse nuk më shkruan asgjë për atentatin e bërë nga Pol Vërlen kundër Rembosë? Shkruamë për këtë." Në këtë e të tjera letra drejtuar piktores, rrezatohet kultura e poetit, e formuar prej leximesh nga Eskili, Dantja, Shekspiri, Hygoi, Dostojevski, Shatobriani, Lamartini, Bodleri, Sartri, Kamyja, Remboja, Vërlen, Remarku, Skoti, nga kompozitorët Moxart e Bethoven e të tjerë, që nuk përmenden, nga artet pamore e nga mbarë bota e artit. Këmbehen (dërgohen) ide e diskutime që na çojnë të gjitha te pyetja: "Po unë, a do të kem fatin të ngopem duke lexuar?" (*Letër Lumes, 1973, pa datë*) dhe na përvijojnë një raport shumë dinamik e gjithnjë në kërkim të poetit me artin, kulturën dhe dijen.

Kemi të bëjmë me dy elitare, që dinin gjuhë të huaja e lexonin në original autorë botërorë, përkthenin kryevepra të poezisë franceze dhe europiane, shkruanin poezi, muzikonin tekste, modelonin ngjyra, donin dhe admironin kulturën perëndimore, së cilës i përkisnin. Nga Bërzështa, Vilsoni i shkruante letra kushërirës në frëngjisht, duke krijuar për kënaqësinë e tyre një "mikroklimë europianiste", – siç i quan I. Kadare përpjekjet e tyre, që "në Shqipërinë e tharë prej propagandës komuniste, të mbanin gjallë ca rrezatime, ca trille, ca 'mondanitet' të një *belle époque*, versioni ballkanik i viteve '30" (*Ismail Kadare: Blloshmi dhe Leka, poetët e vrarë nga shteti, - Në: V. Blloshmi, Vepra II, 2008, f. 147*). Dy prej letrave dërguar Lumes janë shkruar në frëngjisht, ndërkohë që në të tjerat gjejmë rregullisht shprehje e fraza të përzgjedhura autorësh francezë (në ndonjë rast edhe në anglisht), tekste këngësh, vargje e poezi franceze, që ndërkallen në tekstin e letrës ose e shoqërojnë dhe i bashkëngjiten atij, duke interferuar me burime tekstore të fuqishme artistike, që lanë gjurmë në poezinë e Blloshmit. Letrat në frëngjisht, të shkruara nën frymë bodleriane, përcjellin brengën, vetminë e trishtimin e poetit, që burojnë nga leximet e poetëve simbolistë e parnasistë po aq sa dhe nga situata socio-politike në të cilën gjendej. Të shkruarit në frëngjisht, përpos se shprehje vlerësimi, nga ana e poetit, për gjuhën e artit e të kulturës, është përzgjedhur si kod gjuhësor individual ndaj dallojnë këto letra për shprehjen hapur të qëndrimeve politike në kundërshtim me politikën shtetërore. Në letrën e parë në frëngjisht, Vilsoni 24-vjeçar bën fjalë për "mendime të ashpra që i kalojnë në mendje" e shprehet qartë: "Unë di vetëm një gjë, dhe ti e di, dhe gjithë bota e di. Po jua them: 'nëse sensi i vërtetë i njeriut nuk vdes në këtë kohë të tmerrshme, ai nuk ka për të vdekur kurrë'" (*Ma pauvre cousine!* Bërzështë, 6.11.1972). Ndërsa në letrën e 24 nëntorit 1973, poeti luan me kuptimet gjuhësore dhe kapërcen nga ndjesia vetjake tek imagjinata, tekta e cilëson veten "shtëpia e mërzisë" e më pas, duke cituar V. Hygoin e Sh. Bodlerin si për t'i shpëtuar vigjilencës së sigurimit,



shkruan Lumes: "E dua merimangën, e dua hithrën.../ sepse të gjithë e urrejnë". Këto tekste, të shkruara në gjuhën e njerëzve më të kulturuar të kohës, na vijnë si testamente, si oaze shpëtimi e copëza lirie (jo vetëm vetjake), hapësira shprehjeje të fjalës së lirë, e cila vetëmbrohej përmes frëngjishtes aq sa mundte nga sigurimi i shtetit dhe operatorët e zonës. Studiuesi i V. Blloshmit dhe G. Lekës, prof. Sadik Bejko e shqyrton në tërësi veprimtarinë letrare e kulturore të Blloshmit dhe thekson se ajo ishte "kultivimi i një lirie shpirtërore nën tryshninë e mbytjes së çdo lirie tjetër" (*Poeti që e pagoi me peshën e jetës artin dhe bindjen e tij*, - në: V. Blloshmi, *Vepra I*, f. 71).

Vilsoni dhe Genci u akuzuan dhe u dënuan me ekzekutim^{1*} për sabotim në grup dhe agjitacion e propagandë, si nxitës dhe drejtues të një grupi me veprimtari jashtëzakonisht të rrezikshme kundër pushtetit popullor të kohës; u pushkatuan më 17 korrik 1977 (Vilsoni 29 vjeç dhe Genci 36 vjeç) – edhe pse në kampin socialist nuk ekzekutoheshin më poetë – sepse lexonin dhe pëlqenin poetët dekadentë, madje i lexonin në origjinal dhe i përkthenin; u dënuan me pushkatim për trishtimin dhe mërzhinë që përcillnin poezitë e tyre në kundërshtim me entuziazmin e heroit pozitiv të socrealizmit dhe lavdeve që i thureshin partisë. U ekzekutuan se s'reshnin së ngopuri me dijen, duke paguar me jetë dashurinë për të bukurën, të cilën ngado që e vështronin dhe e krijonin, i drejtonte kah Perëndimi.

Ekzekutimi i dy poetëve, 45 vjet më parë, shënon një nga krimet më të rënda të "Sahasasë" shqiptare, gjë që sot duket e pabesueshme, sidomos për brezin e ri, i cili i percepton të largëta vitet '70 të shekullit të kaluar dhe di pak për mynxyrat e komunizmit, ndaj mbetet mision (dhe jo detyrë) krijimi i kujtesës së afërt të të rinjve, e cila pa dyshim duhet të kalojë nga një aradhe dosjesh, ende të mbyllura, për të ngritur përmendoren e pendesës.

1 * Për absurditetin e ngritjes së akuzave dhe pushkatimit të dy poetëve, si dhe për mekanizmat e funksionimit të sigurimit, policisë dhe drejtësisë së kohës së diktaturës, shih: Dosjen operative, Raportin e bashkëpunëtorit të sigurimit, për librat dhe autorët që lexonte V. Blloshmi dhe G. Leka, Aktekspertizat letrare, Fletarrestin e V. Blloshmit, Dosjen hetimore, vendimin e Gjykatës së rrethit Librazhd dhe të Gjykatës së Lartë, urdhrin e ministrit të Brendshëm për ekzekutimin me pushkatim e të tjera dokumente,- në: *Vilson Blloshmi, Vepra II*, f. 167- 190.



PANDOTJA POETIKE E SHPIRTIT

Nga Rudolf Marku

1.

Ngase pas këto ditë do kujtohet dita e vrasjes së dy poetëve, Genc Leka dhe Vilson Blloshmi, njëri ndër krimet më të shëmtuar të shtetit komunist shqiptar, ju lutem më lejoni të sjellë dy kujtime të mia personale, një i vitit 1994 dhe tjetri i vitit 2012...Janë kujtime thjeshtë personale, që nuk sjellin asgjë të re në dokumentacionin e jetës e të ekzekutimit të dy poetëve fatkeqë, por që prapë lidhen me një koinçidencë të çuditshme me fatin e tyre...Poeti Sadik Bejko ka bërë një punë të jashtëzakonshme për të zbuluar të verteten e jetës dhe vrasjes së tyre, duke botuar dy vëllime me dokumentacione arkivore, dhe duke sjellë shëmbullin se si një poet i gjallë përkujdeset për dy kolegë, të ekzekutuar në mënyrën më barbare- jo në vitin 1941 a 1942 a 1943,-por në vitin 1977; dhe jo të ekzekutuar nga pushtuesit fashistë a nazistë a nga bandat fashisto-monarkiste greke a bandat jugoslove, por nga bashatdhetarët e vet të nderuar, që sot e kësaj dite janë shëndosh e mirë, madje duke gjalluar nëpër kryesira të partive të lavdishme të demokracisë Perëndimore. Ironikisht, të asaj demokracie, simpatia për të cilën shërbeu dhe si pretext për të ekzekutuar dy poetët e pafajshëm.Dhe po ashtu nuk ka se si të mos përmendet parathënja eseistike, një Requiem i vertetë, i shkruarit tonë, Ismail Kadare, për krimin e shëmtuar të vrasjes së dy poetëve të talentuar veç pak vite para se të shëmbej kështjella groteske e fantazmës së komunizmit.

...Viti 1994, nëse nuk gaboj. Së bashku me Pjeter Arbërorin, Saik Bejkon, Uran Butken dhe ca miq të tjerë u patëm ftuar në Librazhd për të marrë pjesë në varrosjen e eshtrave të Genc Lekes dhe Vilson Blloshmit. Pasi patëm parë vendin e ekzekutimit të dy poetëve fatkeqë, një prozhmë e vetmuar pylli, buzë një përroi të tharë, një yrt ndjellakeqas, dhe pas një ceremonie përkujtimore në Shtëpinë e Kulturës së qytetit, u drejtuam për në Varreza duke mbajtur mbi supet peshën e dy arkivoleve me ato pak eshtra të mbetura . ishte një kortezhët ndër më të zymtët që kam parë në jetën time...Arkivolët qenë të lehtë, ngaqë qenë pothuajse bosh, e prapë rëndonin aq shumë,sa peshë e krimin që kishte marrë jetën e dy poetëve të pafajshëm. Një krim bërtitës, barbar, i shëmtuar, hakërrimi i injorancës kundër kulturës, i shtazërisë kundër butësisë njerëzore të poezisë, i shëmtimit të përgjeshëm kundër bukurisë së shpirtit... Kur ja, tek po ecnim në një rrugë mes qytezez së shkretë e të zymtë, papritur dëgjojmë një zë të shqiptuar me tërë forcën e gërmazit, si sfidë, : Mirë ja u kemi bërë!...Kthejmë kokën, dhe shohim se këto fjalë janë shqiptuar nga një njeri me një pamje groteske, me një shprehje ligësish të provincave të thella,i tharë, i rrudhur keqas, me një kapele leniniste, një lloj shapke bolshevike, ulur në një parvaz vitrinash të një dyqani të boshatisur... Menjeherë më shkoj ndërmend Ferri i Dantes, klithmat nga gropat tërë gjarpërinj dhe merimanga, klithmat e ligësisë njerëzore, që herë artikulohej si pasione politike, herë si artikuj gazetash,-aq të pranishme

në jetën e përditshme shqiptare- herë si sulme kundërshtarësh dhe herë si dëshira shqyerjesh...Për Kolakowskin, barbaria Totalitare, në përgjithësi (mendojeni vetë se ç'mund të themi pastaj për ligësinë totalitare të markës shqiptare), mbetet dhe shprehja e prezencës së Djallit në Histori. Çfarë kemi bërë për ta përzënë Djallin nga Historia jonë? – pyet ai edhe për ne të gjithë. Më duket se kemi bërë të kundërtën : kemi bërë çmosin për ta joshur që të qëndrojnë mes nesh! Po të ishim vertetë një shoqëri e qytetëruar, kur vjen puna tek dënimi i krimeve të së kaluara, mendoj se të gjithë ne duhej të ishim përtej pikëpamjeve të majta a të djathta, përtej pozicioneve partiake, sepse normalisht si qenie njerëzore duhej të kishim përqafular atë ide të kahershme të Adam Miçnikut që thosh se Jeta më ka mësuar po qe se dikush është duke u fishkëlluar nga një kamxhik dhe se dikush tjetër është duke fishkëlluar dikë me kamxhik, gjithmonë jam në anën e tij që është duke u fishkëlluar nga kamxhiku... Por jo në Shqipëri...Më ka mbetur në kujtesë ajo britmë e atij njeriu me kasketë- Mirë ua kemi bërë! –thënë si një sfidë triumfuese. Qënjë që tha këto fjalë ishte një qenie e mjerë, e rrënuar, me rrudha që nuk vinin veç nga pleqëria-qenë rrudha ligësie, ca brazda ku ka pikuar ligësia e panevojshme njerëzore. Qenë fjalë të artikuluar nga një njeri me siguri i përbuzur nga e gruaja e vet dhe nga fëmijët e vet...Të urresh edhe në ceremoninë e varrimit, aq më tepër në ceremoninë e varrimit të dy poetëve të pafajshëm?...Mos është kjo skenë një symbol i trishtë i Shqipërisë tonë? Nuk dua ta besojë. Por ja që fytyra tërë rrudha me një kasketë groteske leniniste në kokë, më thotë se është më mirë që unë vetë duhet të besojë te simblolet. Sepse mëncuria njerëzore qënka në proporcion të drejtë me aftësinë tonë që kemi (a nuk kemi) që të mund të deshirojmë simbolet që na rrethojnë në çdo hap...

2.

Është viti 2014. Jam në Tiranë, në Panairin e Librit, kur një vajzë më thërret që nga Stendat e Librit – Dikush ka lënë një libër për ty. Ka pritur të paktën nja 4 orë të mira që të takoheshit. Më dha librin. Më erdhi aq keq që isha bërë shkaktar që një njeri kishte pritur gjatë në një ambient të rrëmujshëm e tërë zhurmë si ay i një Panairi. Me siguri libri që shkruar nga personi i panjohur që kishte dashur të takoheshim. E mora atë libër me kujdes dhe lexova titullin dhe emërin e autorit- "Ngadhënjimi i Shpirtit-Poetët martirë,.. Autori-Nazmi Seitaj. Shtëpia Botuese-Globus R. Është një libër kujtimesh kushtuar poetëve martirë Genc Leka dhe Vilson Blloshmi. Shkruar nga një mik intim i tyre. Fillova të shfletojë librin, kur shoh një pusullë letre të shkruar me shkrim dore dhe të lënë mes faqeve të librit: "...dëshëroj që t'iu dhurojë këtë libër. Arsyen do ta gjeni në faqen 102. Përshendetje Nazmi Seitaj"

Përnjeherë shkove te faqja 102 të cilën po e riprodhojë këtu:

"...Genci erdhi nga Qukësi me një gazetë në dorë dhe na gjeti aty te shkëmbi

në rrafshinë. Nuk më kujtohet nëse ajo ishte gazeta "Drita" apo "Zëri i Rinisë,, por mbaj mend se Genci ishte befasuar nga një tregim i Rudolf Markut, që rëfente për dashurinë fatkeqe të poetit arbëresh, Zef Serembe.

Tregimin e lexoi Genci. Ne herëpashere e ndërprisnim dh komentonim ato fragmente të tregimit që na linin mbresa.

Nuk më harrohen se si i përsëriste Genci fjalët e Serembes, kur dikush i thotë atij në çastin që kishte qëndruar mbi varrin e vajzës në dheun e largët të Brazilit: "Sa shumë që ju ka dashur"

"Ajo nuk më ka dashur kurrë,- ia ktheu Serembe i pikëlluar-ajo s'më ka dashur kurrë!".....

Lexuesi i këtyre kujtimeve nuk e merr mend se sa dashamirës ishin këta poetë për ata krijues që shkruanin me aq dashamirësi e lirizëm për jetën dhe njeriun. Ata nuk kanë qenë kurrë ziliqarë. Ndiënin kënaqësi kur lexonin krijime, të cilat qëndronin larg skematizmit vulgar dhe politik

Rudolf Marku, ky moshatar i Vilson Blloshmit e ky krijues nga Lezha e largët, i mrekulloi këta Poetë, paçka se atyre nuk u lejohej të botonin. Le të botonin të tjerët, për ato çka ndinin ata në zemrat e tyre..."

3.

Tregimin e sipër përmendur e kam shkruar dhe botuar në moshën 20 vjeçare. Në librin e Sadik Bejkos për dy poetët e vrasur lexoj se, ca ditë më vonë nga ajo ditë që rrëfen Nazmi Seitaj, Genci i ka shkruar një letër Vilsonit rreth tregimit për Zef Serembën, me entuziamin dhe dashamirësinë karakteristike të një poeti të talentuar e të kulturuar. Letra ndodhet në dosjet e dy poetëve (shih librin për Genc Lekën dhe Vilson Blloshmin- përgaditur me parathënienë të I.Kadaresë dhe pasthënien nga Sadik Bejko).

Nuk e kisha ditur më parë se kisha qenë, qoftë dhe për ca ditë të vetme, në kujtesën e këtyre dy poetëve . Nuk e kam ditur as atë ditë kur shkova në Librazhd në ceremoninë e varrimit të eshtarve të tyre të gjetura në një rrëpirë mali, buzë një përroi. Nuk e kisha ditur për vite me rradhë. Vilsoni dhe Genci me siguri kanë përmendur me dashuri sa e sa shkrimtarë të tjerë bashkëkohor shqiptar, moshatarë të tyrët apo dhe më të mëdhenj nga moshë. Përmendja e emërit tim është thjesht një koinçidencë fatlume, nga ato koinçidencat që vijnë nga shkëndijat hyjnore. Por ajo që më prek në gjithë këtë histori është dashamirësia e jashtëzakonshme e këtyre dy poetëve që jetonin në një provincë të humbur e të izoluar, të vëzhguar e të kërcënuar në çdo hap të jetës së tyre. E prapë të përshkuar me një dritë të brendshme kulture. Në kontrast me agresivitetin e shumë njerëzve sot- me agresivitetin e njeriut dhe shpesh herë me agresivitetin e krijuesve mediokërr që jetojnë atë liri që u jep atyre të drejten të shpifin, të shajnë, të përdhosin , të nëprgojnë kolëgët e tyre me përjagie zilish vrasare, apo dhe me atw vrasjen me armw me zilenciator-vrasjen me anw tw heshtjes. Ja, kjo më shtyu t'i shkruajë këto rrjeshta jo aq mikëluese për lexuesin delikat të sotëm.



Shtrimi i pyetjes, të lashtë sa bota, qysh në poezinë e parë të librit befasues, *Rabin ç'është dashuria*, ndërkaq e lajmëton qerthullin e shtegimit poetik, madje duke mbetur në hapësirën e teksteve në këtë vatër ligjërimi, kur ulet sipari, në vargjet: *A thua ka marrë fund dashuria dashuria Rabin d-a-sh-u-r-i-a / Sa shumë interesa sa shumë lakmi sa shumë pangopësi-i-i-i*, (f. 227). Shtrimi kaq troç i pyetjes, më të zakonit dhe më sublime, si dhe dhënia e përgjigjes, si parashtrës poetike, duke vënë përballë unin me Rabinin, që sublimon dijen dhe udhëtimin e saj në kohë dhe hapësirë, e përveçon librin, në një situatë të ngjeshur, të bashkëlidhënisë së dy rrafshëve, të pranisë së personale, jetësore dhe imagjinare, po kaq të universale, si një marrëdhënie e qenies me botën, me qytetërimin dhe letërsinë. Pra, në këtë lexim paraprak, sepse rileximi ka gjasa që të ndrit votra të pavëna re, ndeshim një shtegim nga vetja për të Tjetri, që e përmend Ernesto Sabato, mbase të tjetri, që tulatet brenda nesh, diku në thellësinë e universit personal, që shpësjell Rabinin e fshehur në nënvetëdije. Përmbledhja poetike *Rabini im*, qysh në titull dhe në secilën sekuençë poetike, ku gjellëjnë mbi njëqind poezi, me gjurmë uniciteti, sendërton dhe kumton një prani të pazakontë të ligjërit poetik, si një kuvendim shpirtëror, me Rabinin e shtrenjtë, diç ma tepër, si një "fluturim" jo pindarik, në universin letrar dhe kulturor, në qëmtim të shenjave estetike, duke endur kështu një tekst hipertekstual, të endjes së tekstit letrar si rimarrje, madje që shpalon një hije palimpsesti të hapur, pra një situim të shkrim-mbi-shkrimit, ku uni autorial gërshtetohet dhe shkrihet në pikat e vëlmit, të të mbërimeve të verbit dhe vokacionit poetik.

Udhëtim imagjinari në kohë dhe hapësirë

Materia poetike e librit *Rabini im*, krahas larmisë së gjendjeve të shumta, që shpesh faniten si imazhe apo si tinguj shpirti, ndërkaq më shumë se sa gjithçka tjetër, ofron procedun e udhëtitimit për askund, me gjasë në thellësi të vetes, të bashkëlidhur me aktin e kuvendimit-dialogut, pamëdyshje të konceptuar si një udhëtimi imagjinari, që kurrë nuk i shkëput dhëniemarrjet me jetësoren, aq të shëmtuar në bukurinë e vetë. Nëse Dantja në Komedinë Hyjnore, aspak nuk po merrem më përjasjen, që nuk e kam në fokus asnjëherë, kur shkruaj për letërsinë, por vetëm më rastësinë e udhëtitimit, mirëfilli imagjinari, sidomos në Ferr, eventualisht në botën nëntokësore. Autori, në faqet e librit *Rabini im*, në shoqërinë e Rabinin, ashtu si Dante me Virgjinin, tashmë "shtegton" vetëm në një botë imagjinare, mbitokësore, aty ku janë djajtë dhe engjujtë, në një botë kinse ëndërore, herë symbyllur, e herë me sytë hapur. Substanca poetike e laryshisë, si ritëm dhe botëperceptim, si vargëzim dhe leksikemë, gati e ngrirë në një imazh drithëruës, shpërfaqur në shtjellat e ngrehinës së librit të përveçëm në letrat shqipe, vetiu të përfshin në rruzullimin e kapërthimit të plotë imagjinari. Fakti që autori ka jetuar me librin, dhe për librin, si një dashnor i paepun, në thelbin e vetë, sugjeron një shtegim të fantazisë, veçmas në hapësirën e pamatshme të librit, ku strehohet dhe arratiset fjala poetike. Në udhëtimin vetanak dhe imagjinari, ka vlerë më vete, edhe sfondi, vendet e parapëlqyera, Parisi, Roma, Frankfurti, Jeruzalemi etj., pra është edhe një vrapim i rrokshëm kulturor, krejt real si marrëdhënie me librin. Në mëdyshjen ligjërimore, të kahjes së botëpreceptimit, autori brendhëron me fantazi të përndeaur, nga vetja për të tjerët, te bota e madhe e artit dhe letërsisë, te bota e qenies, ku fle terri dhe drita jetëdhënëse, e cila ngërthehet në gërma dhe vargje.

Rabini – mësuesi dhe udhërrëfyesi

Në këtë udhëtim të përndeaur, për te të tjerët, pamëdyshje nisur nga vetja,

UDHËTIM NË PËRMBLEDHJEN POETIKE "RABINI IM" TË ABDULLAH ZENELIT

nga Behar Gjoka


por edhe në kthimin e anasjelltë, që ka në bashkëshoqërim të pandarë Rabinin, gjë që formëson tanësinë e librit, madje edhe secilën substancë poetike, ngjiz një gjendje të ngritur letrare, jo fortë të shpeshitë në letrat shqipe. Madje këtë marrëdhënie frymimi, tejet domethënëse, të ndërthurjes së anasjelltë, autori vetvetiu e shpërndërron në rrafsh të një subjektiviteti fluid, të një ligjëratë të hapur, me veten, me kohën, me dashurinë, me shumë gjasa në subtil të personalizuar, teksa e thërret Rabinin im. Pra, këtu jemi në një përveçim, konceptual dhe thadruës, të poezishkrimit, si një bisedë gjithësi e pambaruar, mbase si kuvendim ditënatësor, a diç ma tepër, si një dialogim i hapur, pa doreza, ku zbulohet lakuriq uni dhe bota rrotull, me Rabinin, kaq të pranshëm shpirtërisht dhe mendërisht, por edhe me vetë botën përfaqë, me universin e librit dhe kulturës, të cilat mbajnë në këmbë qytetërimin dhe vetë qenien njerëzore. Duke shkruar kështu në shkallën skajore të personalizimit, Rabinin im, jo se nuk është i

të tjerëve, porse këtu autori shqipton formën ma të naltë, cakun e mbramë, të dialogut, të autorit:

a – Me mësuesin e jashtëzakonshëm, që ka parë dhe di shumë për jetën, ka shumë për të thënë, por hesht, me mësuesin e prerë që nuk të falë gabimet dhe që të gjendet, në brenga e lëngime, me njeriun me përvojë të gjatë, që në mënyrë të veçantë di me rujt ekulibret, në fillim të mbarimit, diçka ma tepër, me gjasë në mbarim të fillimit.

b – Me bariun shpirtëror, fetar dhe dituror, që ka parë dhe provuar shumë në jetë, që pothuajse di gjithçka, që mundet me e rrok mendja njerëzore, e megjithatë sillet si i barabartë, duke qenë një udhërrëfyesh model, kuvendon lirshëm dhe në një barazi ideale, duke sjellë paqe dhe lumni, në të këtë marrëdhënie të ndërsjellë, krejt unike.

c – Me mikun e patëdytë, që të gjendet kurdoherë, e sidomos në ditët ma të vështira, veçmas në stinë e vetmisë, që dëgjon me durim shenjt (Rabinin i jahudive) dhe, flet



me zë të qetë e të sigurtë, me fjalën e duhur, si për ta lehtësuar sadopak, vullkanin e zjarrëllimës përdjegëse të poetit, me veten dhe botën.

Rabini, sidomos mësues dhe udhërrëfyesh, në këtë udhëtim imagjinari, ka qenë shumë pranë gjithë moteve, mbase diku thellë brenda vetëdijes autoriale, porse ai shfaqet atëbotë, kur moti vranë e kthjellat, si një prani përtej kohës dhe hapësirës, ka ma tepër mundësi, edhe përtej fatit të qenies, si individ dhe shoqëri. Rabini, që shfaqet në ditën e fatkobit, me shumë gjasa, të lëngatës së thellë shpirtërore, është si drita në fund të tunelit, edhe pse terri shpirtëror ka nisur fluturim, që zbret në ditët e njeriut pa marrë leje.


Jeta virtuale dhe librorë e poezisë

Rabini im, libri i fundit i autorit, deri më tani, në nivelet e komunikimit, nga librat e vlerë të letërsisë së sotme shqipe, ndërkaq ka mbërritur te lexuesi, në dy mënyra:

Së pari: Fillimisht si "jetësim" dhe komunikim virtual, krejt i hapur me lexuesin gjerë, që tashmë sa vjen dhe zgjerohet hapësirat e veta. Pra, bazuar te kjo rrethanë, mundet të flitet për një proces të hapur, të vetë procesit kreativ, që luajnë rolin e një situimi paratekstual, organikisht me brendësinë e lëndës poetike. Kjo formë, parake dhe reaguse, ndonëse e mirëmenduar, në ditë dhe muaj, e lëshuar në situatën virtuale, realisht e përlindi librin *Rabini im*. Megjithatë, poezia që merr shkas nga rrethana, të caktuara dhe të pashpjegueshme, sepse letërsia, eventualisht edhe poezia lexohen dhe zbulohen vetëm në tekst, e prandaj do duhet lexuar dhe rilexuar vëmendshëm, ndonëse e barti dhe shpaloi në endjen disamujore, riskun e keqkuptimit, në nivel formal, si një bredhje ironike, si një lojë me zjarrin e dyfishtë, letrar dhe dashnor, në universin e librave dhe jetës me travëlime.

Së dyti: Procesi i hapur dhe dinamik, i shkrimit dhe komunikimit të librit *Rabini im*, me lexuesin e gjerë, jo vetëm e ngjizi ligjërimin poetik, por ndërkaq ia mbërriti që të zgjerojë dimensionet e kumteve etike dhe estetike. Tashmë, shkrimi poetik, që fillimisht bëri jetën "virtuale", të një komunikimi rastësor me lexuesin, mbledhur në një libër, të titulluar *Rabini im*, përpos se i plotë, në shtjellimin e pastër kalendarik, qershor-tetor, të vitit të kaluar, ma në fund krijon shansin e leximit të plotë, si dhe të rileximit të herëpas-herëshëm, për të depërtuar në hemisferat e tekstit poetik, tejet të ndërlikuar si bisedim imagjinari, si teknikë shkrimi dhe qëmtimi, i vatrave të laryshisë letrare, që pranëvihen, me shumë mundësi të një endje palimpsesti, ndonëse rastësor, ku un-i autorial, ndërthuret me shumëfishin e un-it të qenies, në kohë dhe hapësirë, duke mbërritur te lexuesi vetëm si ligjërim letrar. Një un specifik, që rend në kohë dhe hapësirë, e sidomos në pentagramin e fjalës, të një un-i të ashpër dhe ironik, ngahera të brishtë dhe vetmitar, nga vetja për te të tjerët dhe anasjelltas, për të endur kështu një rebus poetik të mëvetësisshëm.

Në lidhje me situimin libror, tanimë kemi rrethanat të kthehemi dhe rikthehemi për të parë më qartë elementë të poetikave, që mundësojnë thurjen e një teksti me kaq larmi. Po hedhim një sy në gjendjet letrare, një term



i I. Calvino, të endura në faqet e librit, në pikën referenciale të un-it, për të prekur marrëdhënie me Rabinin. Në vargjet: *Një poet afon largësitë di t'i këndojë bukurisë / Djallëzinë e fshih midis një fiale kurrë nuk bërtet / Është një kërthi që përjetësisht pi gj...* (faqe 22), që tregon për peshën e fjalës së Rabinin, si mësues, mik dhe udhërrëfyes, për autorin e përmbledhjes poetike. Në një situatë tjetër, zbulohet un-i, mbase venerimi i autorit për Rabinin, teksa shkruan: *Rabini im o Rabini im njeri i diturive / Je një det i heshtur s'ua ke frikën stuhive...* (faqe 125)

Struktura e ndërthurjes së poetikave

Hapësira e teksteve poetike të përmbledhjes *Rabini im*, shenjon një situatë të ndërthurjes së poetikave ligjërimore të ndryshme. Bie në sy, si një element përveçues, që shtrihet në gjithë poezitë e librit, është vragëzimi monokolon, që bashkëlidh elementë të epikes, si narravitë poetike e ndodhisë, të dialogut hipotetik, shoqëruar me praninë e një lirizmi, pa anë e kufi, ndonëse këto prekla letrare vijnë të shqiptuara me kurba të ndryshueshme, varësisht gjendjeve të un-it poetik, e shenjojnë përmbledhejen, kryesisht me shenja të poetikës klasike, të mbështjellura me vello moderne si ligjërim dhe poetikë. Nga ana tjetër, e bashkëshkruar është edhe tipologjia e poetikës moderne, që dukshëm shmang rimat, vargëzimet, dhe madje krijon situime të befta, me ritmikën e personalizuar, me melodikën e brendshme, deri me shkrimin poetik si një palimpsest me shumë shtresa ligjërimi, që gërsheton dijen dhe artin, ndjesitë më të brishta me marritë më të mëdha.

Përmbledhja poetike *Rabini im*, pasojë e ndërthurjes së këtyre poetikave, të letrares dhe diturakes, ka mundësi të shijohet më dy lexime:


– Leximi i secilës poezi, pra i gjendjeve të pezullive, mentale dhe shpirtërore, për të hyrë në marrëdhënie me secilën sekuencë poetike, si një rast unik që zbulon një vëllim poetik, me dimensione të pazakonta, tepër të zgjeruara.

– Leximi i tërësor i vëllimit poetik, si për ta pirë, me një frymë, kupën e derteve dhe të mbërimeve të autorit, ma shumë të njeriut të librave, të bisedës imagjinare në mes autorit dhe Rabinin, që të fanitet edhe si një poemë, atipike, që prania e bisedës dhe protagonistëve, ta zgjon këtë shenjzim, jo se është përfundimisht ky shenjzim.

Në rrafshet strukturore-kohore, është një libër vetjak, një akt frymëzimi dhe thadrimi, që rrok dhe shpalon përmasën e një kalendari poetik, thelbësisht autorial, që përfshin pak muaj e shumë ditë nga viti i kaluar. Struktura poetike, që përbëhet nga mbi njëqind poezi, ose mikrostruktura, që endet në secilën prej tyre, dhe makrostruktura, që ka në bazë bisedën/kuvendimin e poetit me Rabinin, të dyja këto vatra, sendërtojnë dhe shqiptojnë gjendjet e shumta poetike, për dashurinë, jetën, filozofinë, fenë, seksin, kulturën, letërsinë, pra një botë e pamatshme, që sugjerohet nga autori. Poezia, siç pati pohuar Harold Bloom: ... është një thirrje profetike që meriton pa diskutim kurorën e letërsisë imagjinare. (2008: 69), ose kulla ku ngujohet copa e shpirtit dhe mendjes së trazuar, që buron nga kuvendimi i gjatë me Rabinin, ura ndërlidhëse e botëperceptimit, e zgjerojnë frymimin dhe semantikën, me bashkëlidhimi me Rabinin, mësues dhe udhërrëfyes, si pikë referenciale, si shkrim i brendashkruar, i përvojave të shumta shkrimore. Po kaq, struktura e vargut, që ka ritëm të brendshëm, ndonëse e bart shtegtimin e poezisë në kohë, ma tepër është eksperiment i ndërthurjes së poetikës klasike, e ngurosur në libra, që vjen me një shpalim modern, më gjasë të çatrafillosur, pra të çliruar nga poetikat orientuese, të cilat autori i refuzon dhe shpërfill, si pasojë e përvojës së gjatë në marrëdhënien jetësore me librin dhe me fjalën shqipe.

VDEKJA E BLETËS

tregim nga Fatmir Musai



Endjente se dora do t'i enjtej nga ai kafshim blete. Kështu i kishte ndodhur edhe më parë. Fillimisht një pickim i hidhur dhe një skuqje e lehtë, as sa një monedhë e vogël pesëdhjetë qindarkëshe, pikërisht në vendin ku agresorja kish ngulur thumbin e kaftë majëmprehtë. Më pas vinte kruajtja gjithnjë në rritje, ashtu siç rritej edhe e enjtura. Dhe në fund, kur pushonin, të dyja e merrnin këtë vendim njëherësh. Veçse e enjtura kërkonte kohën e saj për të kaluar në të kundërtën e vet, në çenjtje dhe, kjo e fundit, sigurisht që zgjaste shumë më tepër se procesi i parë.

Ai hodhi sytë nga insekti agresor, të cilin e kishte kapur për krahësh me mollëzat e gishtërinjve të dorës së majtë. Kur ajo iu afrua veshulit të rrushit që kishte në dorën tjetër, thjeshtë për ta larguar, ai e kishte lëvizur instiktivisht atë. Dhe, siç duket, po instiktivisht edhe bletëza ia kishte ngulur thumbin-ushtë. Thua të ishte keqkuptim midis palëve? Edhe mundet. Po ç'rëndësi kishte tashmë. Me të ndërë dhembjen therëse mbi trinën e dorës, ai s'kishte hezituar ta kapte atë nga krahët. Pa patur frikë se mos hante ndonjë thumb tjetër, pasi, kaq gjë ai e dinte mirë: Bleta vetëm një herë të thumbon! Sepse vetëm një thumb ka, ashtu si një shigjetar që ka vetëm një heshtë për harkun e tij.

Fillimisht, nën efektin e dhembjes, për pak sa s'e shtypi nën tabanin e sholltë të këpucës, por më pas ndërroi

mendje. Jo, i tha asaj. Nuk ndahesh kaq lehtë me mua. Të shohim sa do t'u rezistosh torturave! Dhe ishte gati të fillonte nga shkulja e këmbëve, por një zë i largët thellë brenda vetes, e ndali në momentin e fundit. Nuk vritet një bletë pse të hëngri, sikur i tha zëri. Është gjynah të vrasësh një bletë!

Po, pranoi ai në vetvete. Është një kumt i lashtë. Nga të gjitha insektet, vetëm për bletën populli e ka bërë këtë përjshim. Madje, më tepër se kaq. Nëse të gjitha insektet e tjera, mushkonjat, pleshtat, morrat, tartabiqët e ç'janë, të gjithë pickojnë, për bletën privilegji është i dukshëm. Ajo të kafshon, të ha! E ç'është një pickim para të të ngrënit? Hiçasgjë! I pari s'është veçse një mistrecllek, ndërsa i dyti, ah, kujdes me të dytin! Vërtetë e vockël, por zarinin e bën si një uj. Duhet melheme pastaj që të shërohesh...

Ndërkohë e enjtura po i avancohej. Ai sikur e ndjente helmin t'i përhapje nëpër kapilarët e dorës. Përhapja do të ishte në varësi të forcës së tij. Dhe e krojtura, në vend që të zbutej, po i rritej më tej. Të dyja në raport të drejtë, kruajtja me enjtjen. Dhe s'dihej kur do ta merrnin vendimin për armëpushim. Gjithësesi, atij po i ikte inati i parë. Jo se i kishte pushuar dhimbja. Përkundrazi, trina e fryrë e dorës e acaronte më tepër ndaj kafshëzës fluturake, të cilën, edhe pse ai tashmë e kishte lënë të lirë mbi suprinën e një pllake manjloke, ajo, jo vetëm që nuk largohej në fluturim, por

me zor hidhte disa hapa të vegjël, duke të krijuar më tepër përshtypjen e një zvarritjeje.

Për herë të parë atij i erdhi keq për të. Si harroi se bleta, po të thumboi, është njësoj sikur të ketë nënshkruar një vendim me vdekje për vetveten?! Ndaj u zvarritka kështu, mendoi ai. Mbase këto janë grahamat e fundit të jetës së saj. Ajo s'do të mund të kthehet më në pallatin madhështor të hojeve ku e presin mijërat e punëtoreve. Dhomëza e saj me portën gjashtëkëndëshe do të mbetet bosh dhe Mëma mbretëreshë do të urdhërojë një tjetër bletë të re ta mbushë hojin e saj me mjalte. S'do të ketë më fluturime të gjata nëpër mijëra e mijëra lule nëpër kopshtet e qytetit dhe kthimi në koshere me trastat e këmbëve plot nektar...

A ka më paqësore se magjia e nektarit në hojet e mjalit, mendoi ai. Ndërsa unë e vrava këtë misionare të paqjes! Sepse u tremba, ashtu kot. Trembja ime i ngjalli asaj instiktin e vetëmbrojtjes dhe më shigjetoj me thumbin-ushtë. Ajo harxhoi kështu armën e saj të vetme, edhe pse e dinte se, pakëtaj, do të vdiste edhe vetë! Ashtu si Akili kur vrau Hektorin. Perënditë e patën paralajmëruar se pas vdekjes së Hektorit, s'do të ishte e largët dhe radha e tij. Por heroi kishte një motiv shumë më të madh se jeta e vet dhe, duke vrarë tjetrin, njëkohësisht edhe u vetëvra!

Me sytë e ngulur tek insekti i kaftë, ai vuri re se ajo s'po lëvizte më. Ndjehej sikur të kishte kryer një faj. Për inat e acarim ndaj saj, as që mund të flitej më. Madje, idhnimi tashmë ishte në raport të zhdrejtë me dhembjen e enjtjes. Ai zgjati dorën, e mori trupin e saj dhe e vuri në mes të pëllëmbës. Ajo u rrotullua dhe këmbët e shumta i mbetën të palëvizura përpjetë. Mbaroi, tha ai. Vdiq! Nuk desha..., në fakt nuk desha..., as vetë nuk e di si ndodhi!

Me të në dorë, ai u ngrit në këmbë dhe bëri për nga kopshti i fqinjët ku gjendeshin gjithashtu koshere bletësh. Prej andej do të ketë ardhur, i tha vetes, por nuk bëri as disa hapa dhe u kthye pas. Ç'bëj dhe unë kështu, mendoi. Sikur të më shohë njeri, kushedi ç'do të mendojë. Edhe kjo më duhet! Por edhe ta hidhte bletën kuturu, nuk shkonte, të paktën në respekt të përsiatjeve që i solli, pavarësisht nga enjtja e dorës që, me sa dukej, po i pushonte. Në fund të fundit, nuk duhet të jetë pa gjë thënia se kafshimi i bletës të bën mirë, të sjell mbarësi. Po sikur ta gropos në tokë? Jo, jo, këtë do ta bënte ndonjë paranojak!...

Dhe pikërisht atëherë i lindi ideja më e pakundërshtueshme. Nuk e zgjati më, por me të në dorë, si në një ceremoni përshtypjeje intime, ai u drejtua nga trëndafilin më i madh i oborrit të tij. Ishte një trëndafil i bukur, i bardhë. Me kujdes ia hapi fletët e dendura dhe në thellësi të tyre vendosi bletëzën e kadifenjtë. Po me kujdes, sikur të mos lëndonte një kujtim të qelqtë, sërish i mbylli petalet, siç mbyllet kapaku i arkivolit. Dhe u ndje i lehtësuar.

Ajo tashmë ka varrin e saj, mendoi. Dhe ç'varr?!... E kush nuk do të donte që për varr të kishte një trëndafil?!...

I cilësuar nga vetë autori si “roman i vështirë”, *Arka e djallit* është vepra në të cilën derdhi më së shumti mund shkrimtari Dritëro Agolli. E filloi në fillim të viteve '80, kur shkroi, si thotë vetë, tri të katërtat e tij dhe botoi te revista “Hosteni” dy kapitujt e parë; e vazhdoi në fund të viteve '80 dhe e përfundoi vetëm në vitin 1996. Romani u botua një vit më vonë, i plotë, në shtëpinë botuese “Dritëro”.

Siç mund të shihet, një dekadë e gjysmë iu deshën Dritëroit që t'i vinte pikën këtij “romani të vështirë”, i cili mban në fund si datë të krijimit vitet: 1980-1989-1996.

Shikuar nga pikëpamja tipologjike, *Arka e djallit* është një roman polifonik në kuptimin e plotë të fjalës. Në strukturën e këtij romani gërshetohen plane e perspektiva të ndryshme rrëfimi dhe dëgjohen zëra të shumtë aktantëshe lokutorësh, që sajojnë një mozaik kompleks kompozicional e semantik.

Në themel të romanit *Arka e djallit* qëndron një konvencë e lashtë sa vetë letërsia: konvenca e dorëshkrimit të gjetur. “Arka e djallit” është dorëshkrimi *Shakaja e ndaluar ose Njeriu që e frenojnë kur qesh*, i mbyllur në një arkëz druri dhe i fshehur në baxhën e shtëpisë së kulturës të fshatit Qershizë (emër imagjinar i një fshati shqiptar të viteve '70, në Jug të Shqipërisë), që është skena kryesore në të cilën zhvillohen ngjarjet e romanit.

“Zbulimi” i kësaj arke - arkës ku ruhet dorëshkrimi i Bamkë Dynjasë - nga shkrimtari kryeqytetas, Sherif Abeceja, i cili vjen në fshat për këtë qëllim, shkakton një mori problemesh, si midis banorëve të fshatit, ashtu edhe në relacione më të gjera, që prekin probleme shoqërore, politike, etike, sociale dhe morale të shoqërisë shqiptare të gjysmës së dytë të viteve shtatëdhjetë të shekullit XX.

Dhe kjo ndodh për shkak se autori i dorëshkrimit në fjalë, që është sajësë e shkrimtarit, pra konvencë letrare, është njeri që tenton ta thotë të vërtetën për njerëzit që e rrethojnë dhe kohën në të cilën jeton, duke dalë nga skemat letrare të kohës. “Kur të njihen këto fletorka misterioze (...) do të shohin shkrimtarët e kryeqytetit se si mund të shkruhet e vërteta, që s'ka nevojë të mbahet mbi nagajkat e stolisjes së fjalëve”.¹

Në sajimin e dy prej personazheve kryesore të romanit, Bamkës dhe Cutes, shkrimtari nisat nga dy gjedhe të mëdha të kulturës ballkanike: Ezopi dhe Nastradini. Bamkë Dynjaja, fshatari i zgjuar, që zotëron gjuhën e alegorisë, është personifikim i Ezopit, sepse ashtu siç fliste fabulisti i lashtë për kafshët duke aluduar te njerëzit, ashtu edhe Bamka shkruan për ngjarjet e fshatit të tij duke aluduar në mbarë Shqipërinë. Ndërkaq, Cutja, me shakatë dhe batutat e tij, ta kujton personazhin komik të folklorit turk e ballkanik, Nastradin Hoxhën.

Në pasthënien me të cilën e shoqëron romanin, vetë shkrimtari shkruan: “Dy personazhet e romanit ‘Arka e djallit’, Cute Babulja dhe Bamkë Dynjaja, janë dy personazhet e përjetshëm Ezopi dhe Nastradini. Njëri, shkruan dhe vepron, si Ezopi - Bamka, tjetri vetëm udhëton dhe vepron, si Nastradini, Cute Babulja. Personazhi i tretë, Sherif Abeceja, është kërkuesi dhe zbuluesi i pafat, i zoti dhe i pazoti për të përballuar historinë në përgjithësi dhe individin në veçanti. Është krijuesi”.²

Arka e djallit është vepër ku humori, ironia, grotesku dhe parodia janë element fundamental i tekstit letrar, koncept dhe botëkuptim. Si rezultat i këtij përcaktimi, në roman është sendërtuar uniteti i nevojshëm mes personazhit dhe veprimit, që ishte ideal estetik i Henri Xhejmsit, i cili, në artikullin e tij të famshëm, *Arti i rrëfimit*, shtronte pyetjen: “Ç’është një personazh, përveçse

1 Dritëro Agolli, *Arka e djallit*, Botimet Dritëro, Tiranë 1997, f. 34.

2 Dritëro Agolli, “Pak histori dhe pak kujtesë për lexuesin”, pasthënie e romanit *Arka e djallit*, f. 462.

"ARKA E DJALLIT", NJË VEPËR POLIFONIKE

Nga Agim Vinca

*përcaktim i veprimit? Ç’është veprimi, përveçse ilustrim i personazhit?*³

Shkrimtari Sherif Abeceja, që është vetëdija qendrore e romanit, mund të quhet bartës i këtij koncepti teorik. Ai vjen nga kryeqyteti në fshat për të shtënë në dorë fletoren e Bamkës, e cila “mund të përvetësohet” dhe “të shëmtohet duke u përvetësuar”, por si pasojë e megalomanisë së tij bëhet vetë dëmtues i saj. (Defteri përfshihet nga flaka në fund të romanit).

Titulli i romanit, *Arka e djallit*, është një metaforë. Togfjalëshi “arkë e djallit” s’ka të bëjë me demonologjinë popullore, por sugjeron peripecitë që sjell dorëshkrimi i Bamkës pas daljes nga arka misterioze, që i ngjan kutsisë së Pandorës. Ky veprim, që zbulon absurditetin e revolucionarizimit të jetës në fshat: kufizimin e bagëtisë dhe të


3 Tzvetan Todorov, *Poetika e prozës*, Tiranë 2000, f. 27.

ngastrës para shtëpisë, shkakton shqetësim te njerëzit dhe e shtyn përpara zhvillimin e ngjarjeve në roman, duke e dinamizuar strukturën e tij.

Vetë autori e quan *Arkën e djallit* “dopjoroman” ose “roman në roman”. “*Arka e djallit është një dopjoroman: një i zbuluar dhe një i pazbuluar, njëri për fatin e personazhit, tjetri për fatin e krijuesit, në këtë rast të shkrimtarit. Këtu qëndronte edhe vështirësia e të shkruarit të këtij romani...*”.

Në strukturën e romanit hasen dy forma të rrëfimit, të cilat alternojnë njëra-tjetrën. Narratori i gjithëdijshëm, që mban në dorë penjtë e rrëfimit, përdor vetën e tretë, kurse rrëfimi i Bamkë Dynjasë zhvillohet në vetën e parë. I pari synon t’i shikojë ngjarjet nga distanca, pra në mënyrë objektive, kurse i dyti, që është autobiografik, jo.

Rrëfimin e tij për ngjarjet në fshat Bamka ia drejton shokut të tij të shkollës, Hyskë



Borobojkës, që është një personazh real i romanit *Arka e djallit*.⁴ Ndërsa për krijimin e personazhit të Cute Babules shkrimtarit i ka shërbyer si prototip figura e gazetarit të njohur shqiptar, Çoti Papuli, për të cilin flitet në pasthënien e romanit. Veçse Cute Babulja i romanit nuk është gazetar, por folklorist; merret me mbledhjen dhe studimin e folklorit; punon në Ministrinë e Kulturës në Tiranë, por del shpesh në terren; i ka qejf zifafetet, dollitë, mezen dhe rakinë; merret edhe me shkrimin e aforizmave me karakter humoristiko-satirik.

Prania e romanit hipotetik të Bamkës *Shakaja e ndaluar ose Njeriu që e frenojnë kur qesh*, të cilin ai ia “dedikon” mikut të tij, Borobojka, e bën më dinamike strukturën e romanit. Funksion të ngjashëm kanë edhe aforizmat e Cute Babules;⁵ lista e këshillave të tij për burrat; letra denoncuese e Maxhun Xhabalakut dhe shtresa të tjera të tekstit, të cilat e pasurojnë përmbajtjen e veprës dhe e thejnë linearitetin e rrëfimit.

Episodi i udhëtimit të tandemit Cute-Bamkë në Turqi, për të marrë pjesë në Konferencën folklorike në qytetin e Konias, është një nga episodet më interesante të veprës: një aventurë e vërtetë, me shumë situata komike, që t’i kujtojnë bëmat e Nastradinit. Cute Babulja i Dritëroit është një Nastradin shqiptar i kohëve moderne, i cili vepron në kushtet e një sistemi dogmatik, ku humori dhe shakaja nuk shihen me sy të mirë.


Antipod i tij është kritiku Mitro Karapataqi, personazh i njohur që nga *Shoku Zyllo*, që përfaqëson kritikun zyrtar të realizmit socialist, të cilin shkrimtari tani e karikaturizon plotësisht. Nëpërmjet figurës së tij stigmatizon kritikën panagjerike, që përdor fjalë të mëdha, por boshe (kritikët e tillë nuk i kanë munguar kurrë letërsisë shqipe), ndërsa përmes figurës së rapsodit Gjok Çoku (i njohur po ashtu nga *Shoku Zyllo*) parodizon patosin dhe retorikën stereotipe, që vazhdon të jetë e pranishme në një pjesë të poezisë shqipe.⁶

Nuk mund të flitet për *Arkën e djallit* pa iu referuar pararendëses së saj: *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo*, që është vepra më e njohur dhe më e vlerësuar e Dritëroit. Pa dashur të vemë në peshojë këto dy vepra, që i lidhin edhe shumë elemente të përbashkëta, mund të themi pa ngurrim se kritika ndaj rendit shoqëror të *Arka...* është më e thellë dhe më radikale se të *Shoku Zyllo...*; se teknika e rrëfimit është më e sofistikuar, me më shumë linja, ngjarje e episode; se ka numër më të madh personazhesh; se gjuhësisht vepra është më e pasur dhe se në këtë roman, të filluar në kohën e monizmit, por të përfunduar në pluralizëm, janë shmangur personazhet pozitive të futura dhunshëm të *Shoku Zyllo* për hir të kërkesave të metodës.

4 Hyskë Borobojka, pseudonim i shkrimtarit Gaqo Veshi, njeri nga bashkëpunëtorët e rregullt të revistës “Hosteni”, autor i disa veprave letrare e publicistike, i njohur për shkrimet e tij me frymë humoristike.

5 Të ndara në: Aforizma shoqërore, Aforizma politike dhe Aforizma kulturore.

6 “Nj’ ai prag i ngrohtë i Bamkës./ Kur vjen miku djeg prej flakës./ Djeg prej flakës, djeg prej zjarrit/ Siç i ka lezet shqiptarit”.



Shoku Zylo dhe Cute Babulja kanë të përbashkët shpirtin e aventurës, dashurinë për folklorin dhe kulturën popullore, por derisa Zyloja është mediokër (atij ia shkruan referatet Demka), Cutja është njeri me kulturë dhe mendjemprehtë. Hamës i madh dhe pijetar (fjalë e krijuar nga Dritëroi për ta dalluar njeriun që pi nga pijaneci), Cute Babulja është njëkohësisht edhe një pasardhës i largët i Pantagruelit të Rablesë, të cilin Hygoi e quante “Eskili i llupësisë”. Skena e futjes së tij në vallen e dervishëve melevin, është ndër skenat më të bukura të romanit.

Arka e djallit është vepër që zhvillon dialog, në kuptimin bahtinian të fjalës, me vepra, kultura dhe tradita të ndryshme letrare. Sikurse te *Shoku Zylo...*, edhe këtu, autori u referohet shpesh romaneve të mirënjohura satirike, si *Don Kishoti* i Servantesit, *Panairi i kotësive* i Thekerejt, *Shpirtra të vdekura* të Gogolit, *Tartarini i Taraskonës* i Dodesë, *Ushtari i mirë Shvejk* i Hashekut etj., që i konsideron modele të mëdha të këtij lloji letrar - romanit satirik.

Në roman përmenden, në kontekste të ndryshme, shkrimtarët shqiptarë: Naim Frashëri, Fan Noli, Faik Konica, Hasan Zyko Kamberi, Ibrahim Nezimi, Muhamet Kçyçku e të tjerë; poetët persianë: Firdusi, Rumi, Khajami dhe Saadi; shkrimtarët rusë: Çehovi, Tolstoji, Dostojevski etj., regjisorë si Fernandeli; gazetaret e përditshme turke: “Xhumhuriet”, “Milet” etj.; revista humoristike shqiptare “Hosteni”; citohen proverba të shumta dhe vargje nga këngët popullore; jepen të dhëna me karakter shkencor etj., gjë që e bën *Arkën e djallit* një roman me përmbytje të gjerë shoqërore, politike, letrare, estetike, antropologjike e, deri diku, edhe fetare (veçanërisht referencat për historinë e bektashizmit). Në roman ka referenca edhe për shkrimtarë klasikë si Homeri, Servantesi, Shekspiri, por përmenden edhe shkrimtarë modernë perëndimorë si Oskar Uajldi etj.

Bie në sy në këtë roman prania e elementit erotik si risi, në krahasim me prozën e mëparshme të Dritëro Agollit, me çka kemi parasysh sidomos skenën e aktit seksual të shkrimtarit Sherif Abeceja me mjeken e fshatit, Anthullën.⁷ Do thënë se qëndrimi i shkrimtarit ndaj personazhit Sherif Abeceja, ndryshe nga ç’është trajtuar në kritikën e deritashme (si zëdhënës i ideve të tij), është ambivalent. Agolli sa i afrovan, po aq edhe i ironizon veprimet e këtij shkrimtari “me famë botërore”, që, ndonëse personazh fiktiv, i trilluar nga autori, zgjon, herë-herë, edhe asociacione konkrete.

Është e veçantë mënyra si i formon emrat e personazheve Dritëro Agolli. Në këtë plan ai ndjek parimin e karakterizimit të tyre nëpërmjet emrave: Sherif Abeceja (sherifi në SHBA është funksionar i policisë, kurse ABC-ja është simbol i diturisë); Bamkë Dynjaja (mbiemri Dynjaja shpreh interesimin për botën dhe qëndrimin realist ndaj saj); Mitro Karapataqi me mbiemrin e tij të gjatë, shumërokësh, shenjon zhurmën që prodhon kritiku doktrinar në vend të kuptimit dhe përmbytjes; Spiro Arhitrari (Arhi+trari, që në shqip do të thotë “kryetar”), njeri me karakter të lig e konservator, që ruan dorëshkrimin e Bamkës, të cilin e cilëson në mënyrë keqdashëse me fjalët: “*thashetheme për krahinë, për fshatin, për mua, për ty, për atë...*”; Tahir Kapedani, Jashar Guna e Fasli Gropa, tre burra pleq e me mustaqe, që mbahen si veteranë të luftës, të cilët ngërthejnë në emrat e tyre elemente të kulturës materiale e shpirtërore shqiptare dhe të mjedisit ku jetojnë; Zyber Shtufa, kryetari burokrat i këshillit të fshatit, njeri pa karakter (shtuf - gur gëlqeror); ngjyrim pezhorativ ka edhe emri i berberit të fshatit Alush Karkanaqja etj.

Romani ka referenca të shumta nga folklori shqiptar dhe mitologjia popullore shqiptare, por edhe nga letërsia shqipe dhe e huaj; nga historia e fesë dhe e qytetërimit; nga shkencat e ndryshme etj., aq sa mund të thuhet se është paksa i rënduar me elemente të tilla. Agolli është shkrimtar që nuk ka paragjykimë për kulturat. Vend të veçantë në roman zë filozofia e poetit persian të shekullit të 13-të, Muhamed Xhelaledin Rumi, i mbiquajtur “Mevlana” (mjeshtër) dhe “hazreti” (profet), i cili muzikën dhe vallen i konsideronte mjet të arritjes së dashurisë hyjnore.

Arka e djallit është një thesar gjuhësor jo vetëm nga aspekti leksikor, por edhe nga ai frazeologjik, stilistik etj. Personazhet e Dritëroit janë “njerëz të krisur”, kokëkrisur, babaxhanë e aventurierë, kurse teksti i tij shumë herë del nga skemat dhe kallëpet e kohës.

Si roman polifonik, ku dëgjohen shumë zëra dhe ku, thënë me gjuhën semiotike, “një mori të shenjuarish bashkëjetojnë në gjirin e një shenjuesi të vetëm”, *Arka e djallit* mbetet një vepër e hapur për lexime e interpretime të shumta e të ndryshme.

(Tekst i paraqitur si kumtesë në “Javën e albanologjisë” të Institutit Albanologjik të Prishtinës, mbajtur më 6 qershor 2002)

Përkthyer nga Abidin Krasniqi, botuar nga “Fauves édition”, Paris.
Romani “Les oisillons du coucou: Souvenir d’un colon serbe”.

ROMANI “ZOGJTË E QYQES” I GANI MEHMETAJT, TASHMË FLET FRËNGJISHT

nga Bajram Sefaj

Kur e lexova romanin “Zogjtë e qyqes, të përkthyer në frëngjisht: “Les oisillons du coucou: Souvenir d’un colon serbe”, me përshkoi një ndjenjë e veçantë. Me riktheu prapa, por edhe me drithëroi, ma errësoi pamjen, por ma ndriçoi mendjen, me emocionoi por njëkohësisht me mbyti në pus kujtimësh. Të lexosh diçka që të duket sikur e ke përjetuar, ke kaluar nëpër ato ndeshtrasha, se si ndjehesh, pezull në ajër Vuajtjet rrëfohen nga goja e një koloni serbe me emrin Dragan, që i ka përjetuar të gjitha këto në lëkurën e vet, që bashkëjeton edhe me vuajtjet e shqiptarëve, që pikëllohet pse fati e përplasi në këto hapësira, pse ai dhe të tjerët si ai, nuk ishin ndryshe, pse ata nuk lanë gjurmë, por vragë, pse ishin zogj të qyqes, e nuk ishin zogj të dallëndyshes.

Është tronditës e pikëllues njkohësisht, ky rrëfim, është i afërt me ndjesi e i largët në kohë - gjysmë shekulli, mbërthyer në 270 faqe.

Libri i Gani Mehmetajt, i botuar në Paris nga shtëpia botuese “Fauves édition”, që nga muaji maj i këtij viti (2022), komunikon me francezë e më gjerë, me frankofon, në gjuhën e Balzakut e të Ygoit, Kamus e të Sartrit, një roman që i rrëfen vuajtjet dhe tragjedinë në Ballkan, një roman që të ngjallë kujtimet e hidhura. Ishim të rinj, ndërsa jetonim në kohë të pa kohë dhe në atë mos kohë, përpiqeshim të rrëmbenim një grimë lumturi, a pak dashuri që na e sillte jeta e mosha, mu si personazheve të këtij rrëfimi.

Secili shkrimtar e ka ëndërr që ta përkthejë romanin e tij në gjuhë e kulturës e të shkrimtarisë evropiane e botërore, në qendrën e letërsisë dhe të kulturës, ku jetuan e vepruan disa nga kolosët më të mëdhenj të letërsisë e të artit të përbotshtëm.

Kur u dha lajmi për botimin e këtij romanit në Paris, isha ndër të parët që e porosita me Amazon, isha ndër të parët që e rilexova.

Kadareja ishte i pari zog shtegtar, që e pushtoi jo vetëm Francën, miku im Gani me thjeshtësinë e këmbëngulësinë po përpiqet të pushtojë Francën e ëndrrave të veta, por ka ambicie edhe më të mëdha, të përkthehet edhe në gjuhë të tjera.

A do t’ia dal? Ai ka pretendime që Franca të jetë vetëm trampolina e parë.

Romani e kam lexuar një vit më parë në shqip, kështu që kur nisi ta lexoj në frëngjisht me dukej sikur e kam parë diku, e kam përjetuar, “déjà vu”, do të thoshin francezët.

Parakalonin para syve të mi personazhet e romanit, përftonin edhe fatet e tyre, ndërsa mua me sillnin në kujtime personazhet e mi të fëmijërisë e të rinisë, aq të ngjashëm. Ishte një tjetër Dragan e Dukagjin, një tjetër Nada e Neda, Vjollca e Sunçica.



Dhe është një ndjenjë e veçantë, sepse dashuritë e Zoranit, janë dashuritë e mia, ai e do një shqiptare, por që nuk e realizoi, unë isha i dashuruara në një kolone që me mbeti peng, e doja dhe i druaja, drithërohesh dhe frikësohesh, mbushesh frymë e me ndërpritej fryma.

Romani ka një gjuhë të ëmbël, emocionale, drithëruar që të ngjallë kujtime, të kthen në kohën e shkuar, që përpiqesh ta harrosh e nuk mundesh. Stili i të rrëfyerit është i veçantë, ashtu si është e veçantë tema që e trajton, z. Gani. Është risi në letërsinë shqipe, por risi tematike e stilistike edhe në letërsinë evropiane.

Ne kemi jetuar e bashkëjetuar me kolonë dhunshëm, por në letërsi sikur jemi kursyer të trajtojmë “bashkëjetesën” me ta, kemi ngurruar, ose i kemi paraqitur përmes ndonjë gjakësori, pa u thelluar shumë në jetën që ishte më komplekse.

Abidin Krasniqi, emër i ri në botën (oqeanin) e përkthimit (shqipërimin), bëri mirë që lexuesit francez, përmes një përkthim cilësor dhe mjaft të suksesshëm, ia ofroi këtë vepër letrare, këtë roman të Gani Mehmetajt që, që në botë e letërsisë shqiptare u paraqit një uragan i fuqishëm. Abidini bëri një punë të mirë, e kapi dhe e barti stilin e autorit, ka një gjuhë të rrjedhshme të përkthimit. Vlen të theksohet dhe nënvizohet se ai tashmë është sprovuar dhe i dësnuar, me përkthimin e librit epike “Lahuta e Malcis” të kolosit të letërsisë shqipe, Gjergj Fishta.

“Zogjtë e qyqes”, është fitues i çmimit prestigjioz “Kadare”, për roman të vitit 2021. Kjo vepër letrare e G. Mehmetajt, e cilësuar si gjetje tejet origjinale tematike dhe shtjellim i suksesshëm artistik, jo vetëm për arsye se ngadhënjëu me shpërblimin që mban emrin e shkrimtarit tone botërisht të njohur, por ajo ngjason në vepër letrare të Kadare të ditëve më të mira.



7 *Arka e djallit*, f. 410.

Papastasët ishin shpërngulur prej më shumë se një gjysmë shekulli nga Maqedonia Lindore pranë kufirit bullgar e ishin vendosur në qytet një fillim pranvere si muhaxhirë. Thuhej se ishte bërë shkak një vrasje për çështje nderi. Gjyshi i Lef Papastasit, Nikolla, kishte gjetur një bujar nga Leskovaci, Darko Pandureviçin, në krevat me të shoqen e tij. Thonë se serbi, që ishte mik shtëpie me Papastasët, bënte tregti të madhe. Por nuk i kishte rezistuar bukurisë së gruas që të grish në një qytet të vogël si Kumanova, në punët e seksit që janë dhe mbeten për cilindo të fshehta e në mister të plotë. Gjëja e parë që bënë sapo mbërritën në Liqenas, Nikolla me të shoqen ndërruan mbiemrin nga Grigorov në Papastathi, por gjindja aty në qytet ua thoshin mbiemrin Papastasi. Kishte shërbyer një mbiemër i Jani Papastathit, avokatit më në zë të Selanikut të asaj kohe, me të cilin Nikolla fitonte gjyqet me partnerët e tij grekë, kur këta ia dridhnin në punët e biznesit të miellit. Për grek e mbante veten sllavi shqipfolës e hiqej si i afërt i avokat Janit. Këtë e bënte edhe për t'u maskuar dhe humbur gjurmët nga frika e hasmit serb. Në Liqenas askush nuk ia dinte origjinën e vërtetë, edhe pse ishte bërë shumë shpejt i afërt edhe me kishën. Në të njëjtën rrugë kishte shkuar edhe i biri, Anastasi, por edhe i nipi, Lefi. Ndërsa Anastasi ishte bërë orëndreqës, i biri i tij, Lefi, ishte shndërruar në argjendarin më të madh të Shqipërisë së Mesme. Që të dy zanatet i kishin marrë në Selanik te miqtë e Nikollës, hebrenj që nuk e harronin asnjëherë, sidomos edhe për paratë dhe florinjte e grumbulluara që derdhte si dhurata për ata gjatë viteve që djali në fillim e më pas edhe nipi i tij, përgatiteshin për t'u bërë ustallarë e zanatçinj të zot. Anastasi solli një vajzë të bukur e shumë të hijshme, Maria Hararin, të bijën e Zaharias, që ishte vëllai i Moshesë, orëndreqësit më të mirë që kishte Selaniku në atë kohë, flokët e së cilës shkonin prapa deri në mes të trupit të kolmë vajzëror dhe që me bukurinë e saj e çmendti gjithë qytetin dhe e ruajti atë për shumë vite. Lefi shtiu kurorë me greken Dhespina Faranduri nga Kavalla në kishën "Shën Thanasi". Maria mbylli sytë nga një goditje zemre në ditën që i biri i saj, Lefi, kreu ceremoninë. Dasma u kthye në mort. Por edhe Dhespina kishte një bukuri të veçantë, saqë e admironin që të gjithë në Liqenas. Vajzat e reja kërkonin që t'i ngjanin asaj e ndonjëra prej tyre vishte edhe rroba si ajo. Vetëm Hedija, vajza e Mahir efendiut, thonin se e konkurronte për bukuri greken e bukur. Të gjithë ishin të mendimit se e bija e imam Mahir Sulejmanit kishte si avantazh njomësthinë e moshës dhe një tridhjetëvjeçare si Dhespina nuk mund të matej asnjëherë me një tetëmbëdhjetëvjeçare që i ndriste fytyra si një hënargjend e plotë. Mirëpo Anastas Papastathi la pas edhe dy djem e një vajzë. Edhe ata, pas Lefit, i nisi në shkollat greke në Greqi. Këtë herë që të dy në Athinë me dy vite diferencë, se ashtu kishin ardhur në jetë. Në fillim Minella ishte rregjistruar në universitet për doktor dhe tregojnë se në tre vitet e para kishte qenë nxënësi më i shkëlqyer i kursit. Pastaj ishte njohur me vajzën e profesor Themistokliut, një nga kirurgët më të mirë të kryeqytetit grek e më gjerë, nami i të cilit kishte zënë

PAPASTASËT

tregim nga Aleko Likaj



me kohë gjithë Ballkanin. Po të zinte me dorë doktor Mistoja, vdekja trembej menjëherë, thonin ata që e kishin njohur dhe ia dinin mirë historitë e shpëtimit të jetëve njerëzore atje në "Kalithea." Por e bija, Aliqi, zor se mund të qëndronte vetëm me një mashkull. Pas disa muajsh në lidhje dashurie me Minellën, afër një mëngjesi pa hënë, iku e çau detet duke e lënë në shtrat e në një gjumë të thellë studentin nga Liqenasi. Pas ca ditësh i dërgoi një kartë nga Barcelona duke i thënë se ishte e lumtur me të dashurin e saj të ri spanjoll. Fqinjët e doktorit treguan pastaj se kishte qenë një kapiten vapori që ia kishte prishur mendjen Aliqit. Një miku i Mistos në policinë e Pireut u tha në shtëpi se Hozia ishte një cigan nga Sevilja dhe se prej kohësh ndiqej si trafikant e kontrabandist i Mesdheut. Kishin qenë afër arrestimit, por ai u kishte lënë pendët në dorë, përpara se prokurori të nëshkruante fletën e arrestit. Kaq iu desh Minellës që të dashurën e tij me të cilën jetonte në një dhomë që prej tre muajsh nuk e kishte kuptuar dot, ndaj dhe u marros. Kishte bërë plane profesionale të mëdha për të qëndruar në Athinë si grek e si mjek, ndihmës i kirurgut të famshëm Themistokli Papas. Ky po ia hiqte edhe shpenzimet e shtëpisë në bashkëjetesë me të bijën. Por nuk qe e thënë. Kështu mendonte edhe vëllai më i vogël, Jani i Papastasëve, që kishte një vit aty në Athinë si student në financë, por që nuk e kishte fare për zemër shkollën. Shoqërohej me disa djem e shkante shpesh në shtëpitë e tyre për darka dhe orgji. Kishte zënë edhe një dhomë me njërin prej tyre. Tek i vëllai vinte rrallë. Nuk kishte nevojë për para, as për ato që ia niste Anastasi nga Liqenasi, se shumicën e shpenzimeve ia paguante shoku me të cilin jetonte. Aliqi dy herë i kishte thënë Minellës se i vëllai ishte ndryshe. Nuk i ngjante për burrë dhe se dyshonte se ishte homo. Studenti i mjekësisë nuk e besoi dhe i tha asaj që të mos ia përmendte më këtë muhabet tjetër herë.

Pa u mbushur java e largimit të Aliqit, Minella u bë keq. Doktor Mistoja e shtroi në klinikën e Onasios, te një mjek neurolog e psikiatër me emër në profesionin e tij në atë spital. Ai u kujdes për dashnorin e së bijës, por u trishtua kur mësoi se sëmundja kishte përparuar shpejt. Nuk ia tregoi as edhe letrën e së dashurës që mbërriti nga Barcelona. Nuk bëhej më ajo punë. Djali kishte humbur edhe vetëdijen dhe shpresat për një rikthim në gjendjen e mëparshme ishin shumë të pakta, për të mos thënë aq shpejt, fare. Por si mjek duhej të priste. I dërgoi lajm Anastasit të Papastasëve në Liqenas dhe u përkujdes për Minellën. Shkonte çdo ditë në klinikën e Onasëve, sapo mbaronte vizitat e tij në spital. Kur mbërriti i ati i studentit që u marros për vajzën e tij i, tha se do të bëhej gjithçka për të sëmurin dhe se shpresa vdes e fundit. Ndërsa darkonin në verandën e shtëpisë së tij, doktor Mistoja, bisedën e çoi te djali tjetër i familjes së Papastasëve, që e kishte braktisur shkollën e nuk donte t'ia dinte për atë. Kish zënë rrugën e qejfeve dhe gjithmonë e shihte rrugicave të Athinës me djem. Madje edhe duke u puthur. "Merre për zverku e hiqe që këndeje. Është bërë prostitutë. Këtë ta them si mik".

Këto ishin fjalët e fundit në atë mbrëmje të ngrohtë athinase me aromë limoni e qitroje, që vinin nga kopshti përpara shtëpisë, i mbjellë me agrume dhe ku yjet dukeshin lart si një grusht xixëllonjash të cilat flakëronin si fenerë që po u mbarohej fitili.

Orëndreqësi e takoi të birin, Janin, vetëm pas tri ditësh. Djali nuk pranoi që të kthehej më në Liqenas. Iku dhe e la babanë vetëm para kafeteri "Kretës" në Pire. Dy ditë më vonë Themistokli Papa e rregulloi me policinë, që ta çonin të lidhur deri në kufi. E gjetën me dy partnerë lakuriq në dhomën ku banonte prej një viti e ca. Ligji grek nuk e dënonte, por policët e akuzuan Jani Papastasin për prishjen e qetësisë publike. Kishte qenë në orgazëm.

Anastasi iku me mendjen prapa e me

një hidhërim të madh në kraharor për rrugën që kishte zënë djali i vogël. Qau në atë udhëtim të gjatë që zgjati disa ditë dhe ashtu me zemër të vrarë mbërriti në Liqenas. Të birit, Janit, i tha se do t'i jepte zanatin e tij dhe se Papastasët nuk mund të jetonin dot, nëse nuk kishin midis tyre një orëndreqës dhe një argjendar që po përgatitej në Selanik.

Kur kaluan tetë muaj, në molin e Pireut u shfaq portreti i një gruaje të imët që zor se ia dalloje fytyrën, e cila fshihej pas flokëve të verdha e të palara që shtriheshin deri në gjoksin e saj të fryrë. Poshtë tij, një bark i rumbullakosur që binte në sy, ta jepte menjëherë përshtypjen se kjo femër e vetmuar përballë detit që shkumbëzonte nën beton, ishte shtatzënë dhe pritej shumë shpejt që të bëhej nënë. Nëntori po shkonte drejt mesit të tij me erë që shfrynte kudo. Lart, një qiell i plumbtë nuk jepte asnjë shpresë se do të kishte ndonjë ditë me diell dhe se në mol do të pakësoheshin anijet e barkat që do të sillnin dhe do të merrnin mall për në udhët e deteve të tjerë.

I pari që e njohu gruan mbi mol ishte një punonjës i kapitenerisë së portit. Lart në një zyrë të godinës nga dritarja e dalloj, ndërsa era ia mori shallin e zi dhe në xhamin e rumbullakët të dylbisë iu shfaq qafa e hollë dhe e bardhë e ish shoqes së klasës në lice, Aliqi Papas. E admironte dhe e dëshironte atë kohë vajzën e doktorit, por ajo nuk e kishte mendjen tek Teofil Manalaqi.

Në mbrëmje i bënë vend në shtëpi. Dukej se ishte kthyer nga një tjetër botë, e lodhur e rrsakapitur dhe krejtësisht e përçudnuar. Brenda saj mbante një krijesë për të cilën tha se ishte e Minellës. Por askush nuk e besoi. Madje nuk e pyetën se si iku, pse dhe me cilin. E shpërfillën... Ajo e kërkoi studentin, por as edhe për të nuk i tha kush se ku ndodhej. Në mesnatë i ati, Mistoja, e dërgoi në Korinth dhe që andej në Salaminë me një barkë të një peshkatari vendës. Thonë që e mbylli në një spital. Atje lindi dhe krijesa që doli në dritë. Ishte vajzë. Nënë e bijë nuk u kthyen më te Papasët dhe për Aliqin e historinë e saj në Spanjë e në Greqi askush nuk mësoi gjë.

Nga mesi i pranverës, kur lulet e të gjitha ngjyrave të ylberit ndër saksit kutërbonin dhe jarganvanët e Athinës çelën përsëri sytha për të rifilluar nga e para ciklin e tyre të jetës, Themistokli Papas i dërgoi fjalë Anastasit të Papastasëve në Liqenas që ta merrnin Minellën, të pashëruar e të sëmurë dhe ta kthenin në vendin e tij, pa shpresë se mund ta rikthenin në normalitetet njerëzore. Mjekët e kryeqytetit grek ishin treguar të pafuqishëm për të çrrënjësuar marrosjen e studentit. Por babai i të dashurit të vajzës së tij nuk u nis më për udhë. Thonë se i kishte rënë damllaja dhe se familja kishte porositur Lefin, që kish mësuar tashmë zanatin e argjendarit atje në Selanik. Do të ktheheshin të dy në shtëpi, në Varosh, në lagjen e sipërme të qytetit buzë liqenit, por Anastasin atëherë do ta gjenin nën dhe. Një javë më parë kishte mbyllur sytë duke lënë Marinë të vetme e të ve në atë qytet.

Por edhe kjo do të kishte një fat të tillë.

Disa muaj më vonë i biri, Lefi, këtë herë do t'i sillte nusen, Dhespinën, që kishte shkuar e ta merrte në Kavalla.

Lexusi zbulon se burgu, që duket si vend, në romanin e shqiptarit Besnik Mustafaj "Një sagë e vogël" nuk është thjesht një vend. Romani, i botuar nga "Al-Aan", botues dhe shpërndarës, me përkthimin e Ibrahim Fadlullah nga shqipja, trajton ndryshimet e thella psikologjike, që i shkakton burgut të burgosurit, gardianit dhe familjeve të tyre.

Rrëfimi përbëhet nga tre libra, secili prej tyre shpalos një aspekt nga jeta në burg. Romani zbulon botën e errët të burgut dhe, nëpërmjet zbrërthimit të padrejtësive, bëhet edhe zbrërthimi i njeriut, të cilin e ka krijuar burgu. Ai lloj ndëshkimi nuk arrin të krijojë një njeri i ri dhe i shëruar. Romani nuk del jashtë realitetit të egër dhe po kështu atij nuk i mungon shpresa dhe optimizmi.

Në librin e parë: Bardhyl Huta tregon historinë e babait të tij, Omer Huta. Është një rrëfim i mburitur nga gjyshi, Oso Huta, me kontradiktat midis të vërtetës dhe dhe të asaj që është e fshehur. Gjyshi, gjatë regjimit mbretëror, kishte qenë i burgosur politik. Omeri u rrit në dy etapa të ndryshme: e para shkon deri në moshën dymbëdhjetëvjeçare. Kjo është një etapë, ku fantazia e tij krijon përfytyrimin për atë baba trim, i cili ka në gjoks një zemër dragoi; të babait, me të cilin lavdërohen të tjerët për heroizmat dhe trimëritë e tij. Ai është një burrë, që i kundërvihet shtetit, megjithëse i vockël në krahasim me shtetin e fuqishëm. Ky përfytyrim për babanë trim dhe të ndryshëm sa vjen e rritet në fantazinë e fëmijës, si një formë kompensimi për mungesën e babait në shtëpi. Në krahasim me fëmijët e tjerë, që jetonin nën kujdesin dhe mbrojtjen e baballarëve të tyre, Omeri kishte një baba ndryshe. Ky ndryshim ngjiz krenarinë e fëmijës, megjithëse është i detyruar të jetojë si të ishte një bonjak. Kur Omeri mësoi se babai i tij ishte në burg, iu ndez fantazia dhe vendosi që burgu të bëhet edhe fati i tij.

Burgu nuk është vetëm katër mure, por edhe ëndërrime e mendime

Por një ngjarje rutinë do ta shkatërrojë fëmijën. Kur, bashkë me nënën, vizitoi në burg babain, Oso Hutën, ai ishte në moshën dymbëdhjetëvjeçare. Ai vuri re se i ati s'ishte siç e kishte përfytyruar, por një burrë i dobët dhe i pafuqishëm, i poshtëruar deri

Shënime mbi romanin e Besnik Mustafaj "Një sagë e vogël", botuar në suplementin kulturor të gazetës "Al - Araby", më 9 mars 2022

Errësira sundon jashtë hekurave

nga Lejla Abdullah

në thellësi të shpirtit. Oso qan dhe përqafoi djalin e tij, Omerin, i cili, nga ana e vet, ndjen neveri për babanë e tij të ligështuar. I shpërthejnë lotët dhe ikën prej tij, për t'u rritur pa të. Vite më vonë, kur do të jetë për veten e tij baba, ai do ta paralajmërojë të birin, Bardhylin, se po të binte në burg, nuk do shkonte ta shihte.

Siç vepron fantazia në jetën e fëmijës, po kështu vepron ajo edhe tek i burgosurit, i cili, në librin e dytë të romanit është vet Bardhyli. Ai ra në burgun shqiptar pasi vendi u bë Republikë Popullore Socialiste. Bardhyli rikthen jetën e gjyshit të tij pas gjashtëdhjetë vjetëve. Pas njëmbëdhjetë muajsh në burg, ai ka frikë të takojë të shoqen, Lindën. Fantazia e tij seksuale përflaket kur mendon për një takim me gruan e vet të ligjshme. Por fantazinë ia vranë dy paralajmërimet: njëri prej shokut të tij në burg, që sheh se ai po shkon në takimin e premtuar dhe i thotë: "O i gëzuar! Mos u gëzo!" dhe tjetri nga gardiani, i cili i kujton: "Ruaje gozhdën në tru!".

Ëndrrat poetike të të burgosurit transformohen kështu në një lloj holuçinacioni, që vazhdon gjatë gjithë kohës së takimit me gruan. Ai përfytyron të jetë i pranishëm bashkë me ta, në dhomën e posaçme të takimeve brënda burgut, edhe polici, mbajtësi i uniformës ushtarake, gjë që e pengon atë të sillet normalisht me gruan e vet. Shto edhe frikëra të tjera, që e brenin me ngulm trurin e tij, si ajo për Lindën, humbja e besimit në vetvete si dhe ajo miza, që i gumëzhinte vazhdimisht në vrimën e veshit. Të gjitha këto e penguan afrimin e

Bardhytit me gruan e tij. Gjatë përçarjeve të tij pasqyrohet sa e madhe është dhuna, që aplikon shteti kundër armiqve të vet. Kjo e shtyn Bardhylin të mendojë se ajo dhomë takimesh ishte përgatitur për takimin e babait me gjyshin e tij dhe për takimin e atij vet me gruan e tij. Por ajo tashmë ua kalon pajisjeve të tortures në burg. Kjo, sepse i burgosuri e kupton dhimbjen që e ka pllakosur, duke shkatërruar, në mënyrë të pandreqëshme, përfytyrimin e vjetër për të dashurit e tij.

Në librin e tretë të romanit "Një sagë e vogël" ngjarjet zhvillohet jashtë tij. Për lexuesin bëhet e qartë se i gjithë romani shtjellohet rreth detyrës dhe përgjegjësisë. Shkrimtari tregon historinë e tre shembujve, që e japin këtë preambulë para botës. Kjo, sepse pas largimit të italianëve dhe në pritje të pushtimit të Shqipërisë nga gjermanët, organet e shtetit ishin inekzistente. Por, si gazetari, si gardiani ashtu dhe ushtaraku i dalë në pension mbeten besnik të përgjegjësive të tyre. Secili prej të treve është shembull i njeriut, të cilin e burgosin përjetë përgjegjësitë e tij. Burgu nuk është vetëm në kështjellë, por edhe në veprimet që njerëzit kryejnë gjatë jetës së tyre.

Shpërbërja e përvojës së burgut nuk do të thotë se njeriu del prej tij i shëruar

Linda tregon historinë e gjyshit të saj, Hyqmet Hidit, me qëllimin për të kuptuar kompleksin e nënës së saj për burgun, pasi ajo refuzoi martesën e vajzës së saj me Bardhylin. Ajo deshi ta martojë atë në një


vend, ku s'kishte burg politik. Linda arrin tek historia e gjyshit: në kohën, kur italianët largohen, të burgosurit ikin nga kalaja-burg, duke marrë me vete gardianët, me qëllim që t'i ndëshkonin për keqtrajtimin që u kishin bërë. Por ata e lënë Hyqmet Hidin të lirë, sepse ai kishte qenë i mëshirshëm me ta. Në pritje të qeverisësve të rinj të Shqipërisë, gardiani Hidi nuk mund ta durojë burgun të zbrazur. Ai mbledh gurë dhe i mbyll nëpër biruca. Për këtë ai konsiderohet i çmendur, duke bërë me turp gruan dhe vajzën e tij, nënën e Lindës. Kjo pas një thashethemi, sipas të cilit, ai do t'i arrestonte të dyja për të bërë një burg të vërtetë me njerëz të burgosur.

Në roman jepen shumë tregime rreth çasteve të fundit të Hyqmet Hidit në burg, para se t'i vinte fundi. Në vend të dhunës shtetërore, romani zbulon një lloj tjetër dhune: dhunën e njerëzve. Kemi aty historinë e një gazetari pa gazetë, e një luftëtari pa ushtri dhe e një të burgosuri pa qenë në burg. Në këto shembuj, që jetojnë me një punë në boshllëk, rrjedh shakaja e njerëzve, pas të cilës fshihet poshtërsia e tyre. Në pritje të ardhjes së nazistëve, përballë egërsisë së njerëzve dhe dhunës së tyre, që vijnë si pasojë e përvojave të këqia lidhur me aparatit shtetëror, mbeten pikëpyetjet e të çmendurit për përfundimin e diktaturës.

Nga errësira e burgut, vend i mbyllur, i cili përbën një laborator të pasur për çdo shkrimtar, Besnik Mustafaj transmeton pikëpyetjet për burgun, në mes të mureve të kalasë, tek të gjithë llojet e tjerë të burgjeve, duke filluar nga përfytyrimet e personazheve për veten e tyre dhe për të tjerët e duke përfunduar të përfytyrimet e ndryshme rreth burgut, që kanë të tjerët në mejdisin shoqëror, si dhe për arbitraritetin e tyre në fatin e njeriut. Ndërsa errësira e egër e burgut e merr errësirën e saj nga lidhjet që ka me mendimin dhe nga shkatërrimi që i bën njeriut nga brënda.

Përktheu nga origjinali: Sulejman Tomçini

**Lejla Abdullah është shkrimtare dhe kritike letrare e njohur tuniziane.*



Fushat Eliziane¹ të Parisit ishin shndërruar brenda një nate në fushëtirën e vdekjes. Shëtitorën më vezulluese dhe më të populluar të botës e kish mbuluar ploja e hirtë e pandemisë Covid-19 që kish mbërthyer njerëzimin. Tinëzish, e beftë, e padukshme, e egër, e pashmangshme, e pabesueshme, autoritare dhe e rëndë si vetë frika e njeriut nga vdekja. Frymë gjallese. Heshtje mortali. Shitoret prestigjioze lëngonin qepenmyllura. Dritat ulëritëse të reklamave përloteshin të verbuara.

“Këtu ndoshta matet pesha e gjëmës!” - mendoi Teuta kur taksia me të cilën udhëtonte kaloi Sheshin e Yjeve pranë Harkut të Triumfit dhe u derdh në Champs-Élysées. Uli ngadalë xhamin e dritares në krahun e saj dhe ndjeu se ajri përjashta kishte ngrirë, ishte qelqëzuar dhe nuk përcillej dot gjer në mushkëri. Bunacë. “Prite kur t’ia behë reja e zezë, flatruese dhe kërcënonjëse e zogjve vrasës”, - vijoi ajo të mendonte, sepse në çast iu bë se po udhëtonte lëndësisht nëpër një film të frikshëm të Hitchcock-ut. Diku iu pahit hija e një patrulle policie që u zhdruk vetëtimthi në një cep ngrehine sikur ta kish përpërë dheu. “Janë njerëz a shpirtra?” - i kaloi pyetja mospërmasë kafkës si një e therur migrene. “Me siguri shpirtra, - i erdhi përgjigjja nga mospërmasëkafka, - shpirtra heronjsh që enden Fushave Eliziane të rrethit të parë të Ferrit...”

Kur taksia që dukej sikur po rrugëtonte në zbrazëtirën e botës mori kthesën për në Avenue Marceau, ku në dritaren e një ngrehine valëvitej flamuri i vendit të saj, Teuta pikasi që larg në atë shkreti, pothuaj me gëzim, një formë njerëzore në krye të një rrugice. Ishte një formë ngjyrë dheu që spikaste në zbardhësirën e agimit, e përgjumur, e palëvizshme, por njerëzore. Një formë që me siguri kishte shpirt, mish dhe gjak. Ajo nuk ia ndau sytë derisa taksia që hante shpejtazi udhën (ose e villte atë) iu avit vendit dhe i tregoi se ishte, në të vërtetë, një fole e braktisur të pastrehësh, e ndërtuar me ca batanije që kishin marrë formën e trupit njerëzor. “Nëna ime, - ofshau gruaja e re vetë me vete, - edhe clochard²-ët kanë marrë arratinë!”

Ukrodh sërish në filmin e Hitchcock-ut si në një realitet që tani ia kish huajtur Zoti dhe vijoi lëndësisht vozitjen si një fluturim përmes tij, duke mos ia ndarë vështrimin që sipër taksisë së saj e cila udhëtonte rrugëve, shesheve dhe bulevardëve hënore të Parisit. E pikasi tek kaloi përpara monumentit *Hotel des Invalides* që asaj ore të zbardhëllimës dukej madhështor, mbuluar me brymën e mëngjesit që i jepte pamje fantazmagorike, por edhe të ngarkuar me një barrë misteri. “Napoleoni prehet brenda atyre mureve, poshtë një kubeje...” - tha vetë me vete. “Po a ishte vërtet Napoleoni ai që dergjej në katër arkëmortë poshtë kubesë?” - pyeti sërish veten. Kjo e fshehtë që kishte pothuaj dyqind vjet që turbullonte zemrën e francezëve ia mësyu mendimet dhe nuk e la të përsiatej për fatin e saj. Ndjeu befasi në qiellzë një shije të metaltë të frikshme të cilën e identifikoi si shijen e arsenikut me të cilin thuhej se anglezët helmuan Napoleonin syrgjyn në ishullin e Santa Elena-s. “A ishte punëmbarruar arseniku?”

1 Fushat Eliziane - në mitologjinë greke është vend në Ferr ku qëndrojnë shpirtrat e vdeqshëm. Në Paris është shëtitorja më e bukur e Francës dhe e botës, Champs-Élysées në frëngjisht, e gjatë dy kilometra, që ndjek aksin historik të qytetit dhe lidh sheshin *Concorde* me sheshin *Charles-de-Gaulle*.

2 Clochard - endacak, lypës.

Fragment nga romani i ri

MIRA MEKSI PUTHJA E AMAZONËS

Kur dashuria nuk vdes, vret



Shkaktonte një vdekje të rrefeshme pa dhembje apo, përkundrazi, pillte një agoni të gjatë e të mundimshme?” - vijonte ta mundonte veten me pyetje.

Nuk e ndalte dot mekanizmin e mendimeve që punonte etshëm dhe në drejtimin që i tekej. Sërish i doli përpara syve të mendjes foleja e braktisur e të pastrehëve; gjersa mbërriti në klinikën *Saint Jean de Dieu* përmes filmit të tmerrit dhe pa ia ndarë sytë taksisë së saj që bënte të njëjtën udhë poshtë, përsiatej: “Ku kanë shkuar vallë clochard-ët e Parisit? Ku janë fshehur për t’i shpëtuar virusit me kurorë në kokë dhe me kosën e pashmangshme të vdekjes në dorë?” Iu ndërmend befasi një pastel i Georges Tournon-it me titull *Les deux clochards*³ që e pati mrekulluar me ngjyrat e tokës dhe pamjen e dy miqve të vobektë që më shumë se “clochards” asaj i qenë dukur si apostuj dhe për herë të parë që prej kohësh munda të buzëqeshte.

Iu kujtua aventura e pak ditëve më parë kur ende nuk ishte shpallur pandemia:

3 Les deux clochards - Dy lypësit.

lau vezullimshëm Rrugën Mbretërore që hapej përpara Madeleine-s sipërane. Hodhi vështrimin gjer ku i hante syri dhe shqoi në fund të Rrugës Mbretërore sheshin *Concorde*, më të madhin e Parisit, të ndriçuar si për festë, me fenerët përrallorë nëpër të cilët litarët e shiut ishin qepur si girlanda drite; në mes të tij qëndronte Obelisku përmbi tremijëvjeçar i tempullit egjiptian të Louxor-it. Teuta ndjeu një rrëqethje të fortë, sepse pa tek ai atë grimë kohe përjetësinë të larë nga shiu me një piramidë të artë në majë. Mbeti si e shtangur nga magjia që rrezatonte deri tek ajo monumenti prej graniti dhe e harroi për pak çaste kohën, sëmundjen, operacionin e rëndë që e priste, ankthin, veten... Ndjeu se si lumi i kohës e mori me vete si një guriçkë bregu dhe mendoi e mrekulluar se, sido që të shkonte puna, do të mbetej në jetë të jetëve si krizalidë brenda atij çasti, që po kristalizohej në kujtesën e saj dhe të vetë universit.

Bëri të zbriste shkallaret e mëdha kur në të djathtë të ngrehinës së Madeleine-s pikasi një rreze drite që dilte nga një derë pakëz e hapur. U nis drejt saj me shpresë se mos ishte një tjetër hyrje për në kishë. E shtyu derën dhe dikush i doli përpara.

- Është hapur? - pyeti ajo me mendje për kishën.

- Po, - iu përgjigj i panjohuri dhe i lëshoi udhën. - Hyni, ju lutem.

Hyri. Një ngrohtësi e ëmbël e mbështolli të gjithën në çast dhe sa hap e mbyll sytë u gjend e ulur në një tryezë të gjatë me të ftuar të heshtur që darkonin pa folur. Pa ngjyrat e buta të kafes së tokës, të thjeshta e thellësisht njerëzore, të pastelit të Georges Tournon-it dhe vetëm kur i vendosën një pjatë me supë përpara pa e pyetur se kush ishte dhe se nga vinte, kuptoi se gjendej në strehën e Madeleine-s për të vobektit, clochard-ët. E kuptoi përnjëherë gabimin, mori të ngrihej, por aroma e mrekullueshme e supës i gicilo flegrat e hundës dhe u kujtua se nuk kish mundur të fuste gjë në gojë që një ditë më parë; ndjeu uri, mori ngadalë lugën, e mbushi me supën e pruarur dhe nisi të hante. Nuk guxonte të vështronte përreth nga frika se mos e zbulonin që nuk e kishte vendin aty. Nga një kanistër e vogël në tryezë mori një bukë të vogël të rrumbullakët, të njohur dhe vetëm kur nisi të përtypte tulin e saj të shkrifët, të grunjtë, i ra mendjes se kishte shijen e bukës së meshës.

Ajri ndërkohë ishte mbushur me një aromë të lehtë temjani për atë që dinte ta dallonte. Teuta e pikasi aromën që kishte kërkuar me aq ngulm atë mbrëmje dhe mbushi mushkëritë. Paqja e Madeleine-s iu ndeh sakaq në gjithë trupin. Kaloi minuta pa mbarim në atë gjendje të mrekullueshme kur nisi të mërmëriste vetiu lutjet e vjetra të një gjysheje antike. Dëgjoi që e tërë atmosfera dritëvakët e strehës së të vobektëve filloi të mbushej me pëshpërima lutjesh. Ishte e pabesueshme se si të gjitha lutjet u duk se u bashkuan në një lutje të vetme, si një pëshpërimë e fuqishme dhe ndezullitëse që e ktheu strehën e të vobektëve në kishën e shumëkërkuar për paqen e shpirtit. Atëherë gruaja e re ngriti kokën dhe guxoi të vështronte ballazi dhe rreth e përçark. Teutës iu duk se pikasi mbi kryet e të ftuarve të tryezës një si brerore të lehtë drite - clochard-ët e Parisit ngjanin si apostuj. “Pamja e *Darkës së fundit në Jerusalem!*” - mendoi Teuta, u ngriti si e kalamendur nga mesorja, doli ngadalë

prej derës brinjore të Madeleine-s dhe iu dorëzua ngricës së marsit parisian. Me vete pëshpëriste pa mendje fjalët e Birit të Zotit në *Darkën e fundit*: “Merreni, hajeni, ky është trupi im! Merreni, pijeni, ky është gjaku im!”

Tri ditë më vonë zezona ishte bërë flamuri i botës – ishte shpallur pandemia! Kryetarët e shteteve shfaqeshin të trembur nëpër ekranet e vogla. Vështrimi i tyre i përhumbur tregonte se jo vetëm ishin zënë gafil nga virusi vrasës, por edhe se të ardhmen e shihnin me frikë. Buletinët e Covid-19, si buletinë lufte, nuk ndillnin asgjë të mirë: mijëra të vdekur çdo ditë, spitale të mbushura tumbllas, spitale fushore në ndërtim, stadione të kthyer në spitale. Urdhri i ditës: distancim, maska dhe xhel dezinfektues.

Nëpër farmacitë e Parisit nuk kishte maska, thuhej se shteti kish mbledhur tërë stokun e tyre që të pajiste personelin shëndetësor. Letrat higjienike u kthyen në maskat e para antivirus, pastaj amvisat nisën të qepnin maskat prej cohe. Edhe solucioni virusvrasës mungonte. Rrugëve të Parisit nisën të shfaqen xhelbërëset kundërkovid ambulante, si karrocet me mollët prej sheqeri të Gegës në fëmijërinë e saj që i mësonin qytetarët e Republikës së Pestë se si ta përfitonin në kushtet e shtëpisë. Mjekë gjithfarësh, mjekë infeksionistë, shkencëtarë, profesorë, gazetarë, aktivistë socialë, sharlatanë, mësues masmedian duke prodhuar një kakofoni po aq të frikshme sa vetë pandemia. Nëpër rrjetet sociale ishin shpallur teoritë e para komplotiste.

Në lajmet kryesore të orës njëzet të ditës së hënë, 16 mars, presidenti i Francës, riaku Macron, shpalli, me një qëndrim pozues alla gjeneral De Gaulle, gjendjen e jashtëzakonshme të luftës: mbylljen. “Jemi në luftë”, - tha dhe pastaj shtoi: “Vive la République! Vive la France!”⁴

E nesërmja nisi të rrëshqiste mundimshëm udhëve të kohës me një mantel të zi mbi krye. Njerëzit mund të dilnin nga shtëpitë e tyre vetëm me lejen e policisë dhe për shërbimet më jetike. Ishin kthyer në hije, me maska nga më të çuditshmet në fytyrë. Ngjanin sikur bënë në vendnumëro brenda një kohe absurde që rrokullisej me një shpejtësi skëterrë drejt një të keqeje që vetëm rritej dhe merrte forma të përcudme; edhe ajri jashtë u shpall i molepsur nga virusi, edhe uji, edhe drita. Madje drita e diellit, në vend që ta vriste virusin, siç e gjithë bota shpresonte, po e ushqente. Gjindja pëshpëriste: të mjerët ne!

Në Champs-Élysées, në fasadën e një ngrehine luksoze ku ditë më parë fekste reklama e një marke të madhe veshjesh, tani nxironte një graffiti gjigante, dy gojë të çapëlyera, të ngërthyera me njëra-tjetrën, si të nxjerra nga pikturat e Picasso-s; diçitura: “Pushkatohet puthja!”

Një video që, si rrallëherë, pati dy interpretime të përkundërta dhe të prera me thikë, një tragjik të thekshëm dhe një komik gazmor, bëri xhiron e botës: policia tërhiqte zvarrë të prangosur derisa e fuste në furgonin e saj një grua lypsare dhe të pastrehë, me moshë të papërcaktueshme, trupgjatë dhe me një kasketë gavros të rrasur gjer te sytë, që nuk pranonte të linte strehën e saj prej endacakeje diku në afërsi të hotelit luksoz *Plaza Athénée* në shumë të njohurin shesh *Avenue Montaigne*. Me një shishe konjaku në dorë gruaja përpëlitej sa mundej të çlirohej

nga duart e policëve, ndërkohë që me një zë bubullimë këndonte *Marsejezën* që kishte një tingëllim të fuqishëm rrugëve të zbrazura të Parisit.

Arriti që një çast t’u shpëtonte prangosësve dhe ndërsa ata u lëshuan turravrap pas saj, ajo i vuri shpatullat portës së *Plaza Athénée*-së së ndriçuar nga dhjetëra drita që e veshën gruan në çast me një vello të kuqe gjaku dhe zuri të ulërinte me sa i hante fyti: “Aux armes citoyens!”⁵ Atij çasti ra ora 20:00 dhe nëpër ballkone, tarraca dhe dritare njerëzit dolën si me komandë, ashtu siç bënin përnatë, e nisën të duartrokisnin për heronjtë e spitaleve, mjekët, infermierët, tërë personelin shëndetësor që luftonte ditë e natë për të shpëtuar jetë njerëzish. Përmbi oshtimën e duartrokitjeve të solidaritetit dëgjohej thirrja e tmerrshme e endacakes “Rrëmbeni armët qytetarë!” dhe shishja e konjakut që tundej në dorën e saj si një flamur në betejë. Dukej sikur qytetarët e Parisit po i përgjigjeshin thirrjes së endacakes dhe nga çasti në çast do të zbrisnin shesheve me armët në dorë për një tjetër revolucion francez.

Sado që ishte munduar jo pak, sado që e kishte sflitur veten me pyetjen se cila peshë e së keqes i rëndonte më shumë në shpirt, sëmundja e saj apo pandemia që kish pllakosur mbarë njerëzimin, nuk kish mundur dot të merrte një përgjigje. Kishte, megjithatë, edhe një tjetër barrë të rëndë që ia torturonte zemrën ca më ligisht se dy të këqijta e para, por që Teuta përpiqej ta mbyllte me çelës në një skutë të shpirtit dhe ta hidhte çelësin në det – thyerja e pakuptimtë e dashurisë, braktisja e përnjëmendtë që i kish helmuar gjakun. Kish ndodhur njëkohshëm me zbulimin e sëmundjes së rëndë; më saktë, sëmundja kish qenë prelude, sipari i saj.

Së bashku me Skerdin shijonin prehjen e ëmbël të pasdashurisë në shtratin e madh të apartamentit të saj të ri në një lagje me emër të Tiranës, dhuratë e prindërve të saj. Ishte nata e parë, që kur ajo kish mobiluar apartamentin e vogël, që ai kish vendosur të flinte aty. E kishin bërë në plan të festonin 25-vjetorin e saj, i cili kish qenë përpara një jave, kur ai ndodhej në një koloni piktorësh që po vizitonin veriun e vendit me dëborë.

Kishin një vit që dashuroheshin, ndonëse njiheshin prej shumë kohësh. Kishin mbaruar të dy studimet e larta në Francë, ai për pikturë në *Beaux-Arts* të Parisit, ndërsa ajo për letërsi në Universitetin Paris-Sorbone. Ishin

⁵ Aux armes citoyens! (fr.) – Rrëmbeni armët qytetarë! Është vargu i këngës patriotike *Marsejeza* e kthyer në himnin kombëtar të Francës.

takuar së pari në festën kombëtare që organizonte ambasada shqiptare që në fillim të studimeve të tyre dhe kishin pirë disa herë kafe më pastaj, gjithmonë në ëmbëltoresh *Odette* pranë universitetit të saj, nga qelqnaja e së cilës shijonin pamjen e jashtëzakonshme të katedrales *Notre Dame*. Asokohe Skerdi ishte i dashuruar marrëzisht me një shoqe kursi, Ranin, një indiane nga qyteti i famshëm i Agras, ku ngrihet Pallati i Dashurisë Taxh Mahal, e cila ishte edhe muza edhe modelja e shumë punimeve të tij.

Ndërsa Teuta ishte dashuruar me të që në takimet e para, kur rrinin me orë të tëra në kafene për të komentuar gjithçka, sidomos gjendjen dhe politikën e vendit të tyre, mundësitë e mëdha për t’u integruar në BE dhe apatinë mizore të politikanëve shqiptarë, korrupsionin e tmerrshëm që brente vendin e vogël dhe lëngatën e tij nga firmi i gjakut të të rinjve që e braktisnin çdo ditë. Ishte një ndjenjë e bukur zemre që vajza e ruante me kujdes në një peshtaf ëndrrash. Ndoshta kurrë nuk do të provonte asnjë puthje prej tij, por i gëzohej miqësisë që kishin dhe mendohej shumë të mos i shpëtonte asnjë gjest, asnjë drithërimë zëri apo turbullim shikimi që do t’i tradhtonte ndjenjën e ëmbël. Nga frika se mos e humbiste miqësinë. Ishte ndjenja e saj e fshehtë, vetëm për të, e pashpresë vërtet, por që i kish zbkuruar jetën.

Meshkuj hynin dhe dilnin në jetën e saj pa mundur dot t’ia zbehnin ndjenjën për Skerdin. Një natë në teatrin *Mogador* të Parisit, ku Skerdi me Ranin e kishin ftuar për të parë komedinë e famshme muzikore *Cats*, Teuta vuri në provë shpirtin e saj. Ndonëse ishin të kujdesshëm dhe nuk e shfaqnin, ajo dalloi dashurinë e madhe që projektohej edhe në buzëqeshjen e ndrojtur të Ranit edhe në shkëlqimin e syve të Skerdit, lumturinë e tyre pa asnjë notë të rreme, në një harmoni të përsosur. Dhe sikur të kish ndodhur një mrekulli shpirti, u ndie e lumtur për lumturinë e tyre. U kish shpëtuar pa asnjë sforcim kurtheve vdekjeprurëse të xhelozisë dhe kish ruajtur ndjenjën e saj për Skerdin pa u rrokullisur honeve të zhgënjimit.

Më vonë, të dy ishin kthyer në Tiranë. Teuta kish punuar pas studimeve një vit në një shtëpi botuese të madhe të Parisit, ndërsa piktori ishte kthyer menjëherë në Shqipëri pas marrjes së diplomës. Ajo i qe përkushtuar përkthimit letrar dhe mësimdhënies në Fakultetin Filologjik, ndërsa Skerdi, familja e të cilit jetonte me rentat e pronave të panumërta të rikthyera nga regjimi demokratik, i qe kushtuar me mish e shpirt pikturës dhe kish hapur dy ekspozita njëra pas tjetrës.

Në njërën prej tyre e pati ritakuar Teuta dhe që atë çast nuk ishin ndarë më. India ishte kthyer tani në një kujtim të largët. Kur Teuta kuturisi dhe ia përmendi ish-të dashurën në fillim të lidhjes së tyre, pikasi një të krisur të thellë në qelqen e syve të tij, sikur një dhembje e madhe t’i kish çarë po njëlloj edhe shpirtin. Por Skerdi nuk e dha veten, la të kuptohej se ishin ndarë thjesht ngase ajo nuk kish pranuar as ta vizitonte Tiranën, pale të mendohej se mund të vinte të jetonte në Shqipëri, ndërkohë që ai pati shkuar deri në Agrasin e saj për të vizituar mrekullinë e botës, Taxh Mahalin, i cili, për hir të së vërtetës, e kish bërë të nxirrte nga peneli i tij vepra të çmuara. Gjithsesi, Teuta kuptoi se një krusmë e madhe duhet ta kish vulosur ndarjen e tyre.

Një nudo të sajën të mrekullueshme, vizatim me penë i Skerdit, një nga të paktët që i pati shpëtuar shkatërrimit dëlirës të ndarjes me indianen, Teuta e kish varur përmbi shtratin e madh të dhomës së gjumit – format e trupit të Ranit përsomërisht të lakuara ngjanin si kularët e frikshëm gjarpërorë të një reptili hyjnor. Sa herë që piktori dashuror e pyeste Teutën nëse i ndillte, gjithsesi, një lloj xhelozie ndaj Ranit ai vizatim përmbi kryet e shtratit, ajo i jepte gjithashtu të njëjtën përgjigje, të cilën me sa duket ai nuk lodhej së dëgjuari. “Përkundrazi, - ia kthente ajo, - këto lëmaja trupi të ephshëm femëror rrezatojnë një lloj sensualiteti mistik aq të fuqishëm sa më prushojnë lëkurën sa herë i shoh. Nuk mbetet asnjë grimë vend për xhelozin”. Dhe vërtet, kur drita fikej, tërë qiellana e dhomës dritësohej nga dhjetëra yje dhe planetë fotoshohentë që e zbkuronin dhe që lëshonin një shkëlqim të vetin. Ai dritësim vesonte përmbi kurbat zjarrmuese të trupit të indianes joshëse të vizatimit dhe atëherë ndodhte magjia: një lumë ndezullie ndjesore vërshonte përmbi shtratin dashuror ku kridhej ai që dëshironte.

Skerdi u ngrit, mbushi sërish gotat e tyre me verë dhe i sollti në shtrat. Teuta vendosi dy nënkresa, ngjeshi qafën dhe shpatullat pas tyre dhe mori në dorë gotën e verës. Piu një gllënjë dhe e vendosi me kujdes gotën e kristaltë në komodinën bri shtratit. Dielli i dimrit kish perënduar, por pas qelqnajes së derës së madhe me shina të verandës dukej gjurma e tij rozake në qiellin e mugët të mbrëmjes.

Vajza ishte përhumbur në soditjen e qiellit që dukej i butë si puplat e gushës së rosës së egër, ndërsa djali ishte përhumbur në soditjen e trupit të saj të lëshuar në paqen e ëmbël të pasfurtunës dashurore: ishte i praruar, vezullitës, me gjymtyrë të gjata e të holla, i gjithi në mëshirë të përkëdheljeve të tij. Përmbi lëkurën e mermertë të kraharorit të zbkuruar me prekëza vogëlane, vllaga e ngrohtë e pak minutave më parë ishte shndërruar në bulëza vetëtitëse, si cikla diamanti; djali nisi t’i lëmekte një nga një duke i tharë me mollëzat e gishtërinjve. Ishte si një dashuri e shpikur brenda dashurisë, që i merrte stafetën asaj që porsa kish përvëlur shtratin – përkëdhelja e trupit të shprangosur nga zjarrmia ephshore, shpirtëzimi i lëkurës që pak nga pak ishte ftohur nga përvëlimi çmendurak dhe kish marrë temperaturën e rërës së bregdetit në perëndimdiell, hyjnizimi i kraharorit me magjinë e arabeskave që ai pikturonte me pikëlimin e buzëve të tij, ku rrinin mbërthyer gjinjë si vepra më e arrirë e Zotit.



⁴ Vive la République! Vive la France! (fr.) – Rroftë Republika! Rroftë Franca!

Vonë në vitin 1919, në një studio të mjerë në Paris me shishe vere të shpërndara, Amedeo Modigliani pikturoi një portret të trishtuar të së dashurës së tij 21-vjeçare, Jeanne Hébuterne. Disa muaj më vonë, më 24 janar 1920, artisti i varfër vdiq nga tuberkulozi meningjit në moshën 35-vjeçare. Mbrëmjen tjetër, Hébuterne, tetëmuajshe shtatzënë me fëmijën e tyre të dytë, u hodh drejt vdekjes nga dritarja e katit të pestë.

Gjatë jetës së vështirë dhe të shkurtër të Modigliani-t, çmimi për pikturat e tij elegante e çuditërisht të deformuara ishte më pak se 10 dollarë dhe kishte pak blerës. Një qiradhënë, i cili i konfiskoi disa nga veprat në vend të qirasë, i përdori kanavacat për të arnuar një dyshek të vjetër. Nëntorin e vitit 2004, një ofertues anonim te shtëpia e ankandëve *Sotheby* në NYC, pagoi 31.3 milionë dollarë për portretin e Hébuterne.

Një nga ironitë e shumta në karrierën e Modigliani-t është se një jetë kaq torturose mundi të prodhonte një punë kaq të qetë. Arti i tij arriti të bashkonte hendekun stilistik mes pikturës klasike italiane dhe modernizmin avangard. Poeti francez Jean Cocteau, duke shkruar në vitin 1959, rreth 40 vjet pasi të dy kishin shëtitur kafenetë në Montparnasse të Parisit, e quajti Modigliani-n "gjeniun më të thjeshtë e fisnik për atë epokë heroike". Gjithsesi, historitë e artit tradicional zor se e përmendin. Vepra e tij, si duket, është tepër e vështirë për t'u klasifikuar në kanonin e pikturave të shekullit XX. Ndoshta, më e rëndësishmja, jeta e tij e gjallë e tragjike u ka bërë hije arritjeve të tij si artist.

"Modigliani në jetën e tij personale është thujse një karikatürë e piktorit të keqkuptuar bohemian", - thotë Tamar Garm, një historian arti në University College London. - "Nëse Van Gogh është gjeniu i çmendur tipik, Modigliani është i alkoolizuar tipik me tuberkuloz".


Një retrospektivë e Modiglianit (Phillips Collection, Washington D.C.) tenton ta anashkalojë reputacionin e tij si një përdorues droge i pashëm dhe një kurvar dorëshpuar. Organizuar nga Jewish Museum në New York City, "Modigliani: Beyond the Myth" ofron një portret të artistit si një intelektual serioz e i disiplinuar, veçanëria si piktor e të cilit pasqyrohet në statusin e tij të huaj si një emigrant italian dhe një hebre në Francën katolike. (Përdorimi i fjalës "mit" është pak çorientues, sepse Modigliani vërtet ishte një përdorues droge i pashëm dhe një kurvar dorëshpuar.)

Amedeo Modigliani u lind në portin e Livornos në Toskanë më 12 korrik 1884. Ishte një djalë mamaje ëndërrimtar e i çmuar, më i vogli nga katër fëmijë, në një familje intelektualësh majtistë. Babai i tij, një dështak në biznes, nuk qe i pranishëm në shumicën e fëmijërisë së Modigliani-t. Për t'ia dalë mbanë, mamaja e tij, Eugenia, hapi një shkollë në shtëpi, për të dhënë mësimë frëngjishte dhe anglishte, mes lëndëve të tjera. Një fëmijë i sëmurë, Dedo, siç e thërrisnin, pati disa periudha me pleurit dhe në moshën 14-vjeçare për pak vdiq nga ethet tifoide. Dy vjet më vonë u diagnostikua me tuberkuloz, i cili do ta vriste ngadalë gjatë njëzet viteve të ardhshme. Megjithëse fliste rrallë për gjendjen e tij, dukej i ndërëgjegjshëm për shkurtësinë e kohës së tij. Më vonë, në Paris, do t'i deklaronte një miku, skulptorit lituanëz Jacques Lipchitz, që mbi të gjitha kërkonte "une vie brève mais intense" (një jetë të shkurtër, por intensive").

Si riosh në Itali, u regjistrua në shkollat e artit në Livorno, Firenze dhe Venecia, ku studioi me përkushtim pikturë akademike dhe vizatime të jetës. Ishte i mahnitur nga artistët e Rilindjes Italiane, një pasion që në Paris do ta veçonte nga kaq shumë bashkëmohatarë militantë modernë. Megjithatë, ai donte të hapte terren të ri. Në moshën 17-vjeçare i shkroi nga Venecia

MODIGLIANI: I KEQKUPTUAR

Nga Doug Stewart



mikut të tij nga Livorno, Oscar Ghiglia: "Gjithmonë ngrije zërin dhe ec përpara. Njeriu i cili nuk mund të gjejë ambicie të reja dhe as një njeri të ri brenda vetes... nuk është njeri." Ambiciet e tij e çuan në Francë. "Si artist, - pëlqente Modigliani të thoshte duke cituar Nietzsche-n, - një njeri nuk ka shtëpi në Europë, përveç Parisit".

Duke arritur aty në vitin 1906 në moshën 21-vjeçare, Modigliani doli nga ndarja e klasit të dytë të trenit veshur me një kostum të zi dhe një pelerinë dramatike të zezë. Megjithëse i hollë, dukej më i gjatë se 167 cm dhe e mbante veten si aristokrat. Në valixhe kishte një botim të vjetër të Dantes (të cilin kishte prirje ta recitonte përmendsh me zë të lartë, ditën apo natën) dhe një riprodhim të vogël të *Dy kurtizanet*, pikturë nga artisti rilindës venetikan Vittore Carpaccio, të cilin do ta ngjiste në muret e një vargu dhomash të pafundme me qira. Mori mjaftueshëm para nga mamaja për të jetuar pak muaj, nëse do të ishte i kujdesshëm. Por Modigliani nuk ishte kurrë i kujdesshëm.

Në Paris, zbuloi veprat e Renoir, Degas, Gauguin dhe ndër më të rinjtë, më radikalët, Matisse dhe Picasso. Cézanne veçanërisht ai e shqiptonte "të admirueshëm", një nga mbiemrat e tij të parapëlqyer; kurdo që përmendej emri i Cézanne, ai nxirrte nga xhepi një riprodhim të *Djali me jelek të kuq* të piktorit dhe e puthte. Veprat e tij të hershme ishin të zymta, portrete të frymëzuara nga ekspresionistët me ngjyra gri-jeshile të aplikuara pa finesë dhe vijëzime të rënda shumë dukshëm të marra borxh nga Cézanne dhe Toulouse-Lautrec.

Modigliani mori shpejt pozën e bohemianit pompoz: frekuentonte shpesh vendet ku rrinin artistët në Montmartre dhe më vonë Montparnasse, vishte një shall mëndafshi me ngjyrë të ndezur të lidhur një në qafë në vend të kollares dhe i përgjigjej nofkës Modi, një lojë fjalësh me *peintre maudit* (piktor i mallkuar). Artisti rus, Chaim Soutine, ishte një mik i ngushtë dhe Maurice Utrillo, më vonë i famshëm për skenat e pikturuara të Montmartre, ishte shoqëruesi i tij i parapëlqyer për të pirë. Modigliani ishte mik dhe me Picasso-n, megjithëse nuk ishte pjesë e rrethit të tij të ngushtë. Picasso, i cili kishte pamjen e një punëtori me rrobat me arnuara dhe triko peshkatarësh, dukej sikur e kishte adhuruar gardërobën e Modigliani-t më shumë se pikturat e tij; në nevojë për një kanavacë, njëherë pikturoi mbi një vepër të Modigliani-t që kishte blerë. Modigliani, nga ana tjetër, e vlerësonte gjeniun spanjoll, por i tha një miku se talenti artistik nuk ishte justifikim për të mos u veshur mirë.

Për shumicën e jetës së tij, Modigliani u njoh më shumë si personazh sesa piktor. Rreth 40 vjet pas vdekjes së tij, e bija, Jeanne Modigliani, shkroi se disa njerëz gati zaliseshin nga sjellja e tij sharmante dhe e kultivuar, ndërkohë që të tjerëve u dukej "një budalla i padurueshëm" dhe një "pijanec qejfprishës i mërzitshëm". (Jeanne, vetëm një foshnjë kur i vdiqën prindërit, u rrit nga halla në Itali. E njihje të atin vetëm nga intervistat, letrat e dokumente të tjera. Artiste dhe shkrimtare, vdiq në vitin 1984 në moshën 66-vjeçare.)

Përkrahësi i parë i Modigliani-t ishte Paul Alexandre, një kirurg i ri dhe më vonë një tregtar që drejtonte një lloj kolonie arti me buxhet të ulët në një shtëpi të vjetër në Rue du Delta të Parisit. Modigliani pikturonte aty pa qira dhe ia jepte kanavacat Alexandre-it për 10-20 franga secilën dhe skicat për ndoshta 20 centima. Nuk ishte shumë, por doktori e linte artistin ta rimerrte veprën nëse mund të gjente një ofertë më të mirë. Mes 1909 dhe 1913, Modigliani pikturoi tri portrete me bojë vaji të Alexandre-it. I pari ishte një portret tradicional me subjektin duke pozuar me dorën në bel. I fundit, të cilin artisti e pikturoi nga kujtesa e tij, është më dallueshëm "modiglianeske", me penelat e shpejta, fytyrën e zgjatur dhe sytë e bardhë që do të bëheshin marka e tij.

Modigliani kishte futur shtatë piktura me akuarele dhe bojë vaji në ekspozitën e Salon d'Automne në Paris në vitin 1907 dhe pesë vepra në Salon des Indépendants në vitin 1908, por tërhoqën pak vëmendje. Përveç Alexandre-it, askush nuk dukej i interesuar në artin e tij. I hidhëruar, e zhyti veten në gdhendje guri, frymëzuar pjesërisht nga skulptori rumun Constancin Brancusi, mik dhe komshi. Modigliani ishte i bindur se Rodin dhe ndjekësit e tij e kishin korruptuar skulpturën me mbështetjen e tepruar në argjilë - "tepër baltë", e quante ai. Skulptorët e vërtetë, deklaronte, gdhendin direkt nga guri. Për ta bërë këtë, ai vidhte copa guri gëlqeror nga kantieret e ndërimit. Për një skulpturë të rastësishme në dru, merrte traversa lisi nga linja e re e metrosë që po zgjerohej për në Montmartre.

Nga rreth 1909 deri më 1914, megjithëse pluhuri i gurit i dobësonte mushkëritë e brishta, Modigliani gdhendi një seri kokash guri të mëdha, shumë të stilizuara. Me hundët e tyre jashtëzakonisht të gjata dhe gojë të vogla të mbledhura, veprat masive kombinonin qetësinë e skulpturave të varrit të hershme të Rilindjes me drithërimen ekzotike të monoliteve në Easter Island. Ai gjithashtu vizatonte dhe pikturonte kariatide - figura mbajtëse arkitekturale - gati si i fiksuar.

"Ndikimi i artit tribal, sidomos i skulpturës afrikane, në avangardën në Paris gjatë kësaj periudhe nuk mund mbivlerësohet", - thotë Mason Klein, kurator te Jewish Museum, i cili beson se vetëdija e mprehtë e Modiglianit për veten si hebre (megjithëse nuk e praktikonte) dhe si i jashtëm e hapi kundrejt pasurisë së artit joperëndimor. "Nëse sheh skulpturën e tij, - thotë Klein, - sheh ndikimin jo vetëm të artit afrikan, por artit Khmer dhe artit të Greqisë arkaike, Egjiptit dhe Romës antike. Sheh dhe një prani ikonike të artit bizantin".

Fatkeqësisht, kokat e gdhendura të Modigliani-t ishin thjesht tepër të çuditshme për të tërhequr blerës. I përdorte si mbajtëse gjigante qirinsh në studion e tij pa raftë ku shpesh flinte e punonte. Një bllok gëlqereje që e kishte transformuar në një kariatidë të përkulur ishte tepër e rëndë për të që ta merrte nga toka boshe ku e gjeti dhe e gdhendi. Miqtë e tij e shpëtuan shpejt pas vdekjes së tij në vitin 1920. Tani është në koleksionin e Museum of Modern Art në New York City.

"Skulptura e ndihmonte të mendonte se si mund t'i thjeshtosh format, si mund të tregosh thelbin e diçkaje duke përdorur mjetet më të thjeshta të mundshme", - thotë historiani i artit Tamar Garb. Kur Modigliani u rifokusua te piktura rreth vitit 1914, vepra e tij kishte një energji dhe vetëbesim të ri.

Shumica e piktorëve që bënë emër në fillim të shekullit XX morën pjesë në lëvizjet e reja me teoritë dhe manifestet e tyre: fauvizmin, futurizmin, e të tjera të ngjashme. "Modigliani ishte gjithmonë anomali", - thotë Klein. - "Vepra e tij nuk përshatet me kategoritë standarde të historisë së artit, si ekspresionizmi apo kubizmi. Të mos pikturoje natyra të qeta dhe të ishe ekskluzivisht i përqendruar te portretet

ishite shumë e pazakontë, në mos unike, në kohën e tij”. Por Modigliani ishte i lumtur të qëndronte mënjanë. Charles Beadle, një gazetar anglez i cili kontribuoi në biografinë e vitit 1941 të Modigliani-t të titulluar *Artist Quarter*, e kishte njohur artistin në Paris rreth vitit 1913. “Njëherë, - shkruan Beadle, - kur e pyeta si e quante ‘metodën’ e tij, ma ktheu me mendjemadhësi: ‘Modigliani! Kur një artisti i duhet t’i ngjitet një etiketë, ka humbur!’”

Impulsiv dhe argumentues, Modigliani nuk kishte as prirjen as aftësitë shoqërore për të bërë portrete me pagesë. (Në një pikturë të hershme të një baroneshe franceze që gjuante dhelpra, ai e ndërroi xhakatën e kuqe flakë të gruas në të verdhë kanarine. E fyer, baronesha refuzoi ta paguante për pikturën.) Shumë nga subjektet e tij ishin miq ose të njohur. Portreti i tij për Jean Cocteau është një përzjerje e shkathët “e pamjes” markë të Modigliani-t – sy të papërputhshëm, hundë të shtrembëruar, kokë të zgjatur të balancuar mbi një qafë si bazament – dhe kryelartësinë e akullt të poetit. “E sheh Cocteau të ulur aty si perandor në karrigen si fron me një vetull të ngritur, i gatshëm për të përzënë vërejtjen idiote të ndokujt”, - thotë Klein. Piktura ka elemente të karikaturës, por nxjerr rëndësën e një portreti mbretëror.

Po aq demaskuese janë edhe pikturat e Modiglianit të Paul Guillaume, tregtari i tij i parë serioz i artit. Në një portret të vitit 1915, Guillaume duket elegant dhe me vetëbesim, me një mustaqe të vogël dhe një dorë me dorezë që po mban një cigare. “Modigliani shkroi ‘Novo Pilota’ poshtë figurës”, - thotë Klein. - “E shihte Guillaume si ‘Pilotin e ri’ të tijin, një anëtar i mençur i avangardit i cili do t’i avanconte karrierën. Por sheh gjithashtu mosbesimin për këtë gjithçkanjohës kozmopolitan në mënyrën se si e ka theksuar animin mendjemadh të kokës, kostumin luksoz, cigaret, sikur Guillaume të ishte një tutor që shiste veprën e Modigliani-t”.

Sigurisht, janë interpretimet e stilizuara të grave melankolike e mospërfillëse të Modigliani-t që janë më të njohura sot. Por ajo që i bën portretet e tij të mbesin në mendjen e njerëzve është paretat që mjegullon fytyrat e subjekteve të tij. “Të gjithë janë si fëmijë të lënduar, megjithëse disa prej këtyre fëmijëve kanë mjekër ose thinja”, - shkroi romancieri rus Ilya Ehrenburg, i cili gjithashtu e kishte njohur artistin në Paris. - “Besoj se Modiglianit bota i dukej si një kopsht fëmijësh i madh që drejtohej nga të rritur të pasjellshëm”. Fëmijën me pamje të brishtë që po shtrëngon duart te *Vajzë e vogël me blu*, në fakt, sapo e kanë qortuar. Artisi e kishte dërguar për një shishe verë dhe ajo ishte kthyer me një limonadë.

Ndoshta paretat reflektonte gjithashtu barrën e varfërisë së vetë Modigliani-t. Ai ishte përzënë nga një sërë dhomash në Montmartre dhe Montparnasse dhe flinte në hotele me një frang nata, dhoma pritjeje në stacionet e trenit dhe ndërtesa të braktisura. Ai ia dilte, gjithsesi, të ruante elegancën e tij pavarësisht financave dhe tërhoqi një numër të madh të dashurash, megjithëse lidhjet e tij prireshin të ishin të rufeshme e të shkurtra. Ndryshe nga miqtë e tij artistë, ai refuzonte të punonte punë të ndryshme, megjithëse përpjekjet e tij për të shitur veprat e veta zakonisht përfundonin keq. Duke shkruar në vitin 1925, piktori Maurice de Vlaminck kujtoi Modigliani-n që po i tregonte disa vizatime një tregtari që i kishte ardhur në studio: kur tregtari po kërkonte zbritje, “Modigliani, pa fjalë, mori pirgjet e letrave dhe i drejtoi me kujdes, bëri një vrimë mes gjithë pirgut, i vuri një pe në mes dhe i vari në banjë”.

Përveç disa shumave që ndonjëherë ia dërgonte mamaja nga Livorno, Modigliani mbijetonte kryesisht me skica të shpejta të



Modigliani, *Nu Couché (Sur Le Côté Gauche)*

njerëzve në kafene të cilat i këmbente me monedha, një vakt ose pije. Vlaminck kujtoi dinjitetin e rastësishëm të Modigliani-t teksa punonte te Café de la Rotonde: “Me një gjest milioneri e mbante letrën (në të cilën ndonjëherë shkonte aq larg sa firmoste emrin e tij) sikur të mbante një pagesë me çek për dikë që sapo i kishte blerë një gotë uiski.”

Në vitin 1916, Modigliani u miqësua me një tregtar arti me kohë të pjesshme të quajtur Leopold Zborowski, një emigrant polak dhe poet i vetëstilizuar i cili ia doli t’i jepte artistit një pagë mujore të vogël në këmbim të dhënies së rregullt të pikturave. Marrëveshja nxiti shpirtin e piktorit si dhe të ardhurat e tij. Si pjesë e marrëveshjes, Zborowski i dha artistit një dhomë, ushqim, materiale për të punuar dhe hapësirë studioje, bashkë me qymyr për ta ngrohur. Qymyri doli thelbësor në dimrin e ftohtë të vitit 1917, kur, me inkurajimin e Zborowski-t, Modigliani pikturoi një rresht nudosh të mëdha, të cilat janë mes punëve më të pashlyeshme të artistit.

“Modigliani ishte një piktor thellësisht italian dhe ishte qartësisht i interesuar në gjuhën e trupit, e cila është gjuha e artit italian”, - thotë Griselda Pollock, një historiane arti tek University of Leeds në Angli, e cila shkroi për nudot në katalogun e ekspozitës për Jewish Museum. - “Kur qëndron para disa nudove të Modigliani-t, bëhesh vërtet me turp duke qenë në praninë e një fiziku kaq të sinqertë. Por edhe pse njihet si burrë i pashëm me shumë dashnore, këto ishin kryesisht modele të punësuar nga Zborowski. Nuk i njihte”.


Zborowski çuditërisht shiti një nudo për treqind franga, por përgjithësisht ishin problematike. Francis Cardo, një mik shkrimtar i Modigliani-t, e bleu një për apartamentin e tij si beqar. “Mëngjesin tjetër, - kujtoi, - kur pastruesja erdhi për të rregulluar dhomën, gati ra e vdekur nga pamja e pikturës mbi shtrat”. Për shfaqjen e parë solo të Modigliani-t, te galeria Berthe Weill në Paris në dhjetor 1917, një nudo e madhe u vendos në vitrinën e dyqanit, matanë rrugës nga një stacion policie. Duke parë një turmë që po mblidhej në natën e hapjes, policia investigoi dhe urdhëroi që të hiqeshin gjithë nudot. Kur Weill kërkonte një shpjegim, inspektori turfulloi, “*Ces nues... ils ont des p-p-pois!*” (Këto nudo... kanë qime trupi!) Shfaqja e planifikuar që prej një muaji u mbyll para se të fillonte zyrtarisht, megjithëse Weill ia doli të shiste dy vizatime. (Dyzet vjet më vonë, gratë e Modigliani-t ishin ende duke rritur tensionin e gjakut. Autoritetet postare në New York City e vlerësuan një prej kartolinave të

GuggenheimMuseum me një nga nudot e shtrira të papërshtatshme për postën e SHBA-së në vitin 1950.)

Kur Modigliani takoi të dashurën e tij të fundit dhe më të përkushtuar, Jeanne Hébuterne, në vitin 1917, ajo ishte një studente arti premtuese 19-vjeçare. U shpërngul menjëherë me të, duke lënë të tmerruar familjen e saj borgjeze që kishte marrë një artist të dështuar, hebre për më tepër. Çifti ndau një apartament të rrënuar në Rue de la Grande Chaumière ku, sipas një qiraxhiu të mëvonshëm, “mund të shihje rrezet e diellit që shkëlqenin përmes një pjese të murit”.

Hébuterne ishte e hollë me sy si bajame, fytyrë të zbehtë dhe gërsheta të gjatë kafe të hapur. Ishte aq e përmbajtur sa gruaja e Zborowski-t, Hanka, më vonë nuk kujtonte t’i kishte dëgjuar ndonjëherë zërin. Modigliani e prezantonte si “më e dashura” e tij – një nofkë që me sa duket nuk e kishte përdor kurrë me gra të tjera – dhe iu betua me shkrim se do të martohej me të (megjithëse nuk e bëri kurrë). Dashuria e Hébuterne-s për Modigliani-n ishte me sa dukej pa kushte; ajo madje i falte të pirën dhe daljen nëpër klube.

Në vitin 1918, me Parisin nën bombardimin gjerman, Hébuterne shtatzënë dhe Modigliani me shëndetin e tij të brishtë që po i përqeçohej, Zborowski organizoi një pushim artistik në Provence, për veten, familjen e tij dhe një grup



Modigliani, *Gruaja me sy blu*, 1918

artistësh (duke përfshirë Modigliani-n e Hébuterne-n), që zgjati gati një vit. Aty paleta e Modigliani-t u bë më e ndezur dhe kompozimet e tij më të theksuara. Hébuterne lindi vajzën e tyre, Jeanne, në Nice, më 28 nëntor 1918. Në verën e vitit 1919 ishte sërisht shtatzënë. “Po shëndoshem dhe po bëhem qytetar i respektueshëm i Cagnes-sur-Mer”, - i tha Modigliani i tmerruar një miku artist. - “Do të kem dy fëmijë; është e pabesueshme. Është e pështirë”.

Arti i tij më në fund po vihej re. Atë verë, Modigliani dhe Utrillo ishin yjet e një ekspozite të rëndësishme në Londër. Romancier dhe kritiku ndikues Arnold Bennett shkroi në katalogun e ekspozitës që portretet e Modigliani-t “kishin një ngjashmëri të dyshimtë me kryeveprat”.

Në një faqe të bllokut të skicave të tij Modigliani shkarravit: “Një vit i ri. Këtu fillon një jetë e re.” Thotë kuratori Klein: “E shkroi këtë në Paris tri javë para se të vdiste. E dinte që po vdiste, por punoi deri në fund.” Modigliani-n ndoshta e zuri pneumonia. I dobët dhe i rraskapitur, u shemb në shtëpi dhe u çua pa ndjenja në një spital bamirësie, ku vdiq dy ditë më vonë.

Në funeralin e tij shkuan më të njohurit e botës së artit të Parisit: Picasso, Léger, Derain, Brancusi dhe qindra të tjerë. Në shërbimin e funeralit, vajtuesit raportuan se u ishin afruar tregtarë të etur për të blerë pikturat e Modigliani-t. Galeritë me veprat e tij në stok i dhjetëfishuan çmimet; blerësit i dhjetëfishuan sërisht. Kopjet përmytën tregun. Edhe zyrtarët e policisë ishin të etur për pikturat e tij. Mamaja dhe vëllezërit e motrat e Modigliani-t në Itali nuk përfituan kurrë – kishin pak, në mos asnjë, nga pikurat e tij. Trashëgimia e vetme e Jeanne-it katërmëdhjetëmuajshe ishte koleksioni i marrë për të nga miqtë artistë të babait.

Katër vjet pas vdekjes së Modigliani-t, romancier francez Michel Georges-Michel e bëri heroin tragjik të melodramës *Les Montparnos*, të cilën e vuri në skenë në operën *La Bohème*. Që atëherë, jeta e Modigliani-t është romantizuar në libra të tjerë, skena e filma, më së fundi një film nga shkrimtari-regjisor scocez Mick-Davis, luajtur nga Andy Garcia. Historiani kulturor Maurice Berger, i cili ka ekzaminuar reputacionin pas vdekjes së artistit, thotë se Modigliani “nuk ka qenë kurrë i dashur nga historianët e artit modernist, të cilët e konsiderojnë jo dhe aq të rëndësishme veprën e tij, por publiku e ka dashur gjithmonë: elegancën, finesën, stilin. Dhe njerëzit gjithmonë e duan një histori të mirë”.

Marrë nga *The Smithsonian Magazine*
Përktheu: Enxhi Hudhri

“Është poezia klasike e një njeriu të martirizuar, ku ndjehet jehona e këngës labe. Ngrihet si një kolonë mermeri, me basoreliefe ngjarjesh kombëtare dhe të jetës së tij plot drama, që edhe pse e thyer, e jep idenë e një plotshmërie të madhërishme, e cila nga hijet e dikurshme del shumë e më shumë në dritën e tanishme.”

Visar Zhiti

KUDRET KOKOSHI

Me parathënie nga Visar Zhiti

i rrëmbyer
nga stuhitë...

Onufri Poezi